Fondi për të drejtën humanitare
Humanitarian Law Center
Fond za humanitarno pravo

Mars 2004

DHUNA ETNIKE NË KOSOVË

Fondi për të drejtën humanitare

Korrik 2004

Rezyme

Serbët në Kosovë pas qershorit të vitit 1999 kanë kaluar vite të vështira. Pas tërheqjes së policisë dhe ushtrisë serbe ata u bënë shënjestër e UÇK-së dhe grupeve kriminale. Shumë vrasje, kidnapime dhe asgjësime të pasurisë ndodhën në praninë e forcave ndërkombëtare. Mosreagimi i KFOR-it i bindi edhe shqiptarët, të cilët personalisht kanë qenë kundër dhunës, se bashkësia ndërkombëtare po e mbështetë idenë e grupeve ekstremiste politike për "Kosovën pa serbë". Më 17 mars, duke përjashtuar Mitrovicën UNMIK-u dhe KFOR-i, para së gjithash, me të pabërat e tyre përsëri trimëruan ekstremistët shqiptarë. Mirëpo ata kësaj radhe haptazi u kthyen kundër UNMIK-ut dhe KFOR-it. Ditën e parë me 17 mars detyruan policinë e UNMIK-ut që të tërhiqet në bazat e KFOR-it. Më 18 mars vazhduan të gjuajnë në serbë, duke mos u penguar nga ana e forcave ndërkombëtare dhe me miratim heshtazi të liderëve politik shqiptarë. Dukej sikurse vepronin sipas planit "Dëbimi nga shtëpitë dhe djegëja e pasurisë.

Për dy ditë rresht një grup i vogël sërbësh në shenjë proteste për shkak të sulmit dhe plagosjes së një të riu nga Çagllavica mbajti të bllokuar magjistralen Prishtinë – Shkup. KFOR-i reagoi më energjetikisht vetëm atëherë kur kanosej rreziku se demonstruesit shqiptarë nga Prishtina do të futen në Çagllavicë. Tubimi i shqiptarëve në Mitrovicën jugore me 17 mars për shkak të vdekjes tragjike të tre fëmijëve shqiptarë nga Çabra është shndërruar në tentim për "Çlirimin e "Mitrovicës veriore. KFOR-i këtë me sukses e pengoi duke u konfrontuar me demonstruesit. Lidhur me incidentet tjera KFOR-i duke i mbledhur serbët nëpër shtëpia apo duke i pranuar ata pas dëbimit kanë vepruar sikurse ekipet shpëtimtare. Pas vetës kanë lënë shtëpitë e pambrojtura serbe, me arsyetimin se nuk e kanë mandatin për përdorimin e armëve dhe nuk mund t'i ekspozojnë rrezikut jetërat e ushtarëve të tyre. Në pranin të KFOR-it janë plaqkitur dhe asgjësuar shtëpitë serbe në Frashër afër Mintrovicës jugore, shtëpitë e fundit serbe në dhe Ferizaj, shtëpitë e të të kthyerëve në Belo Polje te Peja dhe lagja e Ashkalinjëve në Vushtërri.

Dhuna e marsit tregoi se policia e UNMIK-ut ka humbur autoritetin tek serbët. Ka pasur raste kur kanë rrefuzuar që të ofrojnë ndihmë personave të moshuar si psh. në Fushë Kosovë kur polici ka ikur me familjen e tij duke e lënë një plakë 80 vjeç në mëshirën e demonstruesëve.

Ngjarjet e 17 dhe 18 marsit tregojnë se anëtarët e SHPK-së kanë vepruar pa komandë dhe udhëzime duke pritur që liderët politik t'i udhëzojnë se çka duhet bërë. Meqenëse liderët politik shqiptarë heshtën duke e pritur rrjedhën e ngjarjeve në terren dhe në rrugë nuk kishte polici të UNMIK-ut, SHPK është lënë që të zgjedhë në mes të sjelljes profesionale dhe mbështjetjes demonstruesve. Disa kanë qëndruar në anën e demonstruesëve duke marrë pjesë në asgjësimin e pasurisë. Pjesa më e madhe e tyre ishte vëzhgues të cilët nuk kanë ndërhy as kur demonstruesit i kanë rrahur serbët. Një numër relevant i policëve Kosovar ka marrë pjesë në evakuim gjë që disa serbë e vlerësojnë si pjesëmarrje indirekte në dëbimin e tyre, kurse një numër tjetër mendojnë se ata ua kanë shpëtuar jetën.

Se çdo gjë nuk është krejtësisht e zezë tregon shembulli i solidaritetit të një polici shqiptar ndaj fqiut serb dhe solidariteti ndaj kolegëve në punë. Duke u udhëhequr me ndërgjegjen e tyre disa kanë tentuar t'u ndihmojnë serbëve duke i larguar ata nga rruga, duke thirrë policinë apo duke i dërguar ata në bazat e KFOR-it. Në mjediset rurale ka shembuj kur lideri i fshatit shqiptar i ka ndalur demonistruesit dhe ka penguar hyrjen e tyre në fshatin serbë si dhe asgjësimin e

pasurisë. Qytetarët e Vushtërrisë kanë ndihmuar evakuimin e ashkalinjëve në lagjën e të cilëve janë futur ekstremistët duke shkatërruar dhe djegur shtëpitë e tyre të posandërtuara.

Me shkatërrimin e përmendoreve kulturore dhe fetare Kosova në pikëpamje të civilizimit është shkretëruar. Sulmet shkatërruese në kisha dhe manastire treguan vendosmërinë e ekstremistëve që të shkatërrojnë çdo gjurmë të ekzistencës së kulturave dhe religjioneve tjera.

Ka bazë për konkludim se demonstratat me rastin e fatit tragjik të tre fëmijëve shqiptarë në mënyrë të organizuar janë transformuar në dhunë kundër serbëve, kulturës së tyre dhe religjionit si dhe frikësimin e UNMIK-ut. Atje ku përfaqësuesit e pushtetit lokal kanë tentuar të qetësojnë demonstruesit ka ndodhë që edhe ata të bëhen cak i sulmit si psh. nw Kamenicë.

Gjithashtu ka bazë për konkludim se heshtja e përfaqësuesve të institucioneve dhe liderëve të partive politike më 17 mars ka trimëruar organizatorët dhe pjesëmarrësit e demonstratave në drejtim të përshkallëzimit të dhunës me 18 mars. Paraqitja e tyre para opinionit dhe apeli për ndërprerjen e dhunës ka lanë përshtypje si jo e sinqertë dhe si e imponuar.

Rekomandime

Organet e gjyqësisë duhet të dënojnë përgjegjësit për dhunë etnike, si aktorët e drejtpërdrejtë të veprave penale ashtu edhe ata të cilët kanë nxitur, ndihmuar, drejtuar apo në formë tjetër mbështetur dëbimin e serbëve dhe ashkalinjëve.

Në disponimin armiqësor të cilin e kanë treguar demonstruesit ndaj UNMIK-ut duhet përgjegjur me shqyrtimin e marrëdhënieve të administratës ndërkombëtare ndaj bashkësisë vendëse duke inkuadruar edhe qasjen e shërbimeve ndërkombëtare.

Të bëhet hetimi lidhur me dëshmitë dhe shënimet se një numër i caktuar i anëtarëve të SHPK-së ka qëndruar në anën e demonstruesve. Ata të cilët janë sjellur joprofesionalisht dhe kundër ligjit duhet larguar nga Shërbimi. Mirëpo, duhet të kihet kujdes se ky është i vetmi institucion i Kosovës i cili ka funksionuar me 17 dhe 18 mars. Kësaj duhet t'i ipet rasti që të bëhet shërbim i cili do të kujdeset për sigurinë fizike të pjesëtarëve të pakicave dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Vërejtjet hyrëse

Në dhunën etnike në Kosovë më 17 dhe 18 mars kanë pësuar 15 shqiptarë dhe 12 serbë. Janë lënduar 170 serbë, prej tyre 150 nga rrahjet në shtëpitë e tyre, ndërsa 20 janë lënduar gjatë sulmeve në rrugë. Rreth 800 objekte serbe, 90 të hashkalinjve dhe 2 shtëpi shqiptare janë shkatërruar plotësisht ose janë dëmtuar seriozisht. Krahas objekteve civile, plotësisht janë demoluar dhe të djegur 36 objekte fetare ortodokse. Sipas të dhënave të Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara gjatë trazirave të marsit janë lënduar 954 persona, në mesin e të cilëve 65 policë ndërkombëtarë, 58 pjesëtarë të SHPK-së dhe 61 pjesëtarë të forcave ndërkombëtare paqësore.[1]

Në mesin e marsit në shumicën e qyteteve në Kosovë Shoqata e Veteranëve të UÇK-së[2] ka organizuar protesta kundër arrestimit të komandantit të Degës të TMK-së në Prizren Selim Krasniqi dhe disa oficerë të tij [3] Në ato protesta organizatorët kanë kritikuar ashpër politikën e UNMIK-ut ndaj UÇK-së duke kërkuar lirimin e ish luftëtarëve të arrestuar të UÇK-së.

Më 15 mars, pas orës 19,00 në fshatin Çagllavicë është plagosur serbi Jovica Iviq (18) derisa ishte duke ecur përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë/Shkup. Pas kësaj ngjarjeje, diku rreth orës 20,00 afër 20 serbë janë tubuar dhe kanë bllokuar rrugën Prishtinë/Shkup, duke gjuajtur me gurë automjetet e shqiptarëve, të cilët duke mos ditur për barikadat kalonin nëpër këtë rrugë. Forcat e KFOR-it dhe të policisë së UNMIK-ut menjëherë shkuan në vendin ku ka ndodhur sulmi ndaj Jovica Iviqit. Mbledhja e provave dhe dëshmive në vendin e ngjarjes ka përfunduar 2 orë më vonë, por rruga ishte e dhe mëtej e blokuar. Në blokimin e rrugëve kanë marrë pjesë më së shumti 200 serbë. Në mengjesin e datës 16 mars, serbët kanë blokuar rrugën që kalon nëpër Graçanicë, duke gjuajtur automjetet e shqiptarëve, por policia e UNMIK-ut e ka izoluar këtë zonë dhe ka bërë të mundshën që komunikacioni tël zhvillohet nëpër rrugët anësore. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i pa sukses kanë bërë përpjekje që të merren vesh me Sërbët për ta çblokuar rrugën. Nga ana tjetër, demostrusit shqiptarë kanë blokuar rrugën përgjatë fshatit Kishnicë. Në mbrëmjen 16 marsit është krijuar përshtypja se situata po qetësohet.

Më l6 mars, pasdite, tre fëmijë shqiptarë, Floriani (9), Egzoni (12) dhe Avni Veseli (13) nga fshati Qabër, të komunës serbe Zubin Potok, janë mbytur në lumin Ibër. Fëmija i katërt Fitim Veseli arriti deri ne bregun e lumit. Trupat e dy djemëve janë gjetur gjatë natës në ujërat e këtij lumi. Djaloshi i mbijetuar ka deklaruar se ate dhe tre shokët e tijë i kanë ndjekur disa serbë që kishin me vete një qen dhe në lum kanë hyrë për të shpëtuar. Dekleratën e tij e kanë emetuar shpesh gjatë natës dhe në mëngjesin e ardhshëm të gjitha televizionet e Kosovës, duke i akuzuar Sërbët dhe njëkohësisht duke dhënë komentet e disa personaliteteve publike se "për shkak të këtyre krimeve serbe duhet të ndermerret diçka"

---

[1] Repopti i sekretarit të përgjithshëm për administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 30 prill 2004 (Secretary-General of the United Nations,Report of the Secretary-General on the Unitend the United Nations Interim Administration Missionin Kosovo).

[2] Shoqata e Veteranëve të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të UÇK-së dhe Shoqata e familjeve të heronjve të UÇK-së.

[3] Janë arrestuar më 16 shkurt 2004, në bazë të aktakuzës së prokurorit ndërkombëtar për krime lufte dhe krim të organizuar.

Pas lajmit për vdekjen e tre djemëve së pari kanë reaguar shqiptarët nga Pjesa jugore e Mitrovicës duke organizuar tubime në shenjë proteste dhe duke organizuar grupe për të sulmuar Veriun e Mitrovicës. Rreth orës 11 më 17 mars një grup i shqiptarëve nga pjesa jugore e Mitrovicës ka çarë blokadën e KFOR-it mbik urën e Ibrit, e cila ndanë qytetin, dhe ka kaluar nëpjesën veriore të Mitrovicës. Rreth mesditës, qindra shqiptarë janë tubuar në Prishtinë dhe janë nisur në drejtim të Çagllavicës. Në qendër të Prishtinës ata kanë djegur automjetet e UNMIK-ut dhe të KFOR-it. Tubimi i demostruesve, kryesisht të rinjë,ka vazhduar në të gjitha qytetet e Kosovës. Demostruesit kishin ardhur nga fshatrat me autobus të pajisur me flamuj kombëtarë dhe parulla "UÇK, UÇK", "Çagllavica nuk është Serbi", "Mitrovicë ne jemi me ty", "UNMIK-u imponon luftë të re" e të tjera. Më 17 mars duke filluar nga ora 14,00 demostruesit e organizuar kanë sulmuar gati të gjitha fshatrat serbe dhe pjesët e qyteteve ku jetonin grupet e vogla te serbëve. Në Vushtrri është sulmuar lagja e ashkalinjve. Në mëngjesin e datës l9 mars KFOR-i ka vendosur kontrolin në tërë territorin e Kosovës.

Disa ditë më vonë, më 24 mars në afërsi të Podujevës nga pusia janë vrarë një oficer i SHPK-së dhe një polic ndërkombëtar, ndërsa përkthyesi është plagosur. Duke u përgjigjur në sulmin, oficeri tjetër i policisë ka vrarë njërin nga sulmuesit. Sulmuesit tjerë janë arrestuar.

Lidhur me rezultatet e hetimeve me rastin e vdekjes së 3 fëmijëve nga fshati Çabër, prokurori ndërkombëtar në Mitrovicë Piter A. Tinsli/Peter Tensley në raportin e tij[4] ka konkluduar se dëshmitë e ofruara nuk përkrahin ekzistimin e dyshimit të bazuar se është kryer vepër penale nga ana e ndonjë personi.

[4] Pa dëshmi për përgjegjesinë serbe,DANAS 28 prill 2004

1. Sulmi në veri të Mitrovicës

Tubimi i shqiptarëve në qendër të pjesës jugore të Mitrovicës ka filluar me datën 17 mars në mëngjes rreth orës 8,00. Disa qindra protestues në orën 11,00 në mënyrë të organizuar janë nisur në dejtim të urës kryesore, e cila ndanë pjesën jugore dhe veriore të qytetit. Demostruesit janë konfrontuar me policinë ndërkombëtare në afërsi të zonës së besimit dhe pa probleme kanë kaluar blokadën, 100 metra nga selia e UNMIK-ut, si dhe para selisë.Tek barikada e tretë, në urën kryesore ka ndodhur fërkimi në mes të demonstruesve dhe pjesëtarëve të KFOR-it, por demostruesit arritën ta thejnë edhe këtë barikadë dhe vazhduan marshin në drejtim të veriut të Mitrovicës. Arritën deri në fund të urës në anën veriore, duke bartur flamurin shqiptar. Pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut i kanë kthyer mbrapa, duke hedhur gaz lotësjellës dhe shokë-bomba, por demonstruesit nëpërmes urës për këmbësorë arritën në lagjën "Tre solitera" ku jetojnë shqiptarët.

Rreth orës 11,00, në udhëkryqin kryesor kam parë gra dhe fëmijë duke vrapuar nga drejtimi i urës dhe duke bërtitur "shqiptarët e kaluan urën". Vrapova në drejtim të urës dhe në anën tonë kamë parë një grup shqiptarësh, të cilët gjuanin me gurë automjetet dhe shitoret. Nuk mund të besoja se tentojnë që ta pushtojnë pjesën veriore të Mitrovicës. Serbët (meshkujt) vraponin në drejtim të urës, ushtarët (KFOR-i) gjuanin gaz lotësjellës mbi shqiptarët, duke u përpjekur që t'i kthenin mbrapa. Në anën tonë, para urës kryesore, tani më janë tubuar shumë meshkuj. Kemi parë se shqiptarët janë nisur në drejtim të urës për këmbësorë, përkatësisht në drejtim të tre soliterëve. Rreth soliterëve ka pasur shumë autoblinda dhe ushtarë të KFOR-it. shqiptarët nganin si pa kokë dhe e gjuanin KFOR-in dhe serbët. Kanë filluar të gjuanin nga drejtimi i soliterëve dhe nga shumë anë të tjera nga jugu i Mitrovicës. Të shtënat nga armët e zjarrit janë dëgjuar disa orë. Edhepse kur KFOR-i arriti që t'i kthejë dhe t'i bllokojë të gjitha kalimet edhe shqiptarët edhe serbët kanë mbetur deri natën vonë, secili në anën e vetë. shqiptarët, duke pritur rastin që të sulmojnë, ndërsa serbët të gatshëm që të mbrohen në veri të Mitrovicës. Më së shumti më kanë befasuar shqiptarët nga tre soliterët. Ata jetojnë aty me vite dhe pa probleme. Ne ata nuk i vërejmë. Në vend që t'i pengojmë bashkombasit e tyre nga jugu i Mitrovicës ata u ndihmonin. Personalisht kam parë se nga dritaret i kanë gjuajtur serbet dhe KFOR-in para soliterit.

M.R. Gazetare nga veriu i Mitrovicës
FDH intervistë 7 prill 2004

Kam vërejtur që shumica e shqiptarëve, të cilët kanë kaluar urën kryesore, ishin të rinjë. Bartnin gurë me të cilët gjuanin shitoret, kafiteritë, automjetet dhe ndërtesat. Në urë arritën ushtarët (KFOR-i) me paisje të plotë ushtarake. Gjuanin gaz lotësjellës dhe shok-bomba mbi shqiptarët. Arritën që t'i kthejnë mbrapa. Pastaj filluan që të tubohen nga qendra kulturore, me qëllim që të kalojnë urën e këmbësorëve. Në ndërkohë në anën tonë u tubuan disa mijëra serbë, arritën ende ushtarë (...). shqiptarët gjuanin me gurë, brohoritnin UÇK, UÇK, ndërsa ne i tubonim gurët dhe i gjuanim ata. Po të mos ishte KFOR-i ne nuk do të shpëtonim. shqiptarët së shpejti filluan të gjuanin me armë nga të gjitha anët. Ne u shtrimë për tokë dhe u fshehnim pas automjeteve. Mua më goditi guri në kokë, ndërsa shoku im u qëllua nga arma. Njerëzit na transportonin për në spital. Atje kishte shumë të lënduar.Kurrë nuk do ta harojë 17 marsin. Ne

(serbët) asesi nuk do t'i lejojmë shqiptarëve që ta kalojnë urën. Ne me ata nuk mund të jetojmë së bashku".

M.S. Serb nga veriu i Mitrovicës
FDH intervistë 7 prill 2004

Unë jetoj në lagjën "Tre solitera". Në këto ndërtesa, përveç neve (shqiptarëve) jetojnë edhe serbët. Në jug të Mitrovicës shkojmë nëpërmjet urës për këmbësorë, të ciën e ka ndërtuar KFOR-i. Në kohën e fundit situata ishte e mirë, kështu që e shfrytëyzonim edhe urën kryesore. Me 16 maj u dëgjua lajmi se fëmijët janë mbytur në lumë, sepse i kanë ndjekur serbët me qen. Nuk di a është kjo e vërtetë. Ditën tjetër shqiptarët në shenjë proteste u tubuan rreth urës nga ana e jugut. Kam parë që pastaj janë tubuar edhe serbwt në anën tjetër të urës. Filluan që të gjuanin me gurë. Ishte një numër i vogël i policëve ndërkombëtarw, kështu që u nisën që të ballafaqohen. Kam dëgjuar edhe të shtëna. Unë isha para ndërtesës sime. Me mua ishin edhe 15 meshkuj nga soliteri. Askend nuk e kemi provokuar, vetëm shikonim se çka po ndodhë në urë. Kur na vërejten serbët u nisën në drejtimin tonë, pastaj u nisën edhe shqiptarët nëpër urën për këmbësorë. Kështu ndodhi konflikti. Të gjithë shqiptarët nuk arritën, sepse KFOR-i francez shumë shpejtë e bllokoi urën. Rreth orës 13,00 filloi konflikti, së pari me gurë. serbët deshën të hyjnë në ndërtesat tona, por ne i penguam. Pjeswtarët e KFOR-it nuk kishin mundësi që t'i pengonin, ndërsa ne nga soliteri (shqiptarët) nuk jemi përzier.Unë nuk kisha mundësi që të ndikoj në shqiptarët e anës jugore të Mitrovicës. Si shqiptarët, ashtu edhe serbët ishin agresiv. Një i ri, Fatmir Abullahu, shqiptar nga Shipoli është qëlluar dhe ka mbetur në vend i vdekur. serbët qëllonin me snajper në drejtim të ndërtesave tona. Në një moment kam hyrë në ndërtesë për t'i larguar fëmijët e fqiut nga kati i parë në një kat më lartë dhe derisa ngjitesha shkallëve një plumb depërtoi në dritaret e shkallëve. Plumbi erdhi nga kulmi i shkollës së medicinës nga pjesa veriore. Ka shenja nga plumbat edhe në banesa. Sipas mendimit tim të shtënat vinin nga drejtimi i ndërtesave të kuqe afër kafiterisë "Dolçe Vita". Rreth orës 17,00 KFOR-i arriti që ta qetësojë situatën, por edhe mëtej ka patur të shtëna sporadike. Në lajme kam dëgjuar se janë vrarë edhe dy shqiptarë, një maqedone dhe një serb dhe që shqiptarët i kanë sulmuar serbët edhe në qytetet tjera. Sipas mendimit tim kjo është ngjarja më e trishtuar pas vitit 1999. Të gjithë duhet t'i bartim pasojat. Ditën e ardhshme është djegur kisha ortodokse në jug të Mitrovicës.

N.R. Shqiptar i anës veriore të Mitrovicës, lagja "Tre Soliterat"
FDH intervistë 24 mars 2004

Kur kanë filluar konfliktet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në lagjen "Tre soliterët" Boshnjakët nga "mahalla e boshnjakëve" i kanë transferuar gratë dhe fëmijët në jug të Mitrovicës.

Në mahallen tonë jetojnë serbët dhe shqiptarët dhe marrëdhëniet janë të mira, por kur filloi konflikti te tre soliterat, rreth 100 serbë u nisën në drejtimin tonë. Ne ishim të gatshëm që t'i braktisim shtepitë, por serbët janë kthyer. Në natën e 17 marsit mbi mahallën tonë është gjuajtur nga snajperi dhe është goditur Boshnjaku Nerman Maliq. Menjëherë është transferuar në spitalin e Prishtinës ku është operuar. Një ditë më herët, KFOR-i Polak ka evakuar serbët që jetojnë në mahallen tonë. Ne kemi kundërshtuar, por pa rezultat. serbët na i kanë dorëzuar

çelsat që ne të kujdesemi për banesat e tyre. Deri më tash asgjë nuk iu ka munguar nga shtepitë dhe besoj se së shpejti do të kthehen.

U.N. Boshnjak nga Mahalla e boshnjakëve, veriu i Mitrovicës
FDH intervistë 25 mars 2004

1.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së

Është evidente që policia e UNMIK-ut nuk e ka percjellur situatën në jug të Mitrovicës. Pas publikimit të lajmit se jane mbytyr në lum tre djem nga fshati Çabër.Tubimi i grupeve të vogla te shqiptarëve më 16 mars në mbrëmje ka kaluar heshturazi. Disa shqiptarë nga jugu i Mitrovicës, të cilët punojnë per UNMIK-un dhe OSBE-në i kanë lajmëruar kolegët në veri të Mitrovices që nesër mos të vijne në punë, sepse do të ketë protesta rreth urës.Më se paku me këtë informate kanë disponuar pjesetarët e SHPK-s. Fakti që ky shërbim nuk e ka paralajmruar policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in për rrezikun e sulmit në veri të Mitrovcës është pasojë e raporteve të institucioneve ndërkombëtare ndaj SHPK-së. Ky shërbim është organizuar si polici e komunikacionit. Nuk merr pjesë në ndërmarrjen e masave që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve dhe pjesëtarëve të pakicave. Informatat qe i merr në kontakt me qytetarë, me rastin e punëve në teren, nuk ka kujt me ia kumtuar, sepse nuk ka komandë të perbashkët dhe procedurë për vendosjen e komunikimit.

Policia e UNMIK-ut ka treguar që nuk mund ta kontrolloj situatën dhe nuk ka autoritet. Për ndryshim nga policia e UNMIK-ut KFORI ka treguar që shume mire i njeh problemet lidhur me veriun e Mitrovicës, gjë që ka kontribuar që shumë shpejtë të organizohen dhe t'i pengojë shqiptarët e anës jugore të Mitrovicës në përpjekjet e tyre për ta "liruar" anën veriore të Mitrovicës.

1.2. Pasojat

Gjatë 17 dhe 18 marsit në Mitrovicë janë vrarë gjashtë persona: Fatmir Abdullahu, Ferid Çitaku, shqiptarët nga lagjeja Shipol e anës jugore të Mitrovicës; Isak Ibrahimi nga fshati Shupkoc, Ajvaz Shatrolli nga veriu i Mitrovicës, Maqedonja Jana Tuçe dhe serbi Borivoje Spasojeviq nga veriu i Mitrovicës. Sipas raportimeve te mediave kosovare, janë lënduar 11 pjesetarë të KFOR-it dhe dhjetëra pjesetarë të policisë ndërkombëtare dhe SHPK-së.

Në vendbanimin " tre solitera " dhe në " mahallën e boshnjakëve " janë kthyer shqiptarët dhe serbët, të cilet i ka evakuar KFOR-i më 17 mars. Banesat e tyre nuk janë të plaçkitura.

2. Djegija e shtëpive në fshatin Frashër

Sulmi mbi serbët në fshatin Frashër ka filluar më 18 mars rreth orës 15:00. Disa qindra shqiptarë nga pjesa jugore e Mitrovicës u nisën në drejtim të fshatit, në të cilin jetojnë edhe shqiptarët, duke brohoritur UÇK, Hashim Thaqi, dhe Ramush Haradinaj. Demonstrueit menjëherë kanë filluar t'i djegin shtëpitë dhe t'i maltretojnë serbët, të cilët iknin nga shtëpitë e djegura. serbët nga qendra e fshatit u organizuan dhe filluan rezistencë të armatosur, derisa

KFOR-i francez arriti, iu mori armët dhe i evakuoi nga fshati.[5] serbi Sllobodan Tanjiq/Slobodan Tanjić u zhduk gjatë evakuimit. Të gjitha shtëpitë serbe janë plaçkitur dhe djegur. Në shtëpitë shqiptare janë vendosur flamuj shqiptarë, çka ishte edhe sinjal për demonstruesit se cila shtëpi nuk është shqiptare. Në sulme ndaj serbëve dhe djegëjën e shtëpive të tyre morën pjesë edhe fqinjët e tyre shqiptarë.

Shitore e djegur e Serbëve në fshatin Svinjare. © FDH

Më 18 mars rreth orës 15:00, një grup i madh i shqiptarëve nga ana jugore e Mitrovicës iu afrua fshatit, duke bartur flamuj shqiptarë. KFOR-i nuk u angazhua për t' penguar. Ata brohoritnin:" UÇK, Hashim Thaqi dhe Ramush Haradinaj". Unë gjindesha në shtëpinë time në qendër të fshatit dhe shikoja se si afrohen. Mbi shtëpinë në fund të fshatit ishte i vendosur flamuri shqiptar. Pronari shqiptar i shtëpisë e dinte se do të na sulmojnë, prandaj e ka vendosur flamurin, me qëllim që mos t'ia djegin shtëpinë. Kur arritën demonstruesit deri te shtëpitë e para serbe i kam parë duke gjuajtur gurë, duke thyer xhamat e dritareve, duke i dëbuar njerëzit nga shtëpitë . Së shpejti 5-6 shtëpi ishin në flakë. Njerëzit që u larguan nga shtëpitë, policia e UNMIK-ut i dërgoi deri në qendër të fshatit, ndërsa pastaj gratë dhe fëmijët i transferuan në bazën e KFOR-it, e cila është në afërsi të fshatit.

D.B. Serb nga Frashëri
FDH instervistë 25 prill 2004

[5] Banorët e fshatit Frashër: na ka zhgenjyer KFOR-i, BLIC, 22 mars 2004

Arritëm që t'i marrim vetëm dokumentet personale. Menjëhere pasi që dolëm, shqiptarët hynë në shtëpi dhe e djegën. E vranë edhe qenin në oborr. Automjeti i policisë së UNMIK-ut na ka transportuar deri në pjesën tjetër të fshatit. Atje na priti autobusi i KFOR-it dhe na dërguan në bazë. Derisa shkonim në drejtim të bazës kaluam nëpër pjesën shqiptare të fshatit. Në çdo shtëpi shqiptare ishte i vendosur flamuri shqiptar dhe dëgjohej muzikë. Fqinjët shqiptarë kishin filluar që të festojnë. Nga baza e KFOR-it, e cila gjendet në kodrën afër fshatit shikonim se si shqiptarët plaçkisnin dhe i djegënin shtëpitë e mbetura në fshat. Nga baza jemi transferuar në Mitrovicë, e pastaj në Zveçan ku tani gjindemi në ndërtesat e papërfunduara pa rryme dhe ujë.

M.T. Serbe nga Frashëri/Svinjar
FDH intervistë 7 prill 2004

Më datën 18 mars rreth orës 15,00 në pjesën shqiptare të fshatit janë tubuar të gjithë shqiptarët. Filluan të mledhin gurë dhe u nisën në drejtim të shtëpive serbe. Disa prej tyre kishin në duarë shufra të drurit dhe të hekurit. Shtëpia ime ishte e para me radhë. Disa qindra shqiptarë, dukshëm të tërbuar, filluan me gurë që të gjuajnë mbi shtëpinë time. Xhamat në dritare ishin plotësisht të thyera dhe në shtëpi u hodhën shumë gurë. Friksoheshim që të qëndronim brenda për shkak të mundësisë se do të gjuajnë bomba, por kishim frigë edhe të dalim, sepse në afërsi dëgjonim të shtëna. Atëhere nje grup i shqiptarëve hyri në shtëpi dhe na nxori që të katërt në oborr, ndërsa ne qëndronim dhe shikonim se si hynë në shtëpi dhe i merrnin orenditë tona. Asgjë më të keqe nuk kam parë në jetë. shqiptarët i kanë vjedhur të gjitha që ne me vite i kemi krijuar, madje edhe gjërat që nuk i nevojiten askujt. Pastaj filluan të gjuajnë shishe me benzinë dhe t'i djegin shtepitë.U përpoqëm që ta shuajmë zjarrin, por shqiptarët na gjuanin me gurë. Në këtë moment arriti automjeti i UNMIK-ut, i cili na mori. Në rrugë deri në bazën e KFOR-it, kemi parë fqinjët tonë se si plaçkisin, djegin dhe shkatrojnë shtëpitë në fshat.

R.J. Serbe nga fshati Frashër
FDH inervistë 7 prill 2004

2.1. Veprimi i KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut

KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut kanë organizuar evakuimin e serbëve nga fshati, pa e penguar plaçkitjen dhe djegëjen e shtepive të tyre.

Unë nuk mund të kuptoj se KFOR-i ka lejuar që të na dëbojnë nga fshati, kur baza e tyre gjindet në afërsi.

M.T. Serbe nga fshati Frashër
FDH intervistë 7 prill 2004

Unë e luta një polic të UNMIK-ut që të na transferojë në bazën e KFOR-it që gjindet në kodër afër fshatit. Kam kuptuar se pa KFOR-in, policia e UNMIK-ut nuk është në gjendje që të angazhohet për mbrojtjen e pasurisë sonë. Antiqi dhe unë jemi transferuar me automjetin e UNMIK-ut deri në bazë. Atje na priti një oficer Belg. E lutëm që ta dërgojë ushtrinë në fshat dhe ta shpëtojë pasurinë tonë. Ai tha se mund t'i dërgojë 30 ushtarë të Luksemburgut dhe 20 Marokien për të na siguruar në qendër të fshatit, ndërsa për shtëpitë që gjinden në periferi nuk mund të garantoj. Nuk deshi të na dëgjojë, ndërsa ne shikonim se si shtëpitë në periferi tani më

digjeshin. Me dorë ia tregoja pamjen para nesh, ndërasa ai vetëm i uli krahët. Ne i pranuam kushtet e tij . U kthyem në qendër të fshatit ku njerëzit ishin tubuar. Pranë tyre ishin disa ushtarë Marokien dhe disa policë ndërkombëtar. Menjëherë pasi që dolëm nga automjeti ushtarët e KFOR-it bukvalisht na kanë detyruar që të hyjmë në kamiona. Kemi bërë përpjekje që të shpjegojmë se nuk dëshirojmë t'i braktisim shtëpitë tona dhe jemi të gatshëm t'i mbrojmë me jetërat tona. Për keqardhje, me dhunë jemi detyruar të hyjmë në kamiona dhe jemi dërguar në bazën e KFOR-it në afërsi të fshatit. Rrugës shihnim shqiptarët që po festonin nëpër fshat, këndojnë këngët për UÇK-në, plaçkisin dhe djegin shtëpitë tona, derisa ushtarët e KFOR-it shikojnë qetë se çka po ndodhë. KFOR-i dhe UNMIK-u janë në mënyrë direkte përgjegjës për këto që ndodhën në fshatin tonë. Ata i lejuan shqiptarët që ta shkatërrojnë fshatin tonë, edhe pse kanë pasur mundësi që ta pengojnë.

D.B. Serb nga fshati Frashër
FDH intervistë 25 prill 2004

2.2. Pasojat

Të gjithë 200 serbë janë dëbuar nga Frashëri. Institucionet shqiptare kanë vlerësuar dëmin, por ky dëm sipas vlerësimeve të serbëve nuk i përgjigjet gjendjes reale. Më një qershor ka filluar renovimi i 30 shtëpive, prej 134 sa janë djegur më18 mars.[6]

3. Bllokimi i rrugëve dhe konflikti në Çagllavicë

Me pesëmbdhjetë mars në Çagllavicë rëndë është plagosur serbi Jovica Iviq (18) mbi të cilin kanë shtënë disa herë sulmuesit e panjohur. Në shenjë proteste, serbët kanë mbyllur rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë – Gjilan. Ata të cilët bënin përpjekje që të kalojnë i maltretonin dhe gjuanin me gurë. Blokimi ka vazhduar deri në orët e hershme të pasditës, me 17 mars. Të provokuar me reagimin e serbëve në Çagllavicë, të dëshpruar me vdekjen e tre djemëve nga fshati Çabër dhe në shenjë përkrahjeje shqiptarëve nga ana jugore e Mitrovicës, pjesëmarrësit e demonstratave në Prishtinë, në mesin e të cilëve kishte shumë të rinjë, u nisën në drejtim të Çagllavicës.[7]

KFOR-i , policia e UNMIK-ut dhe SHPK në hyrje të fshatit kanë vendosur kordonin të cilin masa e demonstruesve shqiptarë e ka thyer dhe ka filluar djegëjen e shtëpive serbe në fillim të fshatit. Gratë dhe fëmijët janë fshehur nepër shtëpi, derisa një grup i meshkujëve ka organizuar mbrojtjen në qendër të fshatit, ndërsa grupi tjetër u nisë në drejtim të shqiptarëve. Në sulmin e demonstruesëve shqiptarë me armë automatike u plagosën serbi Nenad Gjokiq, ndërsa Millorad Lekiq, gjithashtu serb është goditur nga snajperi. Në konfliktet me KFOR-in dhe serbet, kanë humbur jetën tre shtipatë: Bujar dhe Kastriot Elshani nga fshati Bajincë, komuna e Gllogovcit, ndërsa identiteti i shqiptarit të tretë nuk është theksuar.[8] Janë djegur dymdhjetë shtëpi serbe dhe dy shtëpi shqiptare. Gjatë konfliktit një numër i vogël i sërbëve prej gjithësej 1200 sa jetojnë në Çagllavicë janë larguar nga fshati.

---

[6] Serbet nuk i besojnë premtimeve të kota, VEČERNJE NOVOSTI, 2 qershor 2004
[7] Raporti i grupit ndërkombëtar i krizës *Kolapsi në Kosovë* 22 prill 2004: "Nxënësit në fshatin shqiptarë Ajvali në afërsi të Çagllavicës i liruan fëmijët nga orët për të shkuar në Çagllavicë.
[8] 16 të vdekur dhe 575 të lënduar në trazirat që përfshinë Kosovën, KOHA DITORE , 18 mars 2004.

Më datën 15 mars është plagosur një i ri serb, prandaj serbët nga Çagllavica dhe rrethina kanë bllokuar rrugën Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë – Gjilan. (...). Me datën 16 mars në lajme kanë paraqitur një djalosh, i cili dëshmoi se ate dhe tre djemtë e tjerë i kanë ndjekur serbët me qen dhe me këtë rast tre fëmijë janë mbytur në lumin Ibër, afër fshatit Çabër. Të nesërmën, paradite të gjitha stacionet televizive kanë emetuar ngjarjet në Mitrovicë, duke raportuar se janë disa të vrarë dhe mbi 500 të plagosur. Nuk e kisha njejtë. Në atë ditë, më 17 mars në 12,45 kam dalur nga banesa dhe kam parë se takstistat e kanë bllokuar komunikacionin (...). Një grup prej 70 njerëzish të moshës së mesme u nisë nga Prishtina në këmbë në drejtim të Çagllavicës. Nuk dëgjoheshin zërat. Thjeshtë vetëm ecnin në qetësi edhe unë u nisa me ata (...). Kështu ecnin deri në udhëkryqin ku ndahet rruga për Gjilan. Pak më larg (...) është vendosur kordoni i fortë, ndërsa ne u afruam dhe pritnim. Në ndërkohë arritën edhe më shumë njerëz nga Prishtina, kryesisht njerëz të rinjë. Policia (SHPK) më ka thënë që të kthehemi në Prishtinë. Disa njerëz filluan që t'i ofendojnë, madje edhe t'i kërcnojnë. Me disa u shtyenin, por policët nuk lejuanë të kalojmë (...) Pas gjysmë ore masa e njerëzve ishte e madhe. Pastaj disa të rinjë u kthen në anën e majt të rrugës ku ishte hapsirë e hapur dhe tentuan që ta anashkalojnë kordonin, por policët e zgjeruan kordonin e vet. Në këtë mënyrë u dobësua kordoni. Kordoni u thye dhe njerëzit në grupe të vogla vraponin në drejtim të Çagllavicës (...) Kam vërejtur dy automjete të KFOR-it nga të cilët gjuanin gas lotësjellës, ndërsa në të njejtën kohë njerëzit filluan te gjuajnë me gurë. Rreth orës 15,00 kam vërejtur se si po digjej një shtëpi pas hotelit, ndërsa më pas edhe nga shtëpitë e tjera dilte tymi. Në atë moment dëgjuam edhe të shtëna (...) Unë vendosa që të kthehem në Prishtinë, sepse nuk e arsyetojë këtë që ka ndodhur. Isha i indinjuar për shkak blokimit të rrugës, por kjo nuk mund të jetë preteks për djegëjen e shtëpive serbe (...) Kur u ktheva në Prishtinë kam parë te unaza e qytetit dy automjete të UNMIK-ut. Më vonë kam dëgjuar se në Çagllavicë janë vrarë tre të rinjë të nacionalitetit shqiptarë. Dy ishin vëllezër nga Bajinca, ndërsa mendoj se i treti ishte nga Prishtina.

N.N. Shqiptar nga Prishtina, pjesëmarrës në demonstrata
FDH intervistë 18 prill 2004

Bllokimi i rrugës ka vazhduar deri me 17 mars. Atë ditë shqiptarët nga Prishtina u nisën në drejtim të Çagllavicës. KFOR-i , UNMIK-u dhe SHPK kanë vendosur kordonin në Veternik. Banorët e moshës së re të fshatit tonë gjindeshin në rrugën magjistrale, ndërsa gratë dhe fëmijët nepër shtëpi. Ekzistojnë disa shtëpi që gjinden në dalje të fshatit tonë në drejtim të Prishtinës. Aty ka edhe shtëpi shqiptare dhe është për qudi se atë ditë nuk është parë asnjë shqiptar. Ndoshta kanë ikur më heret. Në orët e hershme të pasditës një numër i madh i shqiptarëve arriti deri tek kordoni. Gradualisht kordoni është zgjëruar, sepse masa e shqiptarëve u nisë të kalojë nepërmes të arrave në fshatin tonë. Në këtë mënyrë kordoni ishte i thyer, ndërsa të rinjët e fshatit tonë janë tërhjekur ngadalë. Kur shqiptarët filluan që t'i djegin shtepitë tona, ne jemi tërhjekur në brendësi të fshatit. Nuk kemi pasur mundësi asgjë të marrim me vete. Të gjitha janë djegur së bashku me shtepinë (...) Në brendësi të fshatit, para shtëpisë së vet, u goditë Millorad Llekiq nga snajperi në krah. Thuhet se snajperisti ishte i vendosur në motelin shqiptar ne hyrje të fshatit tonë. Nenad Gjokiqi u goditë me armë zjarri në këmbë. Është plagosur edhe një serb, por nuk di se si quhet.

M.M. Serb nga Çagllavica
FDH intervistë 2 qershor 2204

Shtëpi Serbe e djegur në fshatin Caglavicë © FDH

3.1.Veprimi i KFOR-it, policies së UNMIK-ut dhe SHPK

Në valën e parë të demonstruesve shqiptar KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe SHPK nuk arritën që të organizohen dhe të pengojnë hyrjen e shqiptarëve në fshat. Pas arritjes së forcave Amerikane KFOR-i vendosi konrollin dhe pengoi shkatërrime më të mëdha të shtëpive dhe pasurisë sërbe. serbët nuk kanë vërejtje në sjelljet e forcave ndërkombëtare dhe policisë së Kosovës. Në konflikt me demonstruesit shqiptarë KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut kanë përdorur municion luftarak. Më 17 mars në mbrëmje KFOR-i ka vendosur kontrollin në fshat dhe pastaj nuk pati incidente.

KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe SHPK ishin të frikësuar. Ata kanë bërë përpjekje për t' i qetësuar shqiptarët, por pa sukses, sepse kishte shumë demonstrues. Kisha përshtypjen se ishin të befasuar dhe të papërgatitur. Kur shqiparët e thyen kordonin SHPK-ja dhe KFOR-i e humbën kontrollin dhe shqiptarët hynë në fshat (...) Rreth orës 23,00 arriti njësia e KFOR-it Amerikan, e cila vendosi postbllok të fortë në kodrën e Veternikut. Ata nuk i lejuan shqiptarët që të hyjnë në fshat. E di se ka pasur përpjekje edhe me 18 mars por askush më nuk ka patur mundësi për të hyrë në fshat. Tek ne pas 17 marsit nuk ka pasur trazira.

M.M. Serb nga Çagllavica
FDH intervistë 2 qershor 2004

Në mes të rrugës, dy nga dy, ishin parkuar gjashtë tanke të KFOR-it. Mbi dhe në tanke gjindeshin ushtarët. Mendoj se ishin Finlandezë. Kordonin e kanë vendosur edhe policia e UNMIK-ut edhe SHPK (...) Kam parë kur tre të rinjë e kanë thyer kordonin dhe filluan të vrapojnë në drejtim të Çagllavicës. Policët ndërkombëtar e kanë lëshuar qenin për t'i ndjekur. Qeni e kapi djaloshin për pantollona, ndërsa më pas polici ndërkombëtar e ka zëne të riun. Në këtë moment dy djem iu ofruan policit me gurë të mëdhenjë në duarë.Unë nuk di çka flisnin, por polici e liroi djaloshin dhe u nisën që të tretë në drejtim të Çagllavicës.

N.N. Shqiptar nga Prishtina
FDH intervistë 18 prill 2004

3.2. Pasojat

Sebët, shtëpitë e të cilëve janë të djegura tash jetojnë në qendrat kolektive në Graçanicë ose tek familjet e tyre në fshatrat serbe perreth . Atyre iu vjen keq pse fqinjët shqiptarë nuk iu ndihmuan në mbrojtjen e shtepive, meqë kishin raporte të mira. Kishte raste kur edhe serbët i kanë sulmuar banorët shqiptarë. Qetësia u kthye në fshat dhe shqiptarët pa probleme vijnë në Çagllavicë për të bërë tregëti me serbët.

Njerëzit, shtëpitë e të cilëve janë djegur, së pari janë vendosur në qendrën kolektive në Graçanicë, ndërsa tani janë ose tek familjet ose paguajnë qira. Në këtë pjesë të fshatit ka ende shtëpi serbe, të cilat nuk janë të djegura. Serbët në këto shtëpi jetojnë pa probleme.Edhe para këtyre ngjarjeve, por edhe tani kemi raporte të mira fqinjësore me shqiptarët, por këta fqinjë ose nuk kanë dashur ose nuk kanë guxuar që ta mbrojnë pasurinë tonë me 17 mars. Këtu në fshat jeton Bahtiu, shqiptar. Ai me 17 mars ishte te fqiu i tij serb duke pirë kafe. Të rinjët nga fshati ynë u nisën në drejtim të shtëpisë së tij, e gjuajtën me gurë dhe deshtën që ta djegin. Atëhere nga shtëpia doli djali i Bahtiut me revole, gjuajti ne ajër, kështu që masa është tërhjekur. Përgjatë magjistralës në drejtim të Laple Sellës një shqiptar ka depo të madhe. Këtë depo e kanë thyer serbët, kanë thyer xhamat dhe kanë vjedhur mallin. Për këtë jam i sigurtë, por mendoj se këta serbë janë nga Laplje Sella. Tani situata është e mirë. shqiptarët vijnë tek ne në fshat me qëllim të tregëtisë dhe nuk ka pasur kurrfar incidentesh. Njerëzit janë edhe më tutje të indinjuar por, e dijmë se dhuna nuk është zgjidhje. Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka dalur në vendin e ngjarjës dhe me sa di unë, së shpejti do të fillojnë punimet në renovimin e shtëpive të djegura.

M.M. serb nga Çagllavica
FDH intervistë 2 qershor 2004

4. Sulmi mbi serbët në Prishtinë

Grupi i parë i demonstruesëve është tubuar para ndërtesave ku jetojnë serbët rreth orës 18,00. Atyre iu bashkangjitën demonstruesve, që ishin duke u kthyer nga Çagllavica. shqiptarët kanë shtënë mbi ndërtesa, kanë gjuajtur gurë, kokteje të Molotovit, petarda dhe bomba. Serbët nga kati përdhesë janë tërhjekur në banesat e kateve më të larta. Rreth orës 22,00 demonsruesit kanë hyrë në ndërtesa dhe filluan me djegjen e banesave të katit përdhesë. Në praninë e numrit të vogël të policëve ndërkombëtar dhe kosovar, të cilët në mënyrë pasive shikonin ose iu ndihmonin demonstruesëve për vendosjen e zjarrit, demonstruesit pa penguar plaçkitnin

banesat e zbrazëta. Përveç banesave serbe ata djegën edhe një banesë shqiptare. shqiptarët nga banesat fqinje shikonin se si plaçkiten banesat. Kanë shuikuar se si një grup ka hyrë në banesa dhe i ka përkatitur çantat me gjësende, ndërsa grupi tjetër ka pritur në rrugë dhe i ka bartur çantat. Serbët në mesin e sulmuesëve ka njohur fqinjët e tyre shqiptarë. Nga ana tjetër për shkak të mosbesimit kanë refuzuar ndihmën, të cilën ia kanë ofruar fqinjët dhe të njohurit tjerë shqiptarë.

Me rastin e evakuimit demonstruesit me thikë kanë sulmuar dhe rëndë kanë lënduar Dragan Smilaniqin. Për të evakuar serbët pjesëtarët e KFOR-it kanë përdorur armë zjarri. Një predhë i rastit e goditi një shqiptare, e cila jetonte në katin përdhesë të ndërtesës së YU programit. Lehët është lënduar një rumune, pjestare e policisë së UNMIK-ut. Grupi i fundit i serbëve, 33 sish janë evakuar në orën 02:00 me ndihmën e partollës së policisë Amerikane. Gjatë demostratave në Prishtinë ka pësuar shqiptari Agron Ramadani. Ditën e ardhme me 18 mars është djegur kisha e Shën Nikollës në qendër të Prishtinës.

Automjete të djegura të serbëve përpara ndërtesës YU program në Prishtinë © FDH

Ndërtesa ku unë jetoj është pas ndërtesës së YU programit.Rreth orës 2l:00, shokët më kanë thirrur me telefon që të dalim dhe të shohim se çka po ndodh. Kam shkuar deri në unazën e qztetit, në dalje të qytetit, në rrugë për Shkup. Kemi parë dy automjete të UN-së duke u djegur. Kishte shume njerëz të cilët u kthenin në këmbë nga Çagllavica. Ishin edhe disa policë në afërsi. Ne u nisëm për t' u kthyer në shtëpi (...) Ngjietesha shkallëve kur e dëgjova një zë, si të

ishte ndonjë petardë. Shokët më thirrën dhe më thanë që ta ndali dritën dhe mos të dal më sepse një i ri është vrarë në rrugë. Në orën 22,45 e kam dëgjuar një zhurmë të madhe, njerëzit me gurë i gjuanin ndërtesat serbe. Pastaj kam parë zjarrin dhe kam dëgjuar eksplodimin e bombës. Kam parë se si i kanë gjuajtur tri-katër koktej të Molotovit mbi ndërtesa. Zjarri është zgjëruar deri në katin e katërt. U frikësova se do ta gjuajnë edhe ndërtesën time, kështu që dola jasht. Jasht qëndrova rreth gjysëm ore. Duke u kthyer në shtëpi para ndërtesës sime kam parë që edhe më tutje janë duke gjuajtur ndërtesën e YU programit me gurë dhe koktej të Molotovit. Disa djemë gjuajtën automjetin e madh të UN i cili qarkullonte përgjatë rrugës kryesore. Në këtë kohë kishte shumë më tepër njerëz dhe nuk ishin të gjithë të rinjë (...) Kam parë grupe të vogla prej 4-5 njerëz, të cilit kanë hyrë në banesat e YU programit. Kanë kontrolluar banesat dhe i kanë mbushur çantat e zeza, të cilat me litar i kanë lëshuar në tokë, derisa të tjerët i pritnin dhe iknin. E gjithë kjo zgjati deri në orën 01:00 pas mesnate. Derisa digjeshin banesat, në katin e pestë të një ndërtese kishte njerëz. Disa automjete janë djegur në parkingun e ndërtesës. Nga ana e majtë arriti një grup i madh i policëve të UNMIK-ut dhe diçka krijonte xixa nëpër tokë.

N.N. Shqiptar nga Prishtina
FDH intervistë 23 mars 2004

Një javë para këtyre ngjarjeve duke u kthyer në shtëpi kam vërejtjur një patrollë të SHPK-së se si kujdestaron para ndërtesës sonë. Unë i kam pyetur policët pse qëndrojnë aty, ndërsa ata mu përgjigjen pse aty gjenden për shkak të sigurisë sonë. Mua mu ka dukur e dyshimtë sepse policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së, disa muaj më herët, ka ndërprerë kujdestarinë para ndërtesave tona. Më 17 mars (...)ishin tri sulme mbi ndërtesën tonë. Më i rëndi ishte i fundit, i cili filloi rreth orës 22. shqiptarët kanë shtënë në ndërtesën tonë. Këtë e kanë bërë edhe fqinjët tanë shqiptar nga ndërtesat e afërta. Serbët nga hyrjet tjera KFOR-i i ka evakuar më herët. Kanë thyer dritaret tona dhe kanë gjuajtur koktej. Kështu e kanë djegur një banesë në katin e parë. Banorët e hyrjes sonë janë tërhjekur në një banesë në katin e pestë, e cila ka pasur derë të fortë me hekra. Ishim 33 vetë në këtë banesë me disa fëmijë (...). Tymi nga kati i parë ngjitej lartë dhe nuk mund të merrnim frymë.Unë kam menduar që të kërcejë nga terraca, nëqoftëse ata hyjnë brenda. Me ne ishte edhe i biri im pesë vjeçar dhe frikësohesha për te (...). Evakuimi i njerëzve nga hyrja jonë ka zgjatur disa orë. Më së rëndi ishte para hyrjes kur është dashtë të shkojë deri te transporteri KFOR –it. Këtu e kam humbur kontaktin me fëmijen. Disa herë kanë gjuajtur mbi ne, rumunja nga policia ndërkombëtare bukvalisht më ka shtyrë nën një automjet dhe më ka mbuluar me trup të saj. Kur hyra në automjet, kam vërejtur se nuk është djali im me mua. Kam ngarë jashtë dhe kam filluar ta kërkojë fëmijen. Askush nga serbët nuk deshi të niset pa fëmijen tim dhe të gjithë filluan të dalin nga transportuesi. E kemi gjetur në një automjet të KFOR-it.

V.B. Serbe nga Prishtina,YU program
FDH intervistë 30 mars 2004

Bashkëshortja ime ka vërejtur se në ballkonin tonë digjej zjarri. Arrita shpejt që ta shuaj. Fqinjët e mijë të parë më ofruan ndihmën por unë e refuzova.

D.R. Serbe nga Prishtina, YU program
FDH intervistë 8 maj 2004

Nga ballkoni e kam pa një të ri të cilin unë e njohë. Ishte ky floktari Agroni. Ai e ka gjuajtur koktejin e Molotovit në ballkonin tonë. Kishte fanellë ngjyrë vjollce. Unë e kam parë edhe Bekimin i cili është gjithashtu fqiu ynë. Ishte saktësisht 10:45 kur e kanë gjuajtur koktejin mbi mua dhe me quanin me emrin ofendues "shkinë" .

L.R. Serbe nga Prishtina
FDH intervistë 8 maj 2004

4.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së

Disa pjesëtarë të SHPK-së i kanë përkrahur edhe demonstruesit. Sipas dëshmive të serbëve disa policë të Kosovës kanë ndihmuar demonstruesit që të hyjnë në ndërtesa, ndërsa disa me shkrepsa të tyre i ndeznin koktejet e Molotovit, të cilat demostruesit pastaj i gjuanin në ndërtesa. KFOR-i ka evakuar serbët nga ndërtesa e YU programit, por nuk bëri asgjë për ta siguruar kishën e Shen Nikollës, të cilën demostruesit me 18 mars e kanë djegur, por e ka evakuar vetëm priftin.

Në momentin kur e kam vërejtur grupin e njerëzve, i cili rreth orës 18:30 është nisur në drejtim të ndërtesës sonë, kam kërkuar ndihmën nga SHPK-ja. Ata më kanë bindur se situata është nën kontrollë dhe nuk duhet të frikësohem, por që mos të dal nga banesa. Pasi që kam dëgjuar se është gjuajtur kokteji i Molotovit në hyrjen nr. 23, sërish kam thirrë SHPK-në, por prap kanë përsëritur që situata është nën kontrollë. Së shpejti kam dëgjuar zhurmën para ndërtesës e pastaj kanë filluar sharjet, gurët, shkopinjët dhe të tjera që demonstruesit kishin në dorë. Kam parë policët e Kosovës (shqiptarët) se si qëndrojnë me demonstruesit së bashku. Pritja që policia do të na merr në mbrojtje. Kam pasur përshtypjen që policët në të vëretë na kontrollojnë neve, që ne rastësisht mos të bëjmë rezistencë. Me rastin e evakuimit kam vërejtë snajperistët dhe mendoj se kanë qenë nga SHPK. Asgjë nuk kanë bërë vetëm janë fshehur. Nuk kanë bërë përpjekje për të na mbrojtur.

D. S. Serb nga Prishtina YU program
FDH intervistë 8 maj 2004

Kur një grup djelmoshas rreth 15 vjeç tentoi të hyjë në hyrjen tonë SHPK i pegoi. Megjithatë më vonë kur numri i demonstruesëve është rritur, atëhere SHPK-ja i ka lejuar që të hyjnë në banesa. Nuk na kanë ofruar kurrfar mbrojtje. Neve na ka evakuar KFOR-i në momentin e fundit dhe pasi u plagosë Dragan Smiljaniq.

L.S. Serbe nga Prishtina, YU program
FDH intervistë 8 maj 2004

Atë natë isha në detyrë. SHPK e ka kallur veturën time. Pastaj kanë hyrë në banesën time dhe ma kanë vjedhur një pjesë të uniformës. Kur i kam gjetur gjerat e vjedhura të mija personale në stacion policor nr. 4, kam kërkuar të më shpjegojnë kush në të vërtetë e ka marrë uniformen time. Përgjigjen kurrë nuk e kam marrë. Nuk mund të pohoj që të gjithë pjestarët shqiptarë të SHPK-së kanë qenë të përzier në trazirat e marsit, por një pjesë e madhe po. Këtë ia kam kumtuar edhe atyre.

Serb nga Prishtina, polic i Kosovës
FDH intervistë 8 maj 2004

Shumë herë e kam thirrë policinë dhe ata më kanë thënë se njësitë e tyre janë aty. Megjithatë, ata i kanë ndihmuar vetëm dhunës. Unë kam pa policin, i cili me shkrepsë të vet e ka ndezur koktejin dhe ia ka dhënë demonstruesit, i cili pastaj e ka gjuajtur mbi ndërtesën tonë. E kam thirrë mikun shqiptar, i cili punon në zyrën amerikane dhe i kam thënë se e pati puna jonë. Ai tha se do të vij me pjesëtarët e KFOR-it amerikan. Arritën në momentin e fundit dhe na evakuan.

V.B. Serbe nga Prishtina, YU program
FDH intervistë 30 mars 2004

Iu kam drejtuar për ndihmë patrollës së SHPK-së, e cila në atë moment gjindej para hyrjes sime. E kanë marrë deklaratën time dhe më kanë premtuar që së shpejti do të arrijë përforcimi, edhe pse unë këtë përforcim të policisë nuk e kam parë deri në momentin e evakuimit. Pas bisedës së zhvilluar, SHPK është tërhjekur deri te Aliu (shqiptar) pronar i shitorës në një ndërtesë të YU programit. Mendoj që SHPK-ja ka qenë lidhja me demonstruesit.

D.R. Serb nga Prishtina, YU program
FDH intervistë 8 maj 2004

4.2. Pasojat

Të gjithë serbët e ndërtesave të YU progamit janë zhvendosur. Qeveria e Kosovës me 27 mars ka publikuar rekonstruimin e banesave të shkatëruara në ndërtesat e YU programit. Punimet i hapi kryeministri Bajram Rexhepi. Komisioni ka vlerësuar dëmet dhe ka konstatuar se 20 banesa plotësisht janë të shkatërruara dhe 50 pjesërisht. Banorët e parë *janë* kthyer me 27 prill. Për shkak të ankesave të serbëve për lëshimet në punime, Komisioni për renovimin e objekteve ka urdhëruar revidimin e punimeve.

Banesat tona janë plotësisht të shkatërruara dhe jo vetëm banesat ku kanë jetuar serbët, sepse këtu kanë banuar të punësuarit e UNMIK-ut dhe policët ndërkombëtar. Një pjesëtare rumune e cila është në shërbim të policisë ndërkombëtare ia kanë gjuajtur derën. Banesa ime për fat nuk është e djegur, mirëpo gjërat janë krejtësisht të plaçkitura dhe të demoluara. Kur e vizitova banesën, gjeta fotografinë e fëmijut tim të prerë me thikë dhe kolltuqet e prera thikë.

V.B. Serbe nga Prishtina/YU programi
FDH intervistë 30 mars 2004

5. Asgjësimi i objekteve publike, shtëpive dhe rahja e serbëve në Fushë- Kosovë

Në shenjë përkrahjeje shqiptarëve nga ana jugore e Mitrovicës, një grup shqiptaresh ka penguar nisjen e trenave nga stacioni hekurudhor i Fushë-Kosovës, të cilët është dashur të nisen në orën 14:00. Menjëherë pastaj demosntruesit kanë filluar djegjen e ndërtesave në të cilat kanë qenë të vendosura institucionet paralele; shtëpia e shëndetit, komuna dhe PTT e Serbisë në hyrje të Fushë-Kosovës në fshatin Bresje. Pas kësaj është djegur edhe shkolla "Sveti Sava". Serbet konfirmojnë se zarrëfikësit që gjindeshin para objekteve të ndezura nuk e kanë fikur zjarrin. Kanë reaguar vetëm në rastet kur është kanosur rreziku që zjarri të përhapet në shtëpitë shqiptare. Serbet gjithashtu dëshmojnë se shqiptarët kanë sjellur cisterna me benzinë

me të cilën e kanë lagur shtëpinë e shëndetit, komunën dhe postën si dhe shtëpitë serbe përreth. Sipas të dhënave të komisionit për vlerësimin e dëmeve në demontrata janë asgjësuar 106 shtëpi serbe me objekte përcjellse dhe dy kisha ortodokse. Kisha e Shën Nikollës dhe Kisha e Shën Katarinës. Në këto sulme nuk është kursyer as prona e atyre serbëve, të cilët kanë dëshiruar që t'i mbrojnë fqinjët e tyre shqiptarë. Dëshmitarët nga vendi i ngjarjes, sidomos viktimat, tregojnë për sjellje të vrazhdë të demonstruesve ndaj serbëve të cilët i kanë takuar në shtëpitë e tyre ose në rrugë.

Rreth 3.000 të rinjë shqiptarë, rreth orës 14:00 kanë bllokuar rrugën Fushë Kosovë- Bresje. Kolonën e demonstuesve e kanë siguruar SHPK. Sipas fjalëve të serbëve, të cilët i përscjell "DANAS" polici i caktuar kosovar Isa nga Dubrava e Epërme u ka parapri demonstruesit kur ata kishin filluar ta gjuajnë me gurë shtëpinë e shëndetit ku gjendeshin afër 20 punëtorë dhe 2o të sëmuar. Pas pesë – dhjetë minutash ka arritur ekipi i zjarrfiksëve, mirëpo demonstruesit e kanë penguar që ta fikin zjarrin. Serbët kanë pa edhe cisternën tjetër për të cilën konfirmojnë se ka qenë e mbushur me benzinë me të cilin demonstruesit i kanë spërkatur objektet serbe e pastaj i kanë ndezur. Pas shtëpisë së shëndetit demonstruesit i kanë ndezur edhe shtepitë serbe kundrullë saj, në mes të të cilave edhe një lokal serb. Kanë vazhduar pastaj drejtë qendrës shkollore "Sveti Sava" dhe e kanë djegur, si edhe shtëpitë serbe perreth shkollës. Gjatë këtyre ndodhive demonstruesit e kanë rrahur Trifun Stojiloviqin dhe kanë mbytur Zllatibor Trajkoviqin. Të enjtën më 18 mars janë djegur edhe dy shtëpi serbe, kurse gjatë natës edhe 20. Të njejtën ditë është djegur edhe kisha e "Shën Nikollës". Rëndë është rrahur edhe Predrag Jovanoviqi[9]

Nuk ka pasur kurrfarë shenjash se kjo do të ndodhë. Unë shpesh kam shetitur lirisht mbrëmjeve nepër Fushë Kosovë. Kam pasur shokë shqiptarë (...) Në Fushë Kosovë janë djegur 106 shtëpi. Ditën e parë, kur demonstratat kanë filluar, është djegur spitali, shkolla "Sveti Sava" dhe Posta, kurse pastaj kafeneja "Zhivin Gaj" dhe të gjitha shtëpitë përreth shkollës. Rreth orës 15:00 masa e cila kishte mbi 5000 njerëz ishte tubuar. Nuk e kam njohur askend sepse bartnin shamija dhe syze. Kanë brohoritur llojlloj parulla. Ka pasur edhe cisternë me benzine, kanë hedhur kokteje në kafenenë "Zhivin Gaj", pronar i së cilës është xhaxhai im. Jemi përpjekur ta fikim zjarrin, por pa sukses(...). Atë ditë është rahur Trifun Stojiloviq,. Ai është përndryshe polic, njeri i moshuar. E kanë shtri për tokë, e kan shkelmuar. Ishte i përgjakur. Policët e SHK kanë shikuar duke e rahur dhe asgjë nuk kanë ndërmarrë për ta mbrojtur. Më vonë kemi dëgjuar se Trajkoviq Zllatibor është i djegur në shtëpinë e vet(...). Mbi 50 veta e kanë prishur rrethojën tonë, dhe kanë gjuajtur kokteje. Të gjithë jemi tubuar në oborrin tim. Ujin e kanë ndërpre. Policët na kanë thënë se kemi vetëm 5 minuta per të daluar nga oborri. Unë e preva telin në rrethojë, që me automjete të largohemi nga masa. Ishim rreth 25 deri 26 anëtarë të familjes. Nuk kam dashur të mbetem në shtëpi dhe ta mbrojë shtëpinë, sepse kam dëshiruar që të jetoj. Në momentin kur jamë larguar shtëpia ime ishte ende e paprekur. Ajo është djegur në natën ndërmjet 17 dhe 18 marsit (...). Shtëpia është lyer me benzinë dhe të gjitha janë djegur. I kanë marrë edhe gjërat e vlefshme, teknikën kryesisht, të

[9] Dëshmitë mbi ditët tragjike, "Danas" 30 mars 2004.

gjtha të tjerat janë djegur. Madje është djegur edhe WC fushore. Nga oborr i kanë marrë edhe pulat zbukuruese.

D.V. Serb nga Bresja, të cilit iu eshtë djegur shtëpia dykatëshe
FDH intervistë 28 mars 2004

Tërë jetën jetoj në Bresje ku e kam mbajtur kafenen "Zhivin Gaj" Aty ishin të punësuar të gjithë anëtarët e familjes sime dhe nga kjo punë kemi jetuar (...). Më 17 mars kafeneja ime ka punuar. Rreth orës 15:00 kemi dëgjuar zhurmën nga drejtimi i Fushë Kosovës. Një numër i madh shqiptarësh ishte nisur rrugës kryesore në drejtimin tonë. Atëhere e kam mbyllur kafenen dhe me anëtarët e tjerë të familjes kam shkuar në katin e dytë, duke menduar se ata vetëm do të kalojnë rrugës kryesore. Megjithatë ata kanë filluar të gjuajnë gurë në drejtim të shtëpisë sonë, e pastaj e kanë djegur kioskun, të cilin e kam pasur para restoranit. E kanë djegur edhe automobilin e Simiq Grujicës, i cili ishte i parkuar para kafenesë sime (...). Pastaj kanë thyer restoranin me gurë dhe mjete tjera. Pas një kohe të konsiderueshme jemi fshehur në shtëpinë e nipit tim Dojqin, e cila gjendet pas shtëpisë sime. Demonstruesit (...) kanë filluar të gjuajnë kokteje mbi restoran. Me të birin tim nepërmjet derës anësore kam hyrë në restoran dhe i kam shymur koktejet (...) . Për të ikur nga masa Dojqini u detyrua që ta prenë rrethojën. Me veturë kemi dalë në rrugën anësore dhe kemi shkuar në brendësi të Bresjes. Kjo ka ndodhur rreth orës 16:00 dhe 17:00. Më vonë kam kuptuar se në orët e vonshme të mbrëmjes kanë gjuar kokteje edhe në katin e epërm, kështu që shtëpia është djegur tërësisht. Unë nuk mund të parashikojë vlerën e të gjitha gjërave që i kam pasur në shtëpi. Unë kam pasur orendi të mira dhe paisje për restoran. Kam pasur kompjuterin dhe gjërat tjera me vlerë. I kam pasur dhjetmijë euro, ndërsa dhëndri im dymijë euro. Gjithashtu kemi pasur edhe dinarë, në vlerë prej pesqind euro, kam pasur 16 tavolina dhe 60 karriga. Ari i gruas sime është djegur. Nuk kam vërejtur se diqka është marrë nga shtëpia ime, të gjitha janë djegur.

M.V. Serb nga Bresja
FDH intervistë 1 prill 2004

Unë jam me prijardhje nga Vranja. Në Fushë Kosovë kam ardhur që të punojë si policë para 20 vitesh. Të gjithë njerëzit nga Fushë Kosova dhe rrethina më kanë njohur. Tash jam në pension. Më 17 mars kam dëgjuar se shqiptarët demonstrojnë në qytet. Në këtë kohë biri im ishte në banesën në qendër të Fushë Kosovës, afër stacionit të hekurudhës. U nisa tek ai, por nuk e gjeta në banesë (...). Me rrugë anësore jamë nisur për në shtëpi. Dojqini dhe disa serbë të tjerë, të cilët ishin në oborrin e tij nuk më lejonin të shkoj, por të mbes tek ata. Por gjithmon kam menduar në të birin tim sepse nuk dija se ku ishte. Kur arrita në kafene Bonstil kam parë një grup njerëzish të cilët vinin nga drejtim i shtëpisë së shëndetit. Sipas vlerësimit tim ishin rreth 100. Një prej tyre mu drejtua me fjalë fyese "ku po shkon ti shka"? nuk u përgjigja. Më goditi me grusht në kokë. U shtriva dhe e mbrojta kokën me duar. Asgjë tjetër nuk më kujtohet, as me çka më kanë rrahur as sa persona. Kur më erdhi vetëdija kam parë se ata nuk ishin më aty. Kisha shumë dhëmbje. Syri i majt ishte i mbyllur. Në këtë moment kam parë masën në rrugë, 30 deri 40 metra më larg. Dy policë (SHPK) e penguan masën që të shkojë në drejtim të shtëpive serbe. Ngadal u nisa nepërmes oborreve serbe. Pastaj erdhi djali im, i cili në ndërkohë është kthyer në shtëpi (...). Këtu arriti edhe një polic ndërkombëtar, mendoj se ishte gjerman. Djali im më dërgoi me veturë, në përcjellje të veturës zyrtare të këtij polici në drejtim të Llapna Sellës. Edhe pse isha i përgjakur nuk e kam vërejtur se jam i therurr me thikë. Pasi që arrita në spitalin e Graçanicës unë edhe mjekët e kemi vërejtur se jam i therrur. Kisha katër

therrje. Një ishte nën bri, e dyta në pjesën e kofshës së djathtë dhe dy therrje më të vogla në anën e djathtë. Kisha lëndime në të dy këmbët dhe kokë (...) pastaj jam transferuar për mjekim në Beograd. Për këto ngjarje kam kuptuar kur jam kthyer në shtëpi. Në ndërtesën "Llepa Brena" banesa e djalit tim dhe banesat e 4 vamiljeve serbe janë të plaçkitura. Në Graçanicë në spital kam parë Jova Qirkoviqin nga Kuzmini. Kishte geler në këmbën e majt. Kam parë Radivojeviq Doca - ai kishte plumb në kofshën e djathtë. Kam parë Stana Maksimoviqin e cila ishte e rrahur. Gjithashtu kam parë edhe Kalesiq Stana, të cilës ia kan djegur duarët me cigare, Zlatko Trajkoviqi është i djegur, Aleksiq Stana dhe vajza e saj Gordana janë rrahur.

T.S. Serb nga Bresja
FDH intervistë 28 prill 2004

Shtëpi serbe e djegur dhe e rrënuar në Fushë Kosovë © FDH

Shtëpia e shëndetit dhe shkolla në Bresje janë djegur më 17 mars rreth orës 13:30. Unë e kam shtëpinë një kilometër më larg nga këto ndërtesa, menjëhere pas policisë së komunikacionit. Në atë pasdite erdhi vajza ime Nena. Pastaj ate me telefon e thirri një shqiptare, e cila i tha se situata është shumë e keqe. Rreth orës 17:30 një grup prej dhjetë shqiptarësh sulmuan shtëpinë tonë. Askush prej tyre nuk kishte mbi 18 vjet. Së pari kanë shtënë, ndërsa pastaj kanë filluar të thejnë. Së pari kanë rrahur fqiun tonë Tomiq Zhika. Unë kam dalur në oborr që ta gjejë nipin tim Jovanin. Ai ka hyrë në shtëpi, ndërsa mua më goditën me drrasa që u gjinden në oborr. Dora ime u pergjakë. Pastaj erdhën 15 policë (...). Policia formoi muri të gjallë për t'u

mundësuar largimi ynë nga shtëpitë. Duke u larguar kam parë se grupi u zhduk (...). Na dërguan në stacionin e policisë dhe na vendosën në sallën për takime. E thirrën vajzën time që të shkojë me ta dhe t'i tubojë sërbët nga shtëpitë. Gjithë natën kanë punuar. Gjithësej ishin 138 prej tyre 13 fëmijë (...). Shumë prej tyre kanë ardhur të rrahur. Zhika Tomiq ishte i përgjakur. Jova Qirkoviq i rrahur. Gruaja e Çedo Rapor ka ardhur me dorë të thyer. Erdhën mjekët shqiptarë për të ofruar ndihmën. Jova Qirkoviqin e dërguan për në spital. Gjyshës ia lidhën dorën. Nuk kishin ilaqe. Në mëngjes na dërguan në Kryqin e Kuq.

D.S. Serbe nga Bresja, e vendosur në kontinier në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004

Tridhjetë e peëe vite unë kam punuar si auto ngjyrosës dhe auto mekanik. Kam jetuar në Gjermani. Kam pasur dëshiëe që t'i siguroj fëmijët. Kam lënë pasuri të madhe. Kafe në restoran nuk kam piëe. Me gruan nuk kemi dalur vetëm për të kursyer. Kam pasur shtëpinë tri katëshe. Tani jam i mjerë. Nuk kam asgjë. As fëmijët nuk kanë asgjë. Disa mijëra marka kam fituar në muaj, nga qiraja dhe nga puna ime. Shqiptarët më kanë ardhur shpesh natën, duke u fshehur, për t'iu rregulluar makinat. Të gjithë e kanë ditur se jam i ndershëm. Unë personalisht nuk kam lejuar që të digjen shtëpite e shqiptarëve në rrugën time, gjatë luftës. Ata janë të gjithë njerëz të ndershëm, siç jam edhe unë. Për të gjitha që kanë ndodhur faj kanë politikanët. Gjithkund ka njerëz të mirë dhe të këqinj. (...) 37.500 euro më janë djegur në shtëpi. Kur ka filluar të digjet, tri vajzat e mia, gruaja dhe mbesa pesëvjecare kanë filluar të bërtasin. Unë kam rrëmbyer mbesën time dhe me të kam dalur jashtë. Çfare të hollash? Çka do bëja pa mbesën? Kur kam vrapuar jashtë mbesës ia kam mbyllur gojën që të mos ndëgjohet, sepse gjithë kohën ka qajtur. (...). Jemi fshehur sikurse shtazët. Kemi ikur në oborre shqiptare, jemi fshehur në terr. Diku rreth orës 22,30 kam parë një shqiptar i cili punon si përkthyes në OSBE dhe e kam lutur që ta merrë vajzën dhe mbesen time. Ka pranuar dhe i ka dërguar në Uglare. Unë kam mbetur duke u fshehur nëpër oborre fqinje. Kur arriti një grup shqiptarësh para shtëpisë sime filluan që t' djegin unë u fsheha në gropën e ËC. I kam dëgjuar dy fqinjët shqiptarë, duke thëne se unë jam njeri i mirë, se askujt nuk i kam bërë asgjë, por pa sukses. Erdhi një shqiptarë, i cili punonte në xhami dhe i dëboi këta njerëz. Pastaj filluan që të djegin. Kishin shishe me benzinë. Kisha të holla që i kisha kursyer nga qiraja e banesës në të cilën banonin policët ndërkombëtar. Nuk di a i kanë gjetur të hollat ose janë djegur, por e di se nuk kamë as rrobe për veti. E kam humbur edhe shpirtin. Ma kanë marrë shpirtin. Na kanë sulmuar sikur të ishim shtazë. Në qoftë se nuk jemi njerëz le të thonë dhe të shkojmë nga këtu.

M.I. Serb nga Fushë Kosova, i vendosur n kontenier në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004

5.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut, SHPK-së dhe KZK-së

Evakuimin e serbëve e kanë bërë policët e Kosovës, ndërsa policët ndërkombëtarë janë kujdesur kryesisht për familjet e tyre. Policët kryesisht kanë vëzhguar dhunën e shqiptarëve. Ekzistojnë dëshmitë se policët e Kosovës i kanë udhëhequr demostrusit por i kanë ndihmuar edhe serbët. Disa sërbë tek të cilët kanë banuar policët ndërkombëtar pohojnë se këta kanë refuzuar që t'i transferojne me automjete në ndonjerin nga fshatrat serbe që gjenden perreth. Serbët dëshmojnë që në mesin e demostruesëve kishte pjesëtarë të trupave mbrojtëse të Kosovës.

Nuk ishte KFOR-i, ndërsa SHPK ka qëndruar nga ana tjetër, tek pompa, 200 metra nga shtëpitë serbe.E kam dëgjuar një policë të SHPK se si thotë që kafenenë "Zhivin Gaj" duhet djegur. Policët e SHPK kanë shikuar se si e rrahin Trifun Stojiloviqin dhe nuk kanë ndërmarrë asgjë. Madje disa policë të SHPK kanë shetitur me demonstrues.

D.V. serb nga Bresja, i cili e ka shtëpinë e djegur
FDH intervistë 28 mars 2004

Bija ime ka thirrur KFOR-in, ndërsa ata e kanë informuar SHPK-në (...). Tre policët e SHPK arritën shumë shpejtë dhe ata na futën në shtëpi. Policia më ka pyetur kush më ka rrahur. I kam treguar dy persona dhe policët i kanë mbyllur në veturën e tyre. Pastaj arritën edhe 15 policë, në mesin e të cilëve ishte edhe një grua e cila quhet Sada. Masa e shtyente automjetin e policisë dhe tentoi që ta rrokullisë dhe pastaj policia i liroi ata dy persona, që ishin të mbyllur në veturë. Policët thanë se i kemi 5 minuta që të dalim nga shtëpitë. Kanë formuar murin e gjallë që ne të dalim. Nuk na kanë lejuar asgjë që të marrim. Sada më ka ndihmuar që ta marrë qantën me dokumente. As këpucët nuk kisha mundësi t'i mbathi. Duke na larguar policia kam parë se grupi është rritur (...). Na kanë dërguar në stacionin policor dhe na kanë vendosur në sallën për takime.

D.S. Serbe nga Fushë Kosova, e vendosur në kontenierë në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004-07-07

Vajza ime i ka thirrur SHPK-në më 18 mars në mëngjes dhe ka kërkuar mbrojtëje, sepse në atë kohë disa shtëpi tani më ishin të djegura. Ajo thotë se polici i SHPK-së iu ka përgjigjur: voglushe, nëse shtëpia nuk është djegur dje do të djeget sot.

M.I. Serb nga Fushë Kosova, i vendosur në kontinier në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004

E kam lutur policin ndërkombëtar që të na pranojë neve katër gra të moshuara në veturë dhe që të na shpëtojë. Ai e ka marrë gruan e vet dhe fëmijët ndërsa neve nuk na ndihmojë. Jemi fshehur nepër në thark. Para nesh ishte një grup i të rinjëve, që hedhnin gurë. Për ndihmë arritën dy policë të SHPK-së rreth orës 22:30, të cilët kanë marrë lajmërimin nga Beogradi se katër gra të moshuara fshehen nëpër oborre. Na dërguan në stacionin policor.

S.R. serbe nga Fushë Kosova, e vendosur në kontinier në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004

5.2. Pasojat

Sërbët nuk janë të kënaqur me dëmin e vlerësuar duke marrë parasysh se shtëpitë, të cilat sipas tyre kanë vlerën prej 100.000 i jepet kompensimi prej 15 – 20.000 euro.[10] Më 27 maj ka filluar renovimi i dhjetë shtëpive të para serbe, prej gjithsej 106, që janë të shkatërruara në ngjarjet e marsit. Serbët e Fushë Kosovës/Kosovog Polja janë vendosur në fshatin Uglare/Ugljare ku mbas ngjarjeve të marsit është vendosur komuna serbe. Kanë pritur që vendasit të tregojnë solidaritet më të madh dhe se Republika e Serbisë do të sigurojë ndihmë humanitare të rregullt,

[10] *Ndërtimi të gjitha objekteve gjatë këtij viti*, DANAS, 24 maj 2004

të cilën politikanët tërë kohën e kanë paralajmëruar. Familje me shumë anëtare jetojnë në kontenjerë, flejnë në dysheme ose në dyshekë, nuk kanë shporetë ku do zijenin drekën, si dhe nuk kanë kushte për larje të rrobave. Pas ngjarjeve të Marsit Qeveria e Serbisë dërgon ndihma në të holla, e cila është 65 Euro për familje.

Une dua që shtëpia ime të renovohet dhe të kompensohet dëmi. Nuk di sa do të mbes këtu. Kam dy vajza, nuk di a është e sigurtë këtu.Unë kisha dashur që të mbetem, këtu i kam stërgjyshët. E kam shumë vështirë. Vështirë e kanë edhe miqët e mij shqiptarë. Disa prej tyre më kanë thirrë dhe kanë qajtur.

D.V. serb nga Bresja,i cili e ka shtepinë e djegur
FDH intervistë 28 mars 2004

Ne jemi vendosur në fshatin serb Uglare.Pas disa ditësh na i kanë sjellur 10 kontenierë. Kemi dëgjuar se i ka dërguar qendra koordinuese. Familja jonë e ka marrë një. Kemi dy shtretër dhe një sungjer. Na kanë dhënë miell por nuk kemi shporet. Shtëpia është plotësisht e djegur. Kërkojmë që shtëpia të renovohet dhe të përforcohet siguria.

D.S.serbe nga Fush Kosova,e vendosur në kontenier në Uglare
FDH intrervista 28 mars 2004

Në ndërtesën Lepa Brena, fqiu shqiptar ia dha derën e hekurët që SHPK-ja t'ia vendosë në banesën e fqiut serb, dera e të cilit është thyer më 17 mars. Dy vajza shqiptare kanë bërë përpjekje që të pengojnë sulmuesit që t'i djegin banesat në përdhesë. Nga dritaret kanë bërtitur që mos t'i prekin banesat. Huliganët i ofendonin me fjalë fyese. Fqinjët Bedri Tmava dhe Gani Krasniqi janë përpjekur që ta pengojnë djegëjen

R.T. serbe nga Fushë Kosova, e cila jeton në ndërtesën"Lepa Brena"
FDH intervistë 26 prill 2004

Quhem M.I. Jetoj nw kontenjer. Unw jam njeri pa adresw (...) Shiqoni, kjo wshtw ndihma socijale, tw cilwn e kam marrw prej Serbisw. Saktwsisht 5031 dinarw. Çka mundem unw me kwta dinarw? Mw falni, brenda [nw konferencw] kam pasur shumw çka pwr tw thwnw, por diçka kwtu [tregon nw fyt] mw ka shtrwnguar. Askush nga Qeverija e Swrbisw nuk ka ardhw? As nga Qeverija e Kosovws? Ej, 106 shtwpi nw Fushw Kosovw janw djegur dhe askush tw na shiqojw. Shko, shtazw, kur askush nuk tw shiqon. Nga Swbija twrw kohwn porosisin: " rrini aty, mos shitni pronwn!". A e dini ju se sa njerwz janw tw pwrndjekur? As unw nuk e di saktw, por e di se nw asnjw shtwpi nuk ka pasur mw pak se dy anwtare tw familjes. Vetwm te unw kemi qenw gjashtw (...) Besoni, unw jam njeri i ndershwm. Kam ardhur kwtu [nw konferencw] sepse wshtw dashur tw tregoj pwr mundimet tona, pwrndryshe kurrw nuk do vija (...) Prej Fushw Kosovws kemi ikur nw Uglare. Kur kemi ardhur nw Uglare, askush asgjw nuk na ka pyetur. Tw gjithw ata kanw organizuar dhe na kanw mbajtur mitingje dhe ligjerata. Ne jemi kundervwnw dhe kemi kwrkuar qw tw na dwgjojne. Na kanw thwnw se sw shpejti do tw na sigurohet vendbanimi, dhe se duhet tw mbesim aty. Ne kemi dashur tw shkojmw nw Swrbi. Atwherw kanw filluar qw tw na fyejnw. Mw falni zotwri, do tw jem direkt: "Tw organizojmw transportin pwr pi...". Unw ju kam thwnw: "Turp tw keni. Me çfarw tw drejte keni nw dispozicion ndihmat, tw cilat mbwrrije prej Qendrws sw Koordinimit? Pse nuk na keni dhwnw objektet ndihmwse, tw cilat askujt si duhen, qw ti adaptojmw, tw jetojmw si njerwz, dhe jo si

shtazw nw kontenjera". Der sot nuk na kanw dhwnw ato objekte ndihmwse. Menjwherw, aty ku wshtw kontenjeri jonw, shiten akulloret. Mbesa kwrkon e unw nuk kam. Si tw kem kur edhe rrobat qw i kam veshur nuk janw tw mijat, por mi ka dhwnw ushtari i KFOR-it italian. Ju faleminderit, por unw nuk di ti marr ato (hulumtuesi i FDH-sw dwshiron tw blejw çokollatw pwr mbeswn e tij, por dwshmitari nuk pranon). Mos mw fyeni. Vetwm edhe krenarija mw ka mbetur. Unw tani jam i mjerw, por nuk kam qenw mw herwt. Megjithatw, ndihem i mjerw sepse jam i detyruar tw marr ndihma humanitare. Mw besoni, as atw nuk do ta merrja pwr vehte, le tw ngordhi, por vetwm pwr shkak tw mbesws e marr. Edhe atyre konzervave qe i marrim i ka kaluar afati. Kam dwgjuar se e gjithw ndihma qw vjen prej Qendres sw Koordinimit vjen deri nw Leposaviq, dhe nga aty shkon nw shitore, kwshtu qw populli e blen, ate qw nw fakt duhet ta merr si ndihmw humanitare. Deri tek ne vjen vetwm ajo qw i ka kaluar afati i skadencws, sepse nuk mund tw shitet. Prej Qendres sw Koordinimit wshtw dashur tw mbwrrij ndihma nw tw holla nw emwr tw mbesws sime. Kjo ka qenw donacioni, tw cilin wshtw dashur ta marrin tw gjithw fwmijwt. Mbas ndarjes wshtw thwnw se çdo fwmijw duhet ti merr 400 Euro. Koha ka kaluar, dhe mbesa ime nuk ka marrw tw hollat e saja. Kam shkuar tw shiqoj se qfarw wshtw arsyeja, por mw kanw thwnw se tw gjithwve, tw cilet janw lajmeruar, u wshtw dhwnw shuma e tw hollave. Unw e kam lajmwruar mbeswn time por ... Prej pronws qw kemi tani mw ka mbetur vetwm kamera e cila kushton 660 Euro, por baterinw e ka tw zbrazwt, e unw nuk mund ta mbush sepse mbushwsi wshtw djegur nw shtwpi. Tash as atw nuk mund ta shes. Kamera ka qenw te njw kushwri i imi. Tash ma ka kthyer (...) I kam 55 vite, por dukem se paku 10 vite mw i vjeter. Gruaja mw thotw qw ti lwmw tw gjitha, por unw ende kam shpresw. Mendoj, do tw na thonw diçka, por tw gjithw heshtin. Aspak nuk brengosem pwr vehte, pwr nderw. (qan)

M.I. sereb nga Fushë Kosova, i vendosur në kontinier në Uglare
FDH intervistë 26 prill 2004

6. Dhuna e të rinjëve në Obiliq

Deri në ngjarjet e marsit në qytet kanë jetuar 450 serbë, shumica në lagjën Todoroviqi dhe në ndërtesat e YU programit. Protestat kanë filluar me 17 mars 2004 para komunës së Obiliqit në ora 12:00. Në mesin e demostruesëve ka pasur shumë nxënës, të cilëve më vonë iu bashkangjitën edhe të rriturit. Atëhere me gurë u sulmua ndërtesa e komunës. Disa shqiptarë nga shërbimet komunale iu bashkangjitën demonstuesëve. Ditën tjetër, demostratat filluan me marshin e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme. Në këtë ditë janë djegur shtëpitë serbe në lagjen Todoroviqi dhe ndërtesat e YU programit.

Më 17 mars isha në vendin e punës. Përveç meje në komunë punonin edhe disa serbë. Kemi dëgjuar se do të ketë demostrata në qytet. Kjo nuk ishte dukuri e jashtëzakonshme në Obiliq, prandaj nuk i kemi dhënë rëndësi të madhe. Megjithatë në komunë ka ndodhur diçka e jashtëzakonshme. Dserisa jashtë tuboheshin demostruesit kryesisht nxënësit e shkollës së mesme në ndërtesë është kyqur alarmi kundër zjarrit. Ne e kemi kuptuar këtë si shenjë që punëtorët shqiptar të komunës t'i bashkangjiten demostruesve. Nuk di si ta shpjegojmë ndryshe këtë. Demostratat i kanë udhëhequr fëmijët, ndërsa më vonë iu bashkangjitën edhe të rriturit.

S.A. serb nga Babimoci, shefi i zyrës për komunitete, Obiliq
FDH intervistë 19 prill 2004

Me 17 mars isha në zyrën e organizatës joqeveritare, e cila gjendet në ndërtesën e komunës.Rreth orës 12:00 kanë filluar demostratat para komunës. Demostruesit bërtitnin dhe gjuanin gurë, ndërsa shqiptarët të cilët punojnë në komunë kanë përshëndetur këto ngjarje. Kur arriti KFOR-i i gjuajtën me gurë. Me mua në ndërtesë ishin edhe disa serbë, të punësuar në komunë (...). Arritëm të dalim rreth orës 16:00 kur demonstruesit u nisën në drejtim të Plemetinit. Më herët në zyre ka hyrë Musa Mjekiqi, i cili na tha se mund të dalim, sepse demostruesit kanë shkuar në tjetrën anë. Ai madje shkoi she ia solli qantën njerës grua. Në mbrëmje ishte qetësi.

S.D. serbe nga Obiliqi, aktiviste e OJQ-së për të drejtat e gruas
FDH intervistë 27 mars 2004

6.1. Rrahja e serbëve në stacionin hekurudhor

Me 17 mars rreth orës 14:30 demostruesit u nisën në drejtim të stacionit hekurudhor ku i kanë takuar 16 serbë të moshuar, të cilët i kanë sulmuar fizikisht. Disa prej tyre kanë lëndime të rënda trupore, por disa prej tyre i shpëtuan rrahjes.

Ishte rreth orës 14:24 kur masa u drejtua tek stacioni hekurudhor. Aty takuan 16 serbë të moshuar, të cilët pritnin trenin. I rrahën. Një gruaje të moshuar Stojana Dimitrijeviq (90) ia kanë thyer ashtin e urzës. Një i moshuar Dimitrijeviq, nuk ia di emrin, gjithashtu është rrahur. Gruaja tjetër, Ristiq, as asaj nuk ia di emrin, me ndonjë mjet të mëprehët është prerë në qafë. Njërës grua ia kanë thyer britë, derisa të tjerët janë lënduar ma lehët.

S.A. serb nga fshati Babimoc,shefi i zyrës për komunitete, Obiliq
FDH intervistë 19 prill 2004

Babai im, i cili jeton në shtëpinë pran meje në lagjën Todoroviqi, më 17 mars u nisë për në stacionin hekurudhor, në mënyrë që me tren të shkoj për vizitë mjekësore në Mitrovicë. Demostruesit e kanë vërejtur grupin e serbëve në stacionin hekurudhor dhe u nisën me shkokpinjë dhe gurë në drejtim të tyre. Babai im i cili është 63 vjeç, arriti që të ikë deri në qendrën shkollore. shqiptarët e rrahën me shufra një grua të moshuar. Babai im mbeti në ndërtesën e Qendres shkollore deri në mbrëmje, kur demonstruesit u larguan. Pastaj u kthye në shtëpi.

S.T. serb nga lagja Todoroviqi, person i zhvendosur
FDH intervistë 25 prill 2004

6.2. Dhuna në vendbanimin Todoroviqi dhe ndërtesat e YU programit

Ditën e ardhshme, demonstratat i filluan nxënësit e shkollave të mesme me sheti nepër qytet. Të gjitha shkollat ishin të mbyllura. Derisa lëviznin nepër qytet qytetarët iu bashkangjitnin. Demonstruesit së pari e djegën kishën ortodokse, pastaj shkuan në lagjën Todoroviqi ku kanë jetuar 25 familje serbe. Serbët ikën para masës, e cila i plaçkiti shtëpitë, ndërsa pastaj iu vuri zjarrin. KFOR-i ka evakuar serbët nga ndërtesa e YU programit, duke i lënë banesat pa sigurim. Banesat janë demoluar dhe plaçkitur. Serbët në mesin e demonstruesve kanë parë prindërit e disa nxënësve dhe fqinjët e tyre. Demonstruesit i ka përcjellur kombi i mbushur me gurë, me të cilët gjuajtën shtëpitë serbe, kishat dhe ndërtesat. Një serb para demostruesve ka

dalur me bombë dhe policia e UNMIK-ut e ka arrestuar. shqiptarët nga Plemetini e kanë braktisur fshatin kur kanë dëgjuar që serbët nga ky fshat përgatiten të nisën që t'i ndihmojnë serbët nga Obiliqi, sepse kanë dëgjuar që janë disa të vrarë.

Në mëngjes të 18 marsit rreth orës 8:00 sërish është dëgjuar zhurma nga qendra e qytetit. Pas disa minutash është parë tymi i zi nga dy-tri shtëpi në lagjën Todoroviqi. Pastaj doli tymi eshe nga kisha. Kam parë masën rreth 5000 njerëzish e cila isjte nisur në drejtim të ndërtesës së YU programit. Serbët i kaploi panikë e madhe. Pasi që janë dëbuar, serbët nga një ndërtesë kanë shkuar te ndërtesa tjetër, ku, gjithashtu, jetonin serbët. Edhe nga këtuj serbët janë dëbuar. Dhuna ka vazhduar tërë ditën (...). Shpëtimi i vetëm ishte evakuimi. Një pjesë e sërbëve është transferuar në kazermën e KFOR-it, ndërsa të tjerët në fshatin Plemetin dhe Babimoc. Mendojmë se këtë dhunë e kanë kryer fqinjët e parë.

S.A. serb nga fshati Babimoc, shef i zyrës për komunitete, Obiliq
FDH intervistë 19 prill 2004

Më tetëmbdhjetë mars, rreth orës 10:00 të mëngjesit, kam vërejtur grupe të fëmijëve shqiptarë duke shkuar në drejtim të kishës. Pas tyre shkonin të rriturit (...) Në një moment kam vërejtur tymin nga kisha (...) Dëgjohej ulurima dhe gëzimi. Kemi vërejtur se si demonstruesit shqiptarë afrohen në drejtim të lagjës sonë. Demonstruesit brohoritnin UÇK, Hashim Thaqi, Ramush Haradinaj, (...) Ishin 500 deri 1000 njerëz. Filluan të gjuajnë me gurë shtëpitë tona dhe të gjuajnë kokteje të Molotovit. Disa shtëpi i përfshiu zjarri. U afruan shtëpisë sonë, hynë në oborr dhe filluan të gjuajnë me gurë. Në atë moment brenda në shtëpi ishim 11 veta. Fëmijët dhe të moshuarit i fshehëm në banjo, ndërsa djali im Bojani dhe unë kemi qëndruar në prag të shtëpisë duke pritur më të keqën. E kam dëgjuar ulurimën e qenit tonë dhe kam pa se si e vrasin me gurë. Shtëpia e babait tim tani më ishte në zjarr.E kam kuptuar se do të na vrasin të gjithëve nëse menjëhere nuk ikim. Djali im dhe unë e kemi hapur dritarën nga ana tjetër e shtëpisë dhe filluam t'i ndihmojmë fëmijëve dhe gruas sime që të dalim jashtë. Babai im, nëna ime, agja dhe gruaja e agjës e cila ishte invalid vendosëm që të mbesim në shtëpi. Gruaja, katër fëmijët, vëllai dhe unë disi ia arritëm që ta kapërcejmë rrethojën e hekurt. Filluam të ikim në drejtim të Crkvena Vodicës. Kjo u pamundësua, kështu që u detyruam që të iknim nëpër moqal përplotë ujëra të ndotura nga Termoelekterana. shqiptarët u nisën në drejtimin tonë, por uji i ndaloi. Uji ishte gjithmonë më i thellë kështu që në një momente arriti deri në brez. Fëmijët e vogël i vendosa në krah, kështu që disi arritëm që të dalim. Ishim plotësisht të lagur dhe të frikësuar. Nuk kishim ku të iknim, prandaj vendosëm që të presim në këtë vend që të na shpëtojë dikush. Filloi gjithçka të digjet, por babai dhe nëna ime, axha dhe gruaja e axhës arritëm që ta shuajmë zjarrin. Në këtë moment arriti automjeti i policisë së UNMIK-ut. Policët hynë në shtëpi dhe na shpëtoi. Shtëpinë e dogjën, ndërsa ne qanim duke shikuar se si ajo digjet.

S.T. serb nga lagja Todoroviq, person i zhvendosur
FDH intervistë 25 prill 2004

Të nesërmen, më 18 mars në orën 8:15 kur fëmijët u nisën në shkollë, filluan demostratat para ndërtesës. Demonstruesit bërtitnin "shkina jashtë". Bllokimi i ndërtesës ka zgjatur një orë, derisa na evakuoi KFOR-i . SHPK-ja nuk na ka ndihmuar. Kanë qëndruar në rrugë dhe kanë

shikuar se çka po ndodhë. Banesat tona nuk janë të djegura, por janë të plaçkitura. Asgjë nga gjësendet tona nuk i kemi marrë. Kam dalur nga shtëpia me papuçe.

S.D. serbe e ndërtesës YU program, person izhvendosur
FDH intervistë 25 mars 2004

Ndërtesa e djegur e YU programit ne Obiliq. FDH foto dokumentim

Më shtatëmbdhjetë mars ka patur demostrata, por ato ishin të qeta. Rreth orës 14:00 nxënësit e shkollave të mesme janë tubuar në qendren e qytetit dhe filluan që të defilojnë nepër qytet. Deshën që të hyjnë në ndërtesën e komunës, por ne kemi dal në oborr dhe nuk i kemi lejuar. Kjo nuk ka zgjatur shumë. Pastaj, ishte qetësi (...) Më tetëmbëdhjetë mars në orët e mëngjesit sërish u tubuan nxënësit. Në të vërtetë, ata nuk shkuan në shkollë. Ishin rreth 400 nxënës. Ata janë manipuluar nga ana e disa personave, të cilët nuk janë nga Obiliqi. Së pari gjuanin gurë, ndërsa pastaj i dëbuan nga shtëpitë qytetarët tonë serbë. Ne kemi ndikuar në prindërit e këtyre fëmijëve, që t'i marrin dhe t'i dërgojnë nepër shtëpi. Kisha është pak e dëmtuar, sepse edhe ashtu ka qenë e papërfunduar dhe në te nuk ka pasur ikona. Dyrtë dhe dritaret e kishës janë të thyera. (...) Sipas disa të dhënave jozyrtare në trazira gjithsej ishin dymbëdhjetë të plagosur dhe të lënduar. Një serb me mbiemër Spasiq mbi demonstruesit ka gjuajtur bombë. Ai ka qenë në paraburgim disa ditë dhe më vonë është liruar. Kishte disa raste kur demonstruesit i kanë rrahur serbët (...) Serbët nga fshati Plemetin janë organizuar dhe të paarmatosur deshën të nisën për Obiliq. Ata kishin informatë të gabuar se ka serbë të vrarë. Në krye me kryetarin, delegacioni i komunës ka shkuar në fshatin Plemetin, biseduan me serbët dhe i bindën se asnjë

serb nuk është i vrarë, kështu që ata nuk shkuan në Obiliq. Disda familje shqiptare nga fshati Plemetin kërkuan që të evakuohen.

E.H. shqiptar nga Obiliqi, funksionar i Kuvendit komunal
FDH intervistë 19 prill 2004

6.3 Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së

Disa policë të Kosovës kanë treguar demonstruesve shtpitë serbe. KFORI-ri dhe policia e UINMIK-ut ka evakuar serbët,duke mos ndërmarrë masa për mbrojtjen e pasurisë së tyre. Demonstruesit kanë bllokuar automjetet e KFOR-it, të cilët janë nisur në drejtim të lagjës së sërbëve, ndërsa nuk kanë reaguar as atëhere kur demonstruesit në automjetin e tyre kanë vendosur flamurin shqiptar.

Sipas mendimit tim, pjesëmarrësit kryesor të dhunës kanë qenë policët e Kosovës (shqiptarët), ata ecnin para masës dhe të parët kanë kërkuar që serbët të evakuohen (...) Një serb pohon që fqiu i tij shqiptar, përndryshe polic ia ka vënë zjarrin shtëpisë së tij. Ai nuk dëshiron që ta jap këtë deklaratë askujt. Policia e UNMIK-ut atë ditë është sjellur si vëzhgues. Asgjë nuk ka ndërmarrë për të penguar masën . As ushtarët e KFOR-it nuk kanë ndërmarrë asgjë. Ata janë marë me evakuimin e serbëve.

S.A. sërbë nga fshati Babimoc, shef i zyrës për komunitete, Obiliq,
FDH intervistë 19 prill 2004

Më tetëmbëdhjetë mars vetëm disa poliocë të SHPK-së ishin në rrugë. Nuk e kisha të qartë se çka po ndodhë. Nuk arrita që të shohë asnjë ushtar të KFOR-it ose të policisë së UNMIK-ut. (...) Masa e demonstruesve e udhëhequr me policët shqiptar arriti në vendbanimin tonë. Policët, bukvalisht i kanë orientuar në shtëpitë tona (...) Filloi gjithçka të digjet. Por nëna dhe baba im, axhja edhe gruaja e axhës arritën që ta shuajnë zjarrin. Në këtë moment ka arritur policia e UNMIK-ut. Policët hynë në shtëpi dhe i nxorrën jashtë babain , nënën, axhën dhe gruan e axhës). Shtëpia është djegur menjëhere. Një automjet i policisë së UNMIk-ut na dërgoi në satacionin policor. Pastaj me automjete të KFOR-it jemi transferuar në bazën e KFOR-it në Prishtinë, ku në kushte të vështira i kemi kaluar shtatë ditët e ardhshme. Në bazë ishin të vendosur disa serbë nga Obiliqi dhe Prishtina. Kishte shumë fëmijë të vogël dhe njerëz të moshuar dhe të sëmuar. Ushtarët e KFOR-it na kanë trajtuar si shtazë. Nuk kishim mundësi që të pastrohemi kishim vetëm një batanije e edhe pse ishte mjaft ftohët.

S.T. serbi nga lagja Todoroviqi, person i zhvendosur
FDH intervistë 25 prill 2004

Të gjithë ishin të lodhur dhe të molisur kur dëgjova zërin e një mikut tim nga policia ndërkombëtare. Ai tha se i kemi vetëm tre minuta për ta marrë një çantë, por nuk patëm mundësi as ate që ta marrim. Në transportuesit e KFOR-it kemi hyrë duke vrapuar. Xhamat pelcitnin në të gjitha anët, ndërsa unë e lëndova shpinën. Fqinjët tanë shikonin dhe nuk reagonin.

S.K. serbe nga Obiliqi, person i zhvendosur
FDH intervistë 27 prill 2004

6.4. Pasojat

Sipas të dhënave tona në Obiliq janë 92 shtëpi të djegura, 49 ndërtesa ndihëmse, 46 banesa dhe dy ndërtesa. Janë 55 banesa dhe shtëpi të plaçkitura (...) Lidhur me vlerësimine dëmeve janë organizuar tri komisione: Komisioni, të cilin e formuan shqiptarët nga Komuna, ka konkluduar që dëmi është në vlerë prej 1.145.306 euro. Unë kam punuar në terrer me ekipin tim. Ne kemi konkluduar që dëmi është 1.762. 000 euro. Ndërsa Komisioni i përbashkët me UNMIK-un ka konkluduar se dëmi i krijuar është në shumë prej 1.862. 000 euro. Megjithatë, kjo ka të bëjë vetëm me ndërtesa. Në këto shtëpi ka pasur gjëra të vlefëshme, orendi etj. Konsiderojmë se dëmi i përgjithshëm është rreth 3 milion euro, pa shkollë dhe kishë. Sa i përket shkollës, dëmi është 28.514 euro. Gjithashtu, janë plaçkitur dhe dëmtuar disa shitore dhe janë vjedhur makinat bujqësore. Janë të djegura dhjetë vetura, pronar të së cilëve janë serbë (...) Ne ishim për ta pastruar një ndërtesë. Në plan është kthimi i 24 familjeve. Për pronarët e banesave të djegura, UNMIK-u në bashkëpunim me organizatën humanitare GOAL ka siguruar 30 kontejner. Është thënë që në shtator do të përfundojë rikonstruimi i të gjitha objekteve të dëmtuara. Megjithatë, njerëzit edhe mëtej nuk kanë vullnet për kthim, madje edhe ata të cilët shtëpitë i kanë të parprekura.

S.A. serb nga fshati Babimoc, shef i zyrës për komunitete, Obiliq
FDH intervistë 19 prill 2004

Kurrë nuk do ta harrojë atë ditë. I kam humbur të gjitha ndërsa më së tepërmi më dhimbset që me siguri nuk do të kthehemi kurrë në Obiliqin tonë martirë.

S.Q. serbe nga Obiliqi, person i zhvendosur
FDH intervistë 7. prill. 2004

Askush nga serbët ende nuk është kthyer. Kryesisht kanë shkuar në fshatrat e komunës sonë, në Plemetin, Babimoc e tj. Ka edhe të tille, të cilët kanë shkuar në Mitrovicë dhe Graçanicë. Ne me telefon kemi kontaktuar me nëpunësit tanë të nacionalitetit serb. Ata thonë që serbët i pengojnë që të vijnë në punë. Pas ngjarjeve, disa prej tyre, disa here kanë qenë në komunë, për arsye private.

E.H.shqiptar nga Obiliqi,funkcionar i komunës
FDH intervistë 10 prill 2004

7. Djegia e shtëpive dhe vrasja në Lipjan

Më shtatëmbëdhjetë mars në orën 14:00 disa mijëra shqiptarë kanë filluar të protestojnë në rrugët e Lipjanit. 30 shtëpi serbe dhe 4 banesa në ndërtesën e YU programit janë plaçkitur dhe djegur. Është shkatërruar edhe Zyra komunale për komunitete. Në shtëpinë e vet është vrarë serbi Nenad Vesiq. Në konfliktet me KFOR-in humbën jetën dy shqiptarë, Nevzat Rrahmani dhe Arben Shala. Shumë persona janë të lënduar ekzistojnë rastet kur fqinjët shqiptarë kanë penguar demostruesit që t'i ofrohen shtepive serbe. Në sulmet mbi serbët dhe pasurinë e tyre demostruesit kanë përdorur armë zjarri dhe mjete shpërthyese.

Situata e sigurisë në Lipjan, para marsit ishte në nivel të kënaqshëm. Sërbët filluan që të lëvizin lirë nëpër qytet dhe të blejnë në shitoret e shqiptarëve (...) Marrëdhëniet janë rrënuar. Dhuna ka pasur për qëllim dëbimin e serbëve. Jam i bindur që qëllimi nuk ka qenë vrasjet. Rreth mesditës më 17 mars, shqiptarët u tubuan në rrugën kryesore. Në fillim, në masë kishte më shumë njerëz të rijë, por ma vonë iu bashkangjiten edhe të rriturit. Pas shetisë nepër qytet, demostruesit u nisën në drejtim të shtëpive serbe (...) Masa së pari u nis në drejtim të ndërtesës së YU programit. Atje kishte shumë familje serbe. Gjuanin me gurë dhe thyen xhamat. KFOR-i i nxorri banorët nepërmes terce të një banese. Pastaj demonstruesit sulmuan shtëpitë serbe përreth. Në Lipjan janë plaçkitur dhe djegur 30 shtëpi serbe, duke perfshirë edhe zyrën tonë për komunitete. Të gjitha gjërat e vlefshme janë marrë, gjithashtu të gjitha shitoret serbe janë demoluar. Në këtë natë Nenad Vesiq është vrarë me të shtëna me armë zjarri. Është shtënë edhe mbi shtëpi, ku edhe tash mund të shihen shenjat e pëlumbave. Gati të gjithë serbet nga Lipjani janë evakuar në mjedise tjera ku jetojnë vetëm serbët. Këto fshatra janë Gushterica, Novo Nasele, ndërsa të tjerët kanë shkuar në Graçanice dhe Llaple Sellë. Kam ndëgjuar se ka edhe të lënduar por une nuk i di emrat e tyre (...) Fushata e njejtë ka ndodhur edhe ditën e ardhshme më tetëmbëdhjtë mars.

B.N. sereb nga Lipjani, shef i zyrës për komunitete
FDH intervistë 4 prilll 2004

Sipas gazetës së Beogradit BLIC një grup i demonstruesve rreth orës shtatëmbëdhjetë është nisur në drejtim të kishës. Rrugës kanë thyer. Kanë gjuajtur bombë mbi një serb, i cili ikte para masës. Policët kosovar e kanë arrestuar sebin, sepse demonstruesit e kanë akuzuar se ai ka gjuajtur bomben mbi ta. Në kishë ishte prifti Rangjell Deniq, i cili me këtë rast është lënduar rëndë.[11]

7.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së

Unmiku dhe SHPK kanë evakuar serbët ndërsa demonstruesit kanë plaçkitur dhe djegur pa penguar shtëpitë sebe. Policët e Kosovës i prinin demonstruesit dhe urdhëronin serbët që të largohen nga shtëpitë me arsyetim se nuk mund t'i mbrojnë nga masa. Pjesëtarët e SHPK-së kanë arrestuar përiftin dhe serbin i cili ka ikur para demonstruesëve pa kurrfar arsye. KFOR-i ka penguar shkatërrimin e plotë të kishës.

Unë nuk e kam të qartë se si trupat e KFOR-it, UNMIK-ut dhe SHPK-së nuk arritën të pengojnë dhunën ndaj serbëve. SHPK-ja u ka ndihmuar demonstruesve. Ata ecnin para masës

[11] *Vetë vetes ia ka nxjerrur geleret*, BLIC 23 mars 2004 "Bomba ka ra disa metra afër meje. Unë jamë tërhjekur në shtëpinë e famullitarëve, ndërsa shqiptarët e thyen deren dhe hynë në portën e kishës. Përnjëherë, SHPK hyri në banesë. Në atë kaos unë iu thash mire dita, ndërsa ata u përgjigjën: "çfarë mirëdita! Duart lartë" shikojë, ndërsa ata bastisin banesën tone.Shumë fjalë fyese mi kanë thënë. Më nxorrën me përanga nëduar dhe më tërhiqnin deri në veturë. Gjithë kohën kasha ndjenjen që nëpër fëtyrë më rrjedhëte gjaku, sepse plaga nga geleri në ballë ishte e thellë. Në vend të stacionit më lane në veturë. Gjithkund për rreth ishin shqiptarët, ndërsa unë vetëm dhe ate me pranga në duarë. Një polic shqiptar gjithë kohën i thoshte të tjerëve që të më dërgojnë në stacion, por pa rezultat. "ule koken që mos të shohin" edhe në stacion nuk mi hjeken prangat. Telefoni ishte në xhepin tim. Më thirte gruaja, miku, familja. Nuk kasha mundësi që të lajmërohem dhe t'iu tregoje se qka po dnodhe. Jamë liruar në intervenimin e Graçanicës, ndërsa ka ndërmjetësujar një amerikan. Për pesë orë në polici askush nuk më ka ofruar ndihmë. Kur arrita në mbrëmje në shtëpi, erdhi një mik i imi,ai në plagë më vendosi alkool, ndërsa unë i kamë nxjerrur gelerët. Dje më ka kontrolluar një mjeke nga Bataljoni Finlandez".

dhe i urdhëronin serbët që të largohen nga shtepitë, sepse ata nuk janë në gjendje për t'i mbrojtur. Në të vërtetë ata i kanë dëbuar nga shtëpitë e tyre. Një burrë i moshuar, i cili nuk dëshiron të dëshmojë, por pohon se ka parë kur dy policët janë përgatitur që ta minojnë kishën ortodokse (...) serbët, pjesëtarët e SHPK-së nuk kanë kurrfar raporte me kolegët e tyre shqiptarë. Ata kryesisht punojnë në fshatrat serbe, siç është Gushterica.

B.N. serb nga Lipjani, shefi i zyrës për komunitete
FDH intervistë 4 prill 2004

7.2. Pasojat

Deri në fund të majit në Lipjan janë kthyer 160 serbë, të cilët pas ngjarjeve të marsit janë larguar nga qyteti nëpër fshatrat serbe për rreth. Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve në përbërje kryesisht të shqiptarëve, çka sërbët konsiderojnë si diskriminim etnik. Serbët konsiderojnë që kompenzimi i dëmeve në shumë prej 200.000 euro, sa ka vlerësuar Komisioni komunal është e pamjaftueshëm për renovimin e 30 shtepive serbe. Komisioni i përzier, në përbërje të përfaqësuesve të UNMIK-ut dhe një OJQ amerikane ka vlerësuar dëmin në 411.000 euro, gjë që për një shtëpi kap shumën prej 13.700 euro. Edhe me këtë vlerësim serbet nuk janë të kënaqur,sepse konsiderojnë se ju takon kompensimi edhe për orenditë e plaçkitur ose të shkatërruara.Ajo që është më e rëndë për serbët se ata nuk e ndiejnë veten të sigurtë në Lipjan dhe është shumë vështirë që të vendoset besimi ndëretnik. Gjatë ngjarjeve të marsit kishte edhe raste kur fqinjët shqiptarë të organizuar kanë mbrojtur shtëpitë serbe nga demonstruesit.

Më 19 mars pak është qetësuar situata. Megjithatë serbët edhe më tutje nuk guxojnë që të lëvizin nepër qytet. Edhe ata të cilëve shtëpitë nuk u janë djegur, nuk guxojnë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre. Në ndërtesën e YU progamit janë kthyer 4-5 meshkuj (...) Duhet të theksojë që organet komunale nuk kanë bërë asgjë për të penguar dhunën mbi serbët. Prandaj ne momentalisht nuk kemi kontakte me ta. Kam dëgjuar se disa në komunë kanë propozuar që të mbyllet zyra jonë, e cila vepron në kuadër të komunës.

B.N. serb nga Lipjani, shef i Zyrës për komunitete
FDH intervistë 4 prill 2004

Dhuna në rrugën tonë ka filluar me 17 mars. Ne i kemi lëshuar roletnet në dritare dhe jemi munduar që të shohim se çka po ndodhë jashtë. Demonstruesit u nisën në drejtim të rrugës sonë, por fqiu ynë Byrhani nuk ka lejuar që t'i afrohen shtëpive tona. Me fqinjët tanë shqiptarë nga kjo rrugë kurrë s'kemi pasur probleme. Këto janë tri shtepi serbe, ndërsa të tjera janë shtëpi shqiptare. Unë gjithmonë thoja se kur e shohë Byrhanin duke shetitur e ndiej vehten të sigurtë. Në rrugën tonë pas 17 marsit nuk ka pasur probleme.

R.A. serb nga Lipjani, shtëpinë e të cilit e ka mbrojtur fqiu shqiptar
FDH intervistë 28 mars 2004

8. Shtimë

Serbet nga komuna e Shtimes nuk kanë pasur informata se çka po ndodhë në Kosovë me 17 mars të vitit 2004, prandaj nuk i kanë dhënë rëndësi demonstruesëve dhe skandimeve të tyre. Protestat u bënë të dhunshme në orët e hershme të mbrëmjës kur shqiptarët filluan të gjuajnë

kokteje të Molotovit mbi shtepitë serbe. Disa fqinjë shqiptarë kanë marrë pjesë në demostrata dhe sulme mbi shtepite serbe. Krahas shtëpive serbe është djegur edhe kisha ortodokse e Shën Arkangjelit.

Më datën 17 mars tek une ishte për vizitë një mik i imi. Gjithë ditën kemi qenë në shtëpi dhe nuk e kemi ditur se çka po ndodhë. Fëmija im ka qenë dy here në shitoren shqiptare. Kur është kthyer për herë të dytë më tha se masa e njerëzve demonstron në qendër të qytetit, të cilët skandojnë "Thaçi – Thaçi". Kam menduar se janë demonstrata të zakonshme (...) Rreth orës 19:40 erdhi patrolla policore tek une. Ishin shqiptarë. Ata më pyetën a ka diçka të re. Unë nuk e kam ditur pse e kanë bërë këtë pyetje, por unë u thash se nuk ka asgjë. Njeri prej tyre ma ka dhënë numrin e telefonit. Pasi që shkuan policët, është gjuajtur kokteji i Molotovit në oborrin tim. E goditi betonin dhe zjarri nuk u përhap. Unë menjëherë dola në rrugë, por nuk e pash askend. Unë dyshojë se këtë e kanë bërë fqinjët e mi, të cilët dëshirojnë që unë ta braktisi shtëpinë. Pastaj e kam thirrur policinë në numrin që ma kanë dhënë. Arritën shumë shpejtë . Ata më thanë se nuk e dinë kush e ka bërë këtë. Para se të niseshim njeri prej tyre më tha se situata është mjaft e rëndë dhe ata nuk mund t'i ofrojnë siguri të gjithëve. Isha shumë i shqetësuar (...) Nuk kaluan as 20 minuta kur përsëri është gjuajtur kokteji i Molotovit në oborr. Shpejtë e kam thirrur policinlë. As kokteji i dytë nuk ka shkaktuar dëme. Kur arritën policët unë i luta që t'i transferojnë fëmijët në vend të sigurtë. Ata më thanë që për këtë duhet ta pyesin komandirin dhe shkuan. Unë e thirra një taksist shqiptar, shërbimet e të cilit i kam shfrytëzuar shpesh. Ai me tha se nuk mund të vijë. Pastaj e kam thirrur tjetrin i cili më ka thanë se do të vijë pak më vonë, por nuk erdhi.

N.J. serb nga Shtime, përfaqësues i Bashkësise serbe në komunë
FDH intervistë 14 korrik 2004

SHPK-ja ka evakuar serbët nga Shtimja dhe fshatrat per rreth. Shumë sërbë nuk kanë dëshiruar të evakuohen. Vetëm një shtëpi serbe nuk është shkatërruar dhe të njejtën e ka uzurpuar një shqiptar. Gjatë dhunës një serb është lënduar lehët. Gjithashtu, serbët konsiderojnë që akcioni i shkatërrimit të pasurisë serbe ka qenë i organizuar.

Rreth orës 22:20 telefoni im ka cingëruar. Ishte një polic i cili më tha të jemi të gatshëm për 5 minuta, sepse më vonë nuk do ketë mundësi për të na evakuar. Pas dhjetë minutash arritën dhe të gjashtit na futen në automjet. Asgjë nuk kam vërejtur kur jam larguar nga Shtimja. Na kanë dërguar deri në Novo Naselje. Na kanë thënë se edhe të tjerët duhet t'i evakuojmë. Ne kemi shkuar tek një familje serbe në Shtimje. Ata i ka evakuar policia pak para nesh, ndërsa të tjerët pas nesh. Të gjithë ishin të vendosur nëpër fshatrat serbe në komunën e Lipjanit. Gjatë bisedës kam kuptuar se mbi të gjitha shtëpitë janë gjujtur kokteje të Molotovit. Vetëm një burrë është lënduar e ai eshte Mile Miriq, i cili ka dalur në rrugë pasi që u gjuajt në oborrin e tij kokteji i Molotovit. Ai u gjuajtë me gurë (...) Disa prej tyre pohojnë se policia i ka evakuar me dhunë, sepse ata nuk kanë dashur që ta braktisin shtëpinë. Të gjithë janë evakuar para mesnatës. Mendoj se kjo ka qenë e oganizuar, sepse në natën ndërmjet 17 dhe 18 marsit të gjitha shtëpitë serbe janë plaçkitur, ndërsa më vonë të djegura. Vetëm një shtëpi serbe nuk është e djegur dhe ate për shkak se shtëpinë e ka uzurpuar një shqiptar. Unë nuk do të quditesha që ai i ka djegur shtëpitë tona, sepse ai ka dashur që t'i uzurpojë edhe arrat tona. Krahas orendive shtëpiake janë vjedhur edhe dy motokultivatorë dhe një traktor me të gjitha makinat bashkangjitëse.

N.J. serb nga Shtimja, Përfaqësues i bashkësisë serbe në komunë
FDH intervistë 14 qershor 2004

Komumuna e Shtimjes ka formuar Komisionin për vlerësimin e dëmeve, në të cilën serbët kanë një përfaqësues. Sipas mendimit të tij, kompensimi i vlerësuar nuk është adekuat me dëmin e shkaktuar. Deri në mesin e qershorit të vitit 2004 asnjë serb nuk është kthyer në Shtimje.

Komuna ka formuar Komisionin për vlerësimin e dëmeve dhe unë kam marrë pjesë në këtë Komision.Unë kam shkuar edhe nëpër shtëpitë serbe. E gjithë kjo ishte e tmershme, të plaçkitura dhe të djegura. Edhe orenditë, të cilat nuk janë të rëndësishme ishin të shkatërruara.Komisioni ka vlerësuar dëmin në 112.000 euro me çka unë nuk jamë pajtuar. Kjo është shumë pak dhe nuk mbulon shpenzimet e ndërtimit të vrazhdtë të objekteve. Në çdo shtëpi ka pasur orendi dhe teknikë të ndryshme. Në komunë më kanë thënë se ju vjen keq, por asnje kryrës nuk është arrestuar e kjo nuk është vështirë të bëhet (...) Unë një kohë kam paguar qira për një shtëpi në Suvi Do, por tani në Novo Naselje paguaj qira 60 euro, ndërsa nuk kam as banjo. Unë jetojë nga asistenca sociale prej 65 euro në muaj. Askush nuk mund të na ndihmojë. Komuna më herët ma ka paguar qiranë për shkak të fëmijëve, të cilët kanë vazhduar shkollën këtu. Më kanë thënë se do ta paguajnë edhe më tutje. Komuna na ka ndihmuar në ushqim, por ne nuk mund të jetojmë nga kjo. Nuk di çka të mendoj. Po qe se ndërtohet shtëpia ime, ashtu siç ka qenë më herët dhe tw mw kompenzohen gjërat e vjedhura atëhere do të kisha menduar nëse do të kthehem në Shtimje. As nga Sërbia nuk marrim kurrfar ndihme.

N.J. serb nga Shtimja, përfaqësues i Bashkësisë serbe në komunë
FDH intervistë 14 qereshor 2004

9. Shkatërrimi i pasurisë dhe vrasja në Gjilan

Me datën 17 mars në ora 15,00 demonstruesit filluan protestën duke blokuar udhëkryqet në dalje të qytetit. Pas kësaj në mënyrë të organizuar u nisën drejtë pjesës së qytetit ku gjendet lagja serbe e në të cilën është kisha ortodokse. Drejt shtëpive filluan të hedhin gurë që i kishin sjell me traktor, pastaj kishin hynin nëpër shtëpi dhe i rrahnin të pranishmit, i shkatronin dhe i plaçkitnin orendit shtpiake. Me atë rast, janë lënduar ose rrahur së paku 20 Serbë, kryesisht të moshuar. Demonstruesit i kishin kallur shtëpitë nga të cilat Serbët kishin arritur të iknin. Kisha e Shën Nikollës ka psuar dëme të vogëla. Në shënjestër të demosnstruesve ka qenë edhe ndërtesa e administratës së UNMIK-ut. Gjatë këtyre sulmeve është vrarë Serbi, Sllobodan Periq, profesor i kulturës fizike në Shkollën teknike[12] . Serbët u evakuan në fshatin Shillovë[13]. Gjatë trazirave janë djegur 18 shtëpi të Serbëve, 70 janë plaqkitur dhe demoluar, ndërkaq plotësisht janë shkatëruar rreth 20 automjete Serbe dhe disa të UNMIK-ut. Sipas dëshmive të Serbëve, demostruesit kanë qenë saktësisht të njfotuar se cilat automjete u takojnë policëve Serbë nga Kosova. Në disa raste Shqiptarët lokal u kanë ofruar ndihmë fqinjëve të tyre Serbë.

Së bashku me familjen time jetoj në fshatin Kusce. Jam i punësuar në SHPK në Gjilan dhe punoj në sigurimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan. (...). Në punë nuk kemi pasur kurfarë problemesh para këtyre ngjarjeve. Për datën 16 qershor në Gjilan kanë qenë caktuar demonstratat (...) për shkak të të cilave nuk kam arrdhur në punë me veturën time me targa të vjetëra. Të nesërmën, më 17 mars, së bashku me kolegut tim kam ardhur me veturën time.

[12] Vrasësi i Serbit është arrestuar, BLIC, 8 prill 2004: "Zëdhënësi i UNMIK-ut Niraxh Sing (Nerraj Singh) deklaroi se është arrestuar një i ri Shqiptarë për vrasjen e Sllobodan Periqit"
[13] Kosovë, 18 mars, nga ora në orë, BALLKAN 19 mars 2004.

Automobilin e kam parkuar para hotelit Kristal në afërsi të gjykatës dhe stacionit policor. Pjesën e përparme të automobilit e kam afruar pranë rrethojës së betonit, kështu që targa e përparme nuk ka mundur të shihet, ndërkaq targën e pasme e kam hequr. Aty kishte shumë automjete të parkuara, rreth dhjetë prej të cilave ishin në pronësi të Serbëve. Po atë ditë kemi pasur gjykim. Nga jashtë vinte një zhurmë dhe pastaj vërejtëm një numër të madh njerëzish. Gjyqtari, i cili është Serbë, e ndërpreu gjykimin. Kjo ndohi rreth orës 15.00. Pasi dola nga ndërtesa e gjykatës pash shumë njerzë kështu që nuk pata mundësi që ta marrë automjetin. Gjyqtarët shkuan me automjete zyrtare, kurse unë dhe kolegu im mbetëm në ndërtesën e gjykatës. Shqiptarët filluan tua vëjnë flakën automjeteve. Ndëgjova dikend duke bërtitur: "Hajde me e djegë një golf pa tabela", (...) Unë hipa në katin e dytë për të shikuar se çka po ndodhë jashtë ndërtesës. Atëherë vërejta se automjetin tim e nxorrën në rrugë, pastaj e praptuan dhe ia vunë flakën (...) jashtë nuk shihej policia, kurse këtyre njerëzve u ndihmonin teksistët, stacioni i të cilëve është para hotelit. Kishte edhe automjete të tjera që u takonin Serbëve e që kishin tarka të Kosovës. Edhe ato u dogjën. Me siguri taksistën u kanë treguar se cilat automjete janë të Serbëve. Mendoj se njëri prej tyre, madje, ua ka dhënë një shishe me benzinë me të cilën i digjnin automjetet tona (...) gjatë orëve të vona të natës gjdo gjë u qetësua. Vetëm rreth orës 23,00 aritën policët ndërkombëtarë të cilët na dërguan nëpër shtëpi. Më vonë dëgjuam se në qytet janë djegur 18 shtpi të Serbëve, kurse rreth 70 janë plaçkitur dhe demoluar. Po ashtu ndëgjuam se është varë një Serb, emri i të cilit nuk më kujtohet, por e di se e quanin Bobi.

K.K. Serb, pjesëtar i SHPK
FDH intervistë më 26 mars 2004

Nga terreni jemi kthyer (policët Serbë) rreth orës l9,00. Në rrugët e Gjilanit ende kishte demonstrata. Vërejta se disa shtëpi të Serbëve ishtin djegur, ndërkaq një numër shumë më i madh i tyre ishte plaçkitur dhe dëmtuar. Të nesërmën mora vesh se ishin djegur l8 shtëpi të Serbëve në afërsi të kishës, kurse mbi 70 të tjera janë demoluar dhe plaçkitur. Ishin demoluar edhe disa duqane serbe. Kuptova se ishte vrarë një Serb në qendër të qytetit i cili kishte jetuar me të ëmëm e tij. Në platonë e hotet Kristalit ishin djegur l4 automjete, stre prej të cilave ishin xhipad, kurse ll automjete private që u takonin Serbëve. Ndër këto automjete ishte edhe i imi, me targa të vjetra. Në afërsi të automjeteve tona kishte edhe shumë automjete të tjera të Shqiptarëve, të cilat nuk ishin dëmtuar. Demonstruesit nuk kanë mundur t i identifikojnë automjetet serbe vetëm sipas regjistrimit, ngase edhe disa automjete serbe kanë qenë me regjistrim të Kosovës. Këtë e ka bërë ndonjë grup i cili disponon të gjitha informatat e nevojshme për Serbët që punojnë në SHPK.

K.K. Serb, pjesëtar i SHPK
FDH intervistë më.26 mars 2004.

Shtypi beogradas publikoi të dhënat lidhur me Serbët e rrahur të cilët gjenden për shërim nëpër spitalet e Serbisë. Sipas dëshmisë një njeriu, i cili beson se ka shpëtuar vetëm ngase sulmuesit kanë menduar se ishte i vdekur, demonstruesit nuk kishin mëshirë as ndaj nënës së tij të sëmurë.[14]

[14] Tmerr dhe llahtari, KURUR, më 23 mars 2004: "Uluritnin para shtëpisë sonë. Pamja ishte tmerruese. Nëna dhe unë ishim në kat. Kisha mundësi të kërcej nga dritarja dhe të iku deri nël oborrin e kishës, por nuk pata guximin ta lë nënën. Ajo nuk mund të levizte pa ndihmën time.Shqiptarët shumë shpejt thyen derën dhe hynë në shtëpinë

Djegia e automjeteve serbe në qendër të Gjilanit © FDH

9.1. Veprimi i KFOR-it, i policisë UNMIK-ut, SHPK-së dhe i Trupave Mbrojtëse të Kosovës

KFOR-i amerikan ka intervenuar dy herë, kur i pengoi demonstruesit t'ia vënë flakën kishës ortodokse dhe herën e dytë, kur pengoi demolimin e ndërtesës së administratës së UNMIK-ut. Të gjithë policët Serbë, pjesëtarë të SHPK, më 17 mars janë dërguar në terren jashtë Gjilanit. Më 18 mars KFOR-i aplikoi orën policore. Rrugët i kontrollonin pjesëtarët e KFOR-it dhe të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Para një viti jam punësuar si polic në Shërbimin Policor të Kosovës. Momentalish shërbej në stacionin policor të Gjilanit. Ne policët Serbë, shpehëherë vizitojmë fshatrat e komunës së Gjilanit në të cilat jetojnë Serbët. Mirëpo më 17 mars 2004 na është urdhëruar që të shkojmë në Çagllavicë. Pasdite vonë mësove se pati trazira dhe dhunë në qytetin e Gjilanit (...) Në afërsi të drejtëpërdrejtë të hotelit ku u është dhënë flaka automjeteve gjenden stacioni rajonal

---

tonë. Menjëherë iu vërsulën nënës. Njëri prej tyre iu has me shkop. Unë ndërhyra për ta mbrojtur, kurse ata filluan të më qëllojnë me purteka. Nuk di as vetë i e përballova goditjen në kokë me një shkop metalik. Kisha një ndjenjë se më është qarë koka. Gjaku rridhte vrushkull. Mu morën këmbët dhe u rrëxova pranë nënës. Nënën e shtërngova fort për dore që ta kuptojë se ende jam gjallë. Shqiptarët ikën duke menduar se ishim të vdekur. Nga fika që kishim nuk leviznim. Nuk më kujtohet sa kishte zgjatur kjo deri sa erdhën ushtarët e KFOR-it. Ata na morën para duarsh, kurse ne kukatnim nga dhembjet."

komunal policor dhe gjykata e qarkut. Si është e mundur që të gjitha këto të ndodhin në afërsi të stacionit policor i cili duhet të kujdeset për sigurinë e qytetarëve dhe pasurinë së tyre.

S.D. Serb, pjesëtar i SHPK
FDH intervistë e datës 26 mars 2004

9.2. Pasojat

Serbët, pjestarët e SHPK, vazhduan të punojnë edhe pas ngjarjeve të marsit, por në vendin e punës vijnë me përcjellje të policëve ndërkombëtarë. Këta e kanë humbur besimin për një jetë të përbashkët. Serbët e kuptojnë djegien e shtëpive të tyre si porosi se këtu në Kosovë për këta nuk ka ardhmëri[15]

Pas gjithë asaj që na ka nodhur, që është presion i madh, ne edhe më tutje punojmë dhe i përmbushim detyrat tona. Ne i mbrojmë të gjithë qytetarët, e veçanërisht shqiptarët. Shpresoj që do të jemi të mbrojtur, meqë, përndryshe nuk mund të shkojmë në punë.

S.D. Serb, pjesëtar i SHPK
FDH intervistë e datës 26 mars 2004

10. Dhuna në Viti

Ne protestat e 17 marsit kanë marrë pjesë afro 300 shqiptarë, të cilët i kane sulmuar me gurë serbët dhe shtëpitë e tyre. Disa serb me këtë rast kanë pësuar lëndime të rënda. Atë ditë protestuesit kanë thyer xhamat e shtëpive para të cilave kanë kaluar. Protesta nuk ka zgjatur shumë. Protestat kanë qenë më masovike dhe më të organizuara të nesërmen më 18 mars, kur në rrugë kanë dalur afro 1000 njerëz. Protestuestit kanë qenë të udhëhequr nga një shqiptar me altoparland. Atë ditë shume shtëpi të serbëve janë demoluar, përderisa 10 sosh janë djegur. Poashtu është djegur autobusi i UNMIK-ut i cili bart fëmijët serb per në shkolla.

Ne së pari kemi menduar se protestat janë paqësore. Askush nuk do ta kishte paramenduar se një gjë e tillë do të ndodhte në Viti. Në 17:30 është afruar masa prej 300 personave. Kanë bërtitur parulla të ndryshme. Mu duk shume e çuditshme meqë në këtë rrugëasnjëherë nuk ka pasur protesta. Turma u ndal para oborrit tonë, pastaj hynë në oborr dhe filluan të shkatërrojnë çdo gjë para vetes. Tri automjete ishin të vendosura në oborr. Që të tria i shkatërruan, e pastaj i dogjën. Derisa automjetet digjeshin disa prej tyre silleshin rreth zjarrit duke luajtur. Në shtëpi ishim nëntë anëtarë, gjashtë prej të cilëve ishin fëmijë. Ishim tepër të frikësuar. Ia vumë dryrin derës dhe njëkohësisht luteshim që të mos ndodhë ajo më e keqja.

N.ZH. Serb, nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

[15] Ngjarje të përgjakshme në Gjilan, Politika, 25 mars 2004: Ja, kështu erdhëm, vetëm me këto që i kemi në trupin tonë. Asgjë përdore, as dokumenta, as para, shkrut as gjë. Të gjitha i mori flaka. Nuk mund të besoj se kjo që na ndohi është e vërtetë. Çka kemi nga ajo që e shpëtuam kokën? Çka na duhet jeta? Çdo gjë u rrënua në pakthim.

Shtëpi dhe automjete serbe të djegura në Viti. FDH foto dokumentim.

Me datën 17 mars (...) rreth orës 14,30 babi im, Stojadin Saviq, kishte shkuar te gruaja e axhës. Aty ishte edhe nëna ime Borka me tezen Zhivkën. Që të dyja u gjendën para shtëpisë kur ariti masa. Ishin rreth 300 veta, disa nga Vitia, e disa prej tyre nga rrethina e Vitisë. Me ta ishin edhe pjesëtarët e SHPK-së. Ata së pari hynë në oborrin e Tomisllav Nojiqit. Nga frika tezja Xhivka e mbylli derën dhe hipi në katin e sipërm. Nëna ime filloi të vrapojë drejtë shtëpisë sonë. Një guri e qëlloi në hundë, kurse tulla në këmbë (...) Me qëllim që të mbrohej nëna iu drejtua demonstruesve: "Ikni ore, po vjen burri im me revole". Pas kësaj masa u largua, ndërkaq mbetën xhamat e thyer në shtëpitë tona. Ndërkohë babai im ishte para shtëpisë së gruas së axhës. Edhe ata filluan t i gjuajnë. Babain tim e qëlluan me guri në nundë, kurse gruan e axhës dikush e goditi me një dru nlë shpinë. Nëna, babai, axha dhe gruaja e axhës u fshehën te fqinji Zllatko Petkovi dhe aty mbetën deri sa u errësua kur gjendja u qetësua (...) Pastaj erdhën në shtëpinë tonë. Kur u ktheva vërejta se të gjithë xhamat ishin thyer. Askush nuk erdhi, as nga policia e as kush do qoftë tjetër, që të na pyet se si ndihemi dhe se a na nevojitet diçka.

B.S. Serb nga Vitia
FDH intervistë e dt.l7 maj 2004

Më datën l8 mars 2004 (...), diku rreth orës l4,00 u ndërpre energjia elektrike. Nuk kaloi as gjysmë ore dhe nga drejtimi i qendrës erdhi një grup i madh njerëzish. Ishin më tepër se l000.

Demonstruesit brohoritnin: "UÇK-UÇK" dhe parolla të tjera. Ata mbanin flamuj shqiptarë dhe amerikanë. Erdhën deri te kisha. Kolonës i printe një Shqiptarë me megafon i cili te kisha, kinse i ftonte njerëzit që të shpërndahen. Mirëpo, turma edhe më tutje brohoritte. Pastaj ia mësynë shtëpisë së gruas së axhës dhe menjëherë e dogjën. Unë gjendesha në shtëpinë e fqinjit tanë dhe të gjitha i shikoja nga dritarja. Demonstruesit e tjerë u nisen drejt shtëpisë tjetër, në katin e parë të së cilës gjendej kafiteria. Nuk vonoi shumë dhe ia vunë flakën edhe kësaj shtëpie. Vlenë të përmendet se aty pranë ishte automjeti i zjarrëfikjes. Zjarrëfikësit sikur pritnin që të digjet ndonjë shtëpi e pastaj të intervenojnë për ta shuar zjarrin (...) Pas pak turma u nis drejt shtëpisë sime. Së pari ia vunë zjarrin shtëpisë së gruas së axhës, Desanka Shvabiq, pastaj shtëpisë dhe kafiterisë së Tomislav Nojiqit. Demonstruesit rënuan rrethojën prej drasave, e pastaj thyen derën e lokalit tim ende të papërfunduar dhe në të e hodhën një koktej mollotovi, kështu që lokali filloi të digjej (...) pastaj masa u nis drejt lagjës së Daiqëve, ku i dogjën dy shtpi të Serbëve. Shtëpia e tretë u plaçkit, ndërkaq turma ia dha flakën edhe autobusit të UNMIK-ut i cili transportonte fëmijët Serbë deri në shkollë (...) Po ashtu, ata dogjën edhe automjetin e Novica Terziqit, i cili në atë moment ishte nisur për në qytet. Kur e vërejti masën e tubuar ai e parkoi automjetin para një shtëpie të shqiptarit dhe iku. Rreth orës 18,00 një helikopter fluturoi mbi qytet dhe që nga ai moment masa filloi të shpërndahej.

B.S. Serb, nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

10.1. Veprimi i KFOR-it, i policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK-së

Pjesëtarët e pakët të pocilisë së KFOR-it dhe të policisë së UNMIK-ut ishin vëshgues të ngjarjeve. Serbët kanë parë se disa policë të SHPK-së së bashku me demonstruesit i digjnin shtëpitë, po ashtu ata kanë vërejtur se demonstruesit iknin kur ballafaqoheshin me një numër më të madh të policëve të cilët ishtin të gatshëm të intervenojnë. SHPK-ja ka bërë evakuimin e Serbëve të sulmuar. Dukej se pjestarët e SHPK vepronin pa udhëzime, përkatësisht secili sipas ndërgjegj së vet[16]. Policët Serbë më 17 dhe 18 mars janë mbajtur në stacionin e policisë. Gjatë trazirave dyditore në Viti, nëpër rrugët e qytetit nuk është vërejtur prezenca e policisë së UNMIK-ut. Disa pjesëtarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, të veshur me rroba civile, janë parë ndër demonstrues. KFOR-i vetëm pas përfundimit të dhunës më 17 mars i mbylli të gjitha rrugët që çojnë drejtë pjesëve të qytetit të banuar me Serbë. Në këtë aksion kanë marrë pjesë edhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Të nesërmën me 17 mars Shqiptarët sërish u tubuan nëpër rrugë dhe KFOR-i sërish nuk intervenoi.

Në rrugë para oborrit kishte policë (Shqiptarë) të Kosovës dhe ushtarë të KFOR-it por as ata nuk reaguan, ndoshta ngase numri i tyre ishte i vogël. Pas pak kohe Shërbimit Policor të Kosovës i arritën përforcimet me disa automjete. Ata i parkuan automjetet para derës së shtëpisë dhe hynë këmbë. Huliganët të cilët ishin në oborr filluan të iknin. Me atë rast policët thyen dyert e shtëpisë, pasi ne nuk donim t'i hapnim. Ata hynë në shtëpi dhe na thanë se duhet

[16] Rrahje deri në humbje të vetëdijes, GLAS JAVNOSTI, 21 mars 2004: "të enjten në mëngjes (më 18 mars) turma e Shqiptarëve sulmoi shtëpinë time. Ata ma demoluan automjetin. Për fat të mirë erdhi SHPK dhe ata u larguan. Me gjithatë, sërisht u kthyen dhe atëherë nuk kishte polic rreth shtëpisë sime. Njëri u mundua t'i ndalte, por tjetri i tha në gjuhën shqipe që t'i lejojë. Ata filluan ta sulmojnë shtëpinë time, ndërkaq unë këceva na taraca dhe ika duke vrapuar. Ata më vërejtën dhe më mbërinë te kopshti. Menjëherë filluan të më godasin me duar dhe këmbë dhe më asgjë nuk më kujtohet. Jam zgjuar në spitalin e Vitisë".

të evakuohemi. Ata na përcollën deri te automjetet e veta dhe pastaj të gjithëve së bashku na dërguan në stacionin policor.

N.ZH. Serbë nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

(Më shtatëmbëdhjetë mars) aty ishte Shërbimi Policor i Kosovës i cili asgjë nuk ndërmori, ashtu sikur as KFOR-i, që e kishte punktin e vet vetëm disa dhjeëtra metra më largë (...) KFOR-i atë mbrëmje e bllokoi rrugën, kështu që askush nuk mund të kalonte. Pasi KFOR-i e blokoi rrugën, me ta qëndronin 3-4 pjesëtarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (...) (më tetëmbëdhjetë mars) në masën e demonstruesve vërejta disa pjesëtarë të TMK-së në rroba civile. KFOR-i dhe policia e SHPK-së ishin në rrugë, por pothujse asgjë nuk ndërmorrën për ta ndalur dhunën. Është për tu çuditur që nuk e kam parë çoftë edhe një polic të UNMIK-ut apo pjesëtarë të SHPK-së nga rradhët e bashkësisë Serbe. Më vonë kuptova se Serbët e SHPK kishin qëndruar në stacionin policor dhe se atyre nuk u është lejuar të dalin për shkak të sigurisë së tyre (...) Pak më vonë vërejta policët e SHPK-së të cilët i hudhnin dërrasat e rrethojës në lokal që të digjej edhe më fortë.

B.S. Serb nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

10.2. Pasojat

Serbët kan pritur se përfaqësuesit Shqiptarë të komunës do të pengojnë dhunën ndaj bashkëqytetarëve Serbë. Kryetari i Komunës së Vitisë dhe njëri prej komandantëve të KFOR-it amerikan ishin të gatshëm që pas ngjarjeve të takohen me Serbët, por Serbët nuk pranuan. Shikuar përgjithësisht, Serbët kanë pritur më shumë nga fqinjët e tyre Shqiptarë, edhe pse përmendin rastin e Shqiptarëve në rrugën e Shën Savës te "Ndërtesat e verdha", të cilët së bashku me familjarët e vet kanë dalur në rrugë dhe i kanë penguar demonstruesit që tua vëjnë zjarrin shtëpive të Serbëve. Sipas shkrimeve të disa gazetave të Beogradit, pas evakuimit të Serbëve, shtëpitë e tyre janë shënuar me ngjyrë të bardhe dhe në to janë shënuar emrat e Shqiptarëve "pronarëve të ardhshëm" [17]. Pas një jave 60 Serbë që kishin ikur në Vërbovc/Urbod, u kthyen në shtëpitë e tyre. Në muajin qershor filloi rindërtimi i shtëpive të para.

Përveç shtëpisë sonë në Viti janë djegur rreth 10 shtëpi të Serbëve. Vetëm pas 15 ditësh jemi kthyer dhe kemi vazhduar të jetojmë në pjesën tonë të shtëpisë e cila kishte mbetur pa u djegur. Tani për tani nuk kemi probleme. Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka dalur në vend dhe ka bërë shikimin. Dëmet e shkaktuara janë vlerësuar në shumën prej 158.000 euro. Në të vërtetë, dëmi që i është shkaktuar vetëm një pasurie, është shumë më i madh. Nuk e di se si mendojnë të planifikojnë që me këto të holla të bëjnë renovimin e të gjitha shtëpive dhe të paguajnë dëmin në emër të automjeteve të shkatërruara.

N.ZH. Serb nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

[17] Sërish zjarrë, VEQERNJE NOVOSTI, 23 mars 2004

Pas këtyre ngjarjeve kryetari i Komunsë së Vitisë, Musa Misini, së bashku me një komandat të KFOR-it amerikan tentoi që të organizojë një takim me ne. Mirëpo, ne nuk i pranuam, sepse ata asgjë nuk kanë bërë për ta penguar dhunën ndaj Serbëve. Kam dëgjuar se ka dalur një komision për vlerësimin e dëmeve, por neve asgjë nuk na është thënë, as se kur do të na rindërtohen shtëpitë, e as çfarë është dëmi i vlerësuar. Po ashtu, as fqinjët Shqiptarë nuk kanë bërë asgjë për të penguar djegien e shtëpive tona. Në disa raste ata kanë ofruar ndihmë, por jo edhe në lagjen tonë. Një rast i tillë ka ndodhur në rrugën e Shën Savës, me çrast Shqiptarët së bashku me familjarët e tyre kanë dalur në rrugë dhe nuk e kanë lejuar turmën qu tu afrohet shtëpive të Serbëve. Po kështu kanë vepruar edhe te ndërtesat e verdha.

B.S. Serb nga Vitia
FDH intervistë e datës 17 maj 2004

11. Djegia e lagjës së Hashkalinjve në Vushtrri

Në Vushtrri kanë jetuar 95 familje të Hashkalinjve me 434 anëtarë. Ata përbënin të vetmën bashkësi etnike në qytet. Shumica e tyre ishtin të kthyer që jetonin në shtëpitë e rindërtuara dhe të posandërtuara. Disa qindra Shqiptarë u tubuan në sheshin qendror të qytetit duke brohoritur kundër UNMIK-ut për shkak se nuk është në gjendje t'i mbrojë të drejtat e Shqiptarëve në Kosovë, veçanërisht të fëmijëve[18]. Atë ditë demonstruesit u shpërndanë pa shkaktuar incidente. Mirëpo, me katën 18 mars, në orët e pasditës demonstruesit sërish u tubuan. Në fillim ishin 70 deri 80, ndërkaq me afrimin e natës grupi shtohej. Demonstruesit së pari ia vunë zjarrin kishës ortodokse të Shën Ilisë, e pastaj hynë në *Rreth orës* lagjën e Hashkalinjve dhe ua dogjën pothuajse të gjitha shtëpitë.

Në orën 16.30 (më 18 mars) u dogj kisa ortodokse. E vërejta një grup njerëzish, që nuk ishte aq i madh, ndërmjet 70 e 80 veta i cili ia kishte mësy lagjës së Hashkalinjve. Këta përbënin grupin më ekstrem të demonstruesve. Qytetarët kureshtarë formuan grupin tjetër dhe në fillim vetëm vështronin se çka po ndodhë. Mirëpo, disa nga grupi i dytë iu bashkuan grupit të parë ekstremistë. Filloi të bie nata, kështu që tani më nuk dihej se kush është kush. Ata hynë në lagjën e Hashkalinjve dhe filluan tua vënë zjarrin shtëpive.

T.H. Shqiptar nga Vushtrria, i punësuar në Zyrën për Çështjet e Pakicave dhe Kthim
FDH intervistë e datës 26 prill 2004

Dhuna u bart edhe në fshatin Sllatinë në të cilin u dogjën 15 shtëpi të Serbëve, tetë prej të cilave ishin të braktisura. Serbët pohojnë se Shqiptarët nga Studimja kanë kryer sulm të armatosur ndaj fshatit Gojbujë në të cilin ata jetojnë. Me atë rast Shqiptarët kanë gjuajtur me armë në ushtarët e KFOR-it francez, të cilët e kanë siguruar këtë fshat[19].

---

[18] Një ditë e përgjakshme në Kosovë, shumë të vdekur dhe të lënduar, ZËRI, 18 mars 2004

[19] *Katër ditë e mbrojtën fshatin*, GLAS JAVNOSTI, 24 mars 2004: "Sulmi filloi më 18 mars rreth orës 18,00 me të shtëna. Në fshat në atë moment gjendeshin rreth 10 ushtarë të KFORI-it të cilët nuk ishin në gjendje që të na mbrojnë. Ata propozuan që të na evakuojnë. Ne këtë e refuzuam dhe në kamion u futën vetëm gratë, fëmijët dhe të sëmurit. Në fshat mbetën rreth 40 meshkuj (...) posa shkuan gratë, fëmijët dhe të sëmurit, ata që mbetën u organizuan për ta mbrojtur fshatin. Asgjë tjetër nuk u kishte mbetur. Shtrohej çështja – ose të mbesim dhe ta mbrojmë fshatin, ose të evakuohemi. Më së lehti është që të shkojmë dhe t'i lëmë të gjitha. Mirëpo, sikur të kishim të ishim larguar nuk do të kishim ku të kthehemi (...) ushtarët Francezët ishin të befasuar nga sulmet që

Shtëpi e djegur e Ashkalinjëve në Vushtri. FDH foto dokumentim.

Në fshatrat e tjera të kësaj komune, si për shembull në Prilluzh, ku jetojnë Serbët, nuk pati incidente, e as në Gojbujë dhe Banjë. Kemi vetëm një fshat në të cilin janë djegur 15 shtëpi. Ky është fshati Sllatinë. Nga këto 15 shtëpi, 7 kanë qenë të banuara, kurse të tjera kanë qenë të zbrazëta. Këto shtëpi janë djegur në natën ndërmjet 17 e 18 marsit. Me atë rastë janë rahur disa Serbë. Nuk arrita që të takohem me ta dhe të bisedoj.

T.H. Shqiptar nga Vushtrria, i punësuar në Zyrën për Çështjet e Pakicave dhe Kthim
FDH intervistë e datës 26 prill 2004

11.1. Veprimi i KFOR/it, i policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK

Shërbimi Policor i Kosovës e ka organizuar evakuimin e Hashkalinjve, dhe lidhur me këtë kanë dhënë edhe ndihmën e vet edhe qytetarët. Në kohën e sulmit dhe gjatë evakuimit nuk kanë qenë të pranishëm policët ndërkombëtarë.

Diku rreth orës 19,00 policia filloi evakuimin e Hashkalinjve nga shtpia e tyre. Është interesent të përmendet se me rastin e evakuimit ishin të pranishëm vetëm pjesëtarët e SHPK,

---

ishin drejtuar kundër tyre (...) rreziku, së paku tani për tani ka kaluar.Në fshat janë kthyer edhe fëmijët. Megjithatë, asnjëherë nuk dihet kur Shqiptarët sërish do të na sulmojnë".

kurse jo edhe policët e UNMIK-ut. Kishte mjftë qytetarë Shqiptarë që ndihmuar realizimin e evakuimit. Edhe unë kamë qenë njëri prej tyre. Duhej pasur parasysh të mos ballafaqohemi me ekstremistët, sepse kjo do të ishte me rrezik. Një numër të Hashkalinjve e kaluam nëpër disa rrugica. Ata i dërguam në shkollën policore në Vushtrri (...) ku e kaluan natën. Ditën e nesërme ata u transferuan në bazën e KFOR-it në Smrekovnicë. Aty qëndruan deri më 21 mars, e pastaj përfundimisht u vendosëm në bazën ushtarake në Novosellë të Magjunajve. Këtu qëndrojnë edhe tani. Disa herë kam tentuar të kontaktojë me ta, por ata nuk dëshirojnë të më pranojnë.

T.H. Shqiptar nga Vushtrria, i punësuar në Zyrën për Çështjet e Pakicave dhe Kthim
FDH intervistë e datës 26 prill 2004

11.2. Pasojat

Menjëherë pas djegies së lagjes, Hashkalinjtë kërkuan publiksht ndihmë për tu transferuar në ndonjë vend të tretë.

Janë djegur përkatësisht janë shkatëruar 71 shtëpi, 54 janë djegur plotësisht, kurse 9 prej tyre pjesërisht. 3 shtëpi janë demoluar, ndërkaq një është demoluar pjesërisht. Janë shkatruar 2 dyqane dhe 44 objekte ndihmëse. Sipas disa vlerësimeve dëmi arrinë vlerën prej 1.200.000 eruro.

T.H. Shqiptar nga Vushtrria, i punësuar në Zyrën për Çështjet e Pakicave dhe Kthim
FDH intervistë e datës 26 prill 2004

12. Evakuimi i pleqëve nën rrebeshin e gurrëve në Ferizaj

Deri më 18 mars në Ferizaj kanë jetuar 12 Serbë, prej tyre 10 plaka dhe 2 pleq, të cilët kanë gëzuar mbrojtjen e përhershme të KFOR-it Grek. Serbët kanë braktisur shtëpitë e tyre dy herë në muaj kur shkonin në Shtërpcë për të blerë gjëra të ndryshme ose te mjeku dhe këtë në përcjellje të KFOR-it. Më shtatëmbëdhjetë mars, gjatë kohës së demonstratave në shtëpitë e tyre është gjuajtur me gurë, mirëpo, siç thonë ata vetë, këtyre veprimeve nuk u kanë kushtuar rëndësi të madhe sepse ato ndodhnin kohë pas kohe. Ditën e nesërme, më 18 mars rreth 3000 veta protestonin rrugëve të qytetit. Një grup pak më i madhë i demonstruesve u nis drejtë shtëpive Serbe dhe kishës ortodokse. Sikur edhe në qytetet e djera demonstruesit filluan sulmin e tyre duke gjuajtur me gurë. Pjesëtarët e KFOR-it grek dhe amerikan i evakuan Serbët, edhe pse disa prej grave refuzonin t'i braktisnin shtëpitë, duke i mbrojtur me trupin e vet. Pasi Serbët hynë nëpër automjetet e KFOR-it demonstruesit ua vunë flakën shtëpive. Me atë rast u dëmtua edhe kisha e mbretit të shenjt Uroshit. Një Shqiptare i vizitoi Serbët në bazën e KFOR-it, pasi në televizion kishte parë pamjet se si ndaj tyre demonstruesit kanë hudhur gurë. Gjatë 17 e 18 marsit në Ferizaj janë lënduar 46 veta, ndërkaq ka vdekur Alumuhamet Murseli. Vetëm një ditë pas largimit nga shtëpia, Dushanka Petkoviq kishte vdekur në bazën e KFOR-it.

Me datën 17 mars dëgjuam se kishin filluar demonstratat nëpër rrugët e qytetit. Këtë e kuptuam posaçërisht kur filluan ta gjuajnë me gurrë derën e shtëpisë sonë. Kjo nuk ishte dukuri e rrallë (...). Gjatë natës mbretëroi qetësia. Ditën e nesërme me 18 mars, rreth orës 10,00, masa u tubua para shtëpive tona (...) Në rrugë mbretronte një zhurmë e tmershme,

mirëpo pasi ushtarët na nxorën nga shtëpitë mbretëroi një qetësi absolute. Demonstruesit u ndalën. Unë e drejtova shikimin në drejtim të tyre. Në reshtin e parë qëndronte një djalosh i ri i veshur në të zeza. Kishte ndërmjet 25 dhe 28 vjet. Ai dha shenjë me dorë dhe ndaj nesh filloi sulmi. Na gjuanin me gurë. Para tyre ishin policët (SHPK) të cilët fare nuk reaguan. Ushtarët e KFOR-it amerikan e mbronin me trupin e tyre nënën time. Një gur më goditi në gjurin e djathtë. Po ashtu, morra një lëndim jashtëzakonisht të rëndë të ashtit të kofshës. Përndryshe unë jam e paralizuar edhe kjo më tepër e vështërsonte jetën time (...) Pasi na nxorrën nga automjetet pasoi një duartrokitje (...) të gjithëve na sollën në bazën e KFOR-it grek. Serbët e tjerë i evakuoi Shërbimi Policor i Kosovës. Sipas vlerësimeve të policisë së UNMIK-ut kishte rreth 3000 njerëz, kryesishtë të rinj, edhe pse prijësit e tyre nuk ishtin aq të rinj (...) Një Shqiptare e cila na kishte parë në televizion duke dalur nga shtëpitë tona, kishte vendosur që të na vizitojë. Ajo filloi të qajë kur na pa në atë gjendje.

L.N. Serbe nga Ferizaj, të cilën demonstruesit e kanë gjuajtur me gurrë
FDH intervistë e datës 2 maj 2004

Rreth orës 10,00 erdhi KFOR-i grek i cili na tha se duhet të evakuohemi. Unë asesi nuk dëshiroja të dal nga shtëpia. Hyra në shtëpi dhe e mbylla derën me çelës. Fillova të qajë duke i lutur që të mos më nxjerin nga shtëpia. Ata as që dëshironin të më dëgjonin. Ata më tërhoqën me forcë dhe më futën në automjetin e tyre. Me këtë rast më shkaktuan mbresa nëpër trup. Më dërguan drejtë në bazën KFOR-it grek. Aty hasa edhe disa Serbë të tjerë. Unë isha e fundit që kishte arritur në këtë bazë. Kemi ushqim të mirë dhe pije. Nëse dëshirojmë të shkojmë në Shtërpcë ushtarët na dërgojnë atje dhe na kthejnë. Mirëpo, ata nuk do të na mbajnë përgjithmonë me ushqim në këtë vend. Më vonë mësova se shtëpia ime së pari është plaçkitur e pastaj është djegur pastaj janë djegur me rend të gjitha shtëpitë Serbe në qytet. Tani më nuk kam shtëpi, ndërkaq nipërve nuk kam se çka tu lë në trashëgim. Pikërisht për këtë nuk kam dashur ta braktisi shtëpinë time. Do të ishte më mirë sikur edhe unë të isha djegur së bashku me shtëpinë. Është formuar një komision për vlerësimin e dëmeve, por unë atyre aspak nuk u besoj.

V.S. Serbe nga Ferizaj, të cilën policët e kanë nxjerë me dhunë nga shtëpia
FDH intervistë e datës 2 maj 2004

12.1. Veprimi i KFOR-it, i policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK-së

KFOR-i, policia e UNMIK-ut dhe SHPK nuk penguan grumbullimin e demostruesve para shtëpive të Serbëve, sulmet poshëruese ndaj pleqëve si dhe shkatërrimin e pasurisë së tyre. Evakuimin e Serbëve e bënë SHPK dhe KFOR-i. Me rastin e evakuimit, ushtarët amerikanë i mbrojtën me trupat e tyre pleqët. Ushtarët grekë dhe amerikanë tentuan të pengojnë shkatërrimin e kishës së Shën Uroshit, por edhe ata u sulmuan nga demonstruesit. Me atë rast u lëndua rëndë një ushtar grek, kurse 16 ushtarë të tjerë u lënduan lehtë.[20]

[20] *Një grup i banditëve gjuante bomba mbi ushtarët e mi*, NEDELNI TELEGRAF, 24 mars 2004 ".... rreth 500 veta kah hudhur në Ferizaj më 17 mars bomba dhe shishe me benzinë në tanket e KFOR-it. Sulmi vazhdoi edhe pasi komandanti i KFOR-it grek, me qëllim të shpërndarjes së demonstruesve, urdhëroi ushtarët e vet që të gjuajnë në ajër. Sulmuesit nuk u tërhoqën, madje numri i tyre sa vinte e shtohej dhe arrit në 3000 veta kështu vazhdoi deri sa ardhën helikopterët amerikanë të cilët filluan të hudhin gazlotësjellës ndaj Shqiptarëve të tubuarë. Gjatë këtyre konflikteve, ushtari i batalionit 525 të parashutistëve të mekanizuar grek mori djegie të shkallës së

Ditën e parë (më 17 mars) na vizituan policia e UNMIK-ut dhe e SHPK-së, mirëpo ne nuk u besojmë atyre dhe kjo u dëshmua ditën e nesërme (...) Para derës ishte një tank grek. Masa filloi ta gjuaj me gurë derën e shtëpisë sonë. Ata hudhnin gurë edhe në tankun grek. Me atë rast u qëlluan kokë një ushtar grek. Sipas të gjitha gjasave, tanku u largua për t'i ofruar ndihmën e nevojshme ushtarit të lënduar. Në orën 11,30 thirri policia e UNMIK-ut dhe na thanë që të mos shkojmë askund sepse janë nisur për te ne ushtarët amerikanë. Pas 15 minutash arritën pjesëtarët e KFOR-it amerikan me 2 automjete. Ata u vendosën në të dy anët e derës së shtëpisë sonë, duke krijuar një koridor të vogël për kalimin tonë. Ushtarët amerikan reaguan ashpër duke na urdhëruar që të përgatitemi për 2 minuta. Ne refuzuam ta braktisim shtëpinë, kurse tre ushtarë amerikanë e kapën karrocën në të cilën ishte e ulur nëna ime dhe e futën në automjetin e tyre. Edhe motra ime refuzonte të dilte, por kur e pa se unë dhe nëna ishim nisur drejtë automjeteve edhe ajo doli nga shtëpia (...) Derisa dilnim nga shtpia na gjuanin me gurë. Para tyre qëndronin policët Shqiptarë, të cilët fare nuk reaguan. Ushtarët e KFOR-it amerikan e mbronin me trupin e tyre nënën time.

L.N. Serbe nga Ferizaj, të cilën e kanë evakuar ushtarët amerikan
FDH intervistë e datës 2 maj 2004

Të nesërmën erdhi zëvendëskomandanti i bazës amerikane, kolonel Sanders. Vetëm disa çaste më parë përfaqësuesit e policisë së UNMIK-ut na kumtuan lajmin se shtëpitë tona ishin djegur. Këtë e përsëriti edhe koloneli Sanders. Dushanka Petkoviq, e cila vuante nga sëmundja e zemrës ju drejtua kolonelit me këto fjalë: "Ku ishit ju? Pse nuk na mbrojtët?". Pas kësaj gjendja e saj u keqësua edhe më tepër. Gjendja e saj rëndohej gjithënjë e më tepër e ajo vdiq vetëm pas 15 minutash. Mjekët grekë tentuan t'i japin ndihmë, por ajo nuk kishte shpëtim.

L.N. Serbe nga Ferizaj, të cilën e kanë evakuar ushtarët amerikan
FDH intervistë e datës 2 maj 2004

13. Rrënimi i kishave në Gjakovë

Më tepër se 1000 Shqiptarë dolën në rrugë më datën 17 mars rreth orës 14,00, duke protestuar për shkak të vdekjes së fëmijëve dhe në shenjë përkrahjeje të Shqiptarëve nga pjesa jugore e Mitrovicës. Ndër demonstrues kishte Shqiptarë të rinj nga fshati që kishin ardhur me transport të organizuar. Pas shëtisë nëpër qytet demonstruesit u tubuan para komunës, të cilëve iu drejtuan përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës, duke shprehur solidaritetin e tyre me demonstruesit. Për të penguar rritjen e masës, ushtarët italian mbyllën të gjitha rrugët që qonin deri te komuna. Pasi demonstruesit e rrahën një plak, automjeti i blinduar i KFOR-it kaloi

---

dytë në fëtyrë dhe qafë, derisay mbronte punktin vëzhgues te kisha e Shën Uroshit në Ferizaj, ku janë strehuar Serbët e zhvendosur. Një ushtar amerikan dhe 16 grek morën lëndime nga mjetet shpërthyese që i hudhnin Shqiptarët. Aktet e qmendura të dhunës, shkatërimi i vendeve të shenjta dhe sulmet ndaj personave të pafajshëm krijuan imazhin të cilin bota nuk do ta harojë ayq shpejtë (...) Nga mediat kamë dëgjuar rrëfimin se disa ushtarë të mi kanë qenë ncitës të këtyre incidenteve. Kjo nuk është e vërtetë. Këta dëshmitarë gënjështarë kanë haruar të thonë se është shtënë me armë ndaj ushtarëve të mi grekë dhe amerikanë derisa ishin duke ruajtur kishën e Shën Uroshit, pastaj se janë hedhur rreth 20 granata dore dhe se ndaj ushtarëve janë hedhur bomba me flakë me qëllim që ushtarët e mi të lëndohen ose të vriten (...) Po ashtu konsideroj, se të gjithë liderët janë përgjegjës për këto sulme, e posaçërisht udhëheqja e Kuvendit të Komusnës së Ferizajt.

nëpër masën e tubuar gjë që shkaktoi lëvizje të reja të demonstruesve[21]. Pas kësaj demonstruesit u nisën drejtë kishave, dy prej të cilave ishtin të braktisura. Në kishën e tretë, përkatësisht në Tempullin e Shën Marisë, në të cilin ishin të vendosura 5 plakat vetme Serbe në Gjakovë, pjesëtarët e KFOR-it italian, të cilët i ruanin natë e ditë, mezi arritën t'i avakojnë për shkak të vërsuljeve të masës: demonstruesit e dogjën këtë dhe dy kisha të tjera; Kishën katedrale të trinisë së shenjët dhe kishën e Shën Llazarit. Pas disa ditësh shërbimet komunale organizuan menjanimin e rrënojave.

14. Evakuimi i të kthyerve në Biqë dhe Grapc

Më 17 mars afro 1500 shqiptarë nga Klina janë nisur për në Biqë dhe Grapc përmes fshatit të banuar me shqiptarë Shtupël. Sipas serbëve të Biqës, sulmi ndaj fshatrave serbe është parandaluar nga përfaqësuesi i fshatit Shtupël, i cili e ka kthyer prapa masën. Megjithatë, më 18 mars në Biqë është djegur një shtëpi përderisa tre shtëpi tjera janë demoluar dhe plaçkitur. Pjesëtarrët e KFOR-it italian në mbrëmje të 17 dhe 18 marsit kanë bërë evakuimin e 60 serbëve nga fshati Biqë dhe prej 30 deri 40 serb nga fshati Grapc. Serbët nga Biqa KFOR-i i ka dërguar me kaminoë në bazën e tyre në Gjakovë, përderisa serbët e fshatit Grapc me helikopterë i kanë dërguar në fshatin Osojan. Në shtëpitë e tyre serbët janë kthyer më 25 mars. Me tu kthyer, kryeari i komunës së Klinës i ka vizituar serbët e Biqës dhe ju ka premtuar se komuna do të ju shpagojë dëmin e shkaktuar.

Për të ardhur prej Klinës për në Biqë dhe Grapc medoemos duhet të kalohet përmes fshatit shqipar Shtupël. Kur masa e shqiptarëve arriti në Shtupël, Ismet Dauti përfaqësues i fshatit nuk i ka lejuar të vazhdojnë drejt Biqës dhe Grapcit. Gjatë kësaj kohe KFOR-i ka arritur të i përgatisë serbët e Biqës për evakuim. Rreth orës 20:00 kanë filluar të shtënat nga kodrat përreth. Nuk shihej se kush gjuante. Mesiguri kanë gjuajtur në ajër meqë asnjë plumb nuk ka goditur fshatin. Njerëzit kanë qenë të tmeruar. Për këtë arsye unstarët italianë i kanë udhëzuar të hipin në kaminotë e tyre. Njerëzit e Biqës kanë pritur në këto kaminoë deri në 4:00 të mëngjesit (...) Pastaj me ato kamionë i kane shpier në bazën italiane, në afërsi të Gjakovës. Të kthyerit e fshatit Grabc KFOR-i i ka bartur me helikopter në Osojan. Prej 18 deri më 25 mars fshatërat Biqë dhe Grabc kanë qenë të zbrazur. Kur jemi kthyer kemi parë se një shtëpi, në fund të fshatit, që gjendej përbri fshatit shqiptar fqinjë Ozdrim, ishte djegur ndërsa tre shtëpi tjera ishin plaçkitur dhe demoluar. Shtëpitë tjera janë të paprekura dhe asgjë nuk mungon. Njerëzit kanë qenë të lumtur që shtëpitë e tyre nuk janë djegur, megjithatë ata ishin të frikësuar. Për një kohë mendonim t'a lëshonim fshatin, por kemi duruar. Menjëherë pas kthimit në shtëpi ka ardhur kryetari i komunës së Klinës, Ramë Manaj, i cili na premtoi se shtëpia e djegur dhe ato të demoluara do të rindërtohen shpejt. Mendoj se ka qenë i sinqertë. Përmomentin në fshat jetojnë 25 mashkuj nga Klina dhe afro 30 serbë nga Biqa. Të gjithë kohë pas kohe udhëtojnë për në Sërbi, por të shumten e kohës janë këtu. Çdo të diele kemi vozitje të organizuar për në Mitrovicë, ku i blejmë gjërat ushqimore. Përditë na viziton KPS, në të shumtën e rasteve janë shqiptare dhe sillen shumë korrekt. Policija e UNMIK-ut duket shumë rrallë.

B.D. Serbi kthyer në Biqë
FHD intervistë më 13. qershor 2004.

[21] Një ditë e përgjakshme në Kosovë, shumë të vdekur dhe të lënduar ZËRI, 18 mars 2004

14.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe KPS

Si preventivë, KFOR-i ka evakuuar serbët e Biqës dhe Grapcit. Pas kthimit të serbëve policia e Kosovës patrullon rregullisht.

14.2. Pasojat

Serbët nga Biqa besojnë se siguria e tyre do të rregullohet poqëse do të kenë marrëdhënie të mira me fqinjët shqiptare. Shqiptarët kohë pas kohe shkojnë në vizitë tek serbët e Biqës, por edne e bëjne këtë fshehurazi.

Më vjen keq për banorët e Bellopojës sepse janë kthyer në fshat pa kurrëfarë marrëveshje me shqiptarët, prandaj edhe ata kurre nuk e kanë pranuar kthimin e tyre. Prej se kanë ndodh ngjarjet e marsit po mendoj të kyqem në poliktikë. Më së shumti më pengon qëndrimi i atyre të Mitrovicës. Ata ende nuk po e kuptojnë se vetëm dialogu me shqiptarët mundet të na mbrojë prej shqiptarëve. KFOR-i vjen e shkon, ndërsa ne pastaj mbetemi të pambrojtur. Sa i përket shqiptarëve (...) shqiptarët vijnë fshehurazi, sidomos ata me të cilët i kemi pas marrëdhëniet e mira para ngjarjeve të marsit. Një herë jam gjendur në një situatë shumë komike. Erdhi një çift bashkëshortor të më vizitojë në Biqë. Pak pas tyre erdhi një shqiptarë. E dija që nuk mund ta pranoj brenda në shtëpi se ai pastaj do t'i shihtë këta dy shqiptarët tjerë që ishin brenda. Poashtu edhe ata që ishin brenda do ta shihnin këtë tjetrin që po vizitonte një serb. Të gjithë kanë frikë se dikush do t'i paraqesë. Më është dashur të kërkoj falje kinse isha shumë i zënë për momentin dhe se nuk mund të pija kafe me të, dhe se të vinte më vonë. Mysafirëve, çiftit bashkëshortor që ishin brenda ju thash se ishtë një fqinj serb i cili kërkonte ta vizitoj më vonë për t'i ndihmuar diçka. Pas një kohe, çifti bashkëshortor shkoi, ndërsa pak më vonë erdh shqiptari të cilin nuk e kisha lëshuar në shtepi më parë për të pirë kafe.

B.D. Serb, i kthyer në Biqë
FDH intervistë 10. korrik 2004.

Gjatë dhunës së marsit fshati Biqë ka kaluar shumë mirë. Vetëm një shtëpi është djegur. Tani të gjitha shtëpitë po rindërtohen shumë shpejt. Pikërisht unë dhe vëllau im i kemi përfunduar gjashtë shtëpi të reja për serbë. Megjithse nuk ka aty shumëçka për të punuar apo ndërtuar. Në Biqë i kalojmë dy muaj në vit. Është shumë mërzitshëm sepse çdo ditë fliten ndodhitë e njëjta, që janë treguar qysh ditën e parë. Fatkeqësisht, momentalisht nuk mund të jetë ndryshe pasi që nuk ka mundësi të dilet prej fshatit, me çka do të pasurohet jeta, por...Ndonjëherë disa shqiptarë vijnë, por gjithmonë fshehurazi që të mos kuptohet. Kurrë nuk guxojnë të vijnë dy persona, sepse frikësohen se tjetri do të tregojë. Më së shumti thonë se ju frikësohen atyre qe kanë ardhë nga Shqipëria veriore. Shumë janë të ashpër (këta të Shqipërisë veriore) dhe gjithmonë u vjedhin diçka. E vetmja ndodhi interesante ka qenë festa e spasovdanit në fshat. Pëerndryshe fshati është krejtësisht i vdekur.

R.D. Serb, i kthyer në Biqë
FDH intervju 10. jula 2004.

15. Sulmi ndaj Serbëve të kthyer në Bellopojë si dhe djegia e shtëpive të tyre

Demonstratat në Pejë kanë filluar më 17 mars në orën 14:00 kur disa mijë shqiptarë janë tubuar në sheshin qendror të qytetit duke brohoritur parulla kundër UNMIK-ut dhe Serbëve.[22] Sipas gazetës kosovare Koha Ditore situata është ndryshuar rrënjësisht kah ora 14:30 kur pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut kanë gjujatur pacak në marshin e protestuesve. Pas kësaj, protestuesit kanë gjujatur me gurë ndërtesën e administratës së UNMIK-ut, i kanë djegur disa automjete të UNMIK-ut si dhe kishën ortodokse Jovane Preteča i Krstitelj[23]. Një grup prej afro 200-300 protestuesish janë drejtuar kah fshati serb Bellopojë në të cilin jetojnë 34 mashkuj, persona të kthyer. Në atë kohë në fshat ka qenë duke u mbajtur takimi në mes të kthyerve në fshat dhe serbëve të zhvendosur rreth kthimit të këtyre të fundit dhe ndërtimit të shtëpive të tyre. KFOR-i italian e ka ndaluar hyrjen e grupit protestues në fshat, mirëpo shqiptarët kanë arritur të depërtojnë nga të gjitha drejtimet. Sipas deshmive okulare afro 4000 – 5000 shqiptarë kanë hyrë në fshat dhe kanë filluar të djegin dhe rrënojnë. Masa ka arritur të tejkalojë punktin e KPS në afërsi të fshatit pa problem. Protestuesit kanë djegur të 25 shtëpitë e rindërtuara, trafostacionin, kanë përdhunuar dhe dëmtuar varrezt serbe dhe kanë djegur kishën ortodokse 'Vavedenja presvete Bogorodice'. Pjesëtarët e KFOR-it italian i kanë ekakuuar të gjithë serbët. Në sulmin e protestuesve disa prej serbëve janë lënduar rëndë, përderisa policia e UNMIK-ut e ka vrarë Esat Tahiraj shqiptarë nga Novosella në momentin kur ai me thikë ka dashur të vrajë një serb.

Me shtatëmbëdhjetë mars në fshati ishim 34 meshkuj. Ishim duke mbajtur takim në shtëpinë e famullisë lidhur me kthimin nëpër shtëpia. Pas takimit kemi drekuar, dhe mëpastaj i kemi rënë vërdallë fshatit dhe kemi biseduar se ku do të ishte hapësira më e mirë për ndërtimin e 15 shtëpive tjera. Qendra për koordinim na ka premtuar se do ta përkrahin materialisht ndërtimin. Ne në atë moment nuk kemi pas ide se çka ka qenë duke ndodhur në Mitrovicë dhe qytetet tjera. Ishte diku kah ora 15:00 kur kemi vërejtur grupën e 200-300 njerëzve (...) Nuk dinim se për çka ishte fjala. Shumica ishin të rinjë. Ushtarët nuk i lejuan të kalojnë punktin. Brohoritnin UÇK, UÇK (...) Iu afruan edhe vetë punktit të KFOR-it italian. Ushtarët nuk i lejonin të kalojnë punktin. Ata qëndruan aty 10 minuta, dhe në atë kohë ata na shanin dhe bënin me gjeste se do të na mbysin. Megjithatë KFOR-i ka arritur të i kthejë prapa. Nuk kanë kaluar as dhjetë minuta kur kemi vërejtur grupe të mëdha njerëzish duke ardhur nga të gjitha anët. Kishin flamujë shqiptarë dhe gjëra të tjera në duar. Ishte një djalë i cili kishtë altoparlant përmes të cilit i thirrte njerëzit për sulm. Mesiguri kanë qenë diku afro 4000-5000 (...) Vetëm një veturë e policisë së UNMIK-ut ishte e parkiruar prapa. Dy policë amerkianë ishin në veturë, një femër dhe një mashkull. Ata na thanë që të hyjmë brenda në famulli dhe të presimderi sa të vijë përforcimi i KFOR-it. Ne hymë në famulli dhe pritnim si delet që presin të ju vijë radha për therrje.

M.O. Serb nga Bellopoja
FDH intervistë 4. korrik 2004.

---

[22] *Ditë e përgjakshme në Kosovë, shumë të vrarë e të plagosur,* ZERI, 18. mars 2004
[23] *Dhuna e ashpër në rajonin e Dukagjinit*, KOHA DITORE, 18. mars 2004.

Sipas raporteve të mediave të Beogradit disa mijë shqiptarë kanë gjujatur gurë dhe koktejë të Molotovit në *famulli* ku kanë qenë të vendosur serbët. Gjatë evakuimit një nga protestuesit u sul drejt Miladin Bačević-it dhe e shpoi disa herë me thikë. Pjesëtarja amerikane e policisë së UNMIK-ut së pari është munduar ta ndalojë duke bërtitur "stop, stop" dhe pastaj meqë nuk është ndalur e ka gjujatur me revole dhe e ka vrarë sulmuesin.[24]

15.1. Veprimi i KFOR-it, policisë së UNMIK –ut dhe KPS

KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut kanë qenë të gatshëm të ju ndihmojnë serbëve, mirëpo ishin të paktë në numër për të ndalur dhunën e protestuesve. Afro njëzet pjesëtarrë të KPS as nuk kanë provuar të ofrojnë çfarëdo rezistence ndaj protestuesve. Ustarët e KFOR-it italian kanë krijuar mur të gjallë "tunel" për evakuimin e serbëve. Në pamundësi ta ndalojë një djalë shqiptar i cili ka provuar me thikë të vrasë Miladin Bačević-in, një amerikane pjesëtare e policisë së UNMIK-ut ka gjujatur në sulmuesin dhe e ka vrarë. Serbët thonë se me këtë vrasje janë parandaluar vrasja e 34 serbëve që ishin në atë kohë në fshat. Serbët e lënduar janë dërguar në spitalet e KFOR-it në Prizren dhe Pejë. Një grup protestuesish që gjatë sulmit në Bellopojë ende kanë qenë në Pejë janë ka provuar të depërtojë në Gorazhdec, fshatin më të madh në komunë, mirëpo kah ora 18:00 KFOR-i spanjoll e ka parandaluar dhe me këtë protestat kanë përfunduar.

Ushtarët e KFOR-it nuk kanë mundur t'i ndalin protestuesit, sepse vinin nga të gjitha anët. Ishin diku 20 pjesëarë të KPS-it, të stacionuar dhjetëra metra pas famullisë. Vetëm një veturë e policisë së UNMIK-ut ishte e parkiruar në prapavijë. Dy policisë amerikanë gjindeshin në veturë, një femër dhe një mashkull (...) Njëherë dola përpara famullisë dhe thirra KPS që të na ndihmojë por ata as që kanë dashur të dijnë (...) Ushtarët e KFOR-it kanë ardhë tek famullia dhe kanë formuar dy kordonë. Na thanë që të kalojmë njëri pas tjetrit nëpërmes "tunelit" të cilin ata e kishin krijuar me trupat e tyre. Masa filloi të na gjuajë neve dhe pjesëtarët e KFOR-it italian me gurë. Njëri nga shqiptarët ka pasur thikë. Ai e ka therrur Miladin Bačević-in në krahun dhe dorën e majtë. Në atë moment kam dëgjuar të shtënë. Masa u largua paksa dhe ashtu na evakuuan. Ishim dymbëdhjetë të lënduar, disa rëndë e disa lehtë. Përveq Miladinit, i lënduar rëndë është edhe Arangjel Arsenijeviçi, i cili i ka dy brinjë të thyer (...) Më vonë kam kuptuar se kur policja amerikane e UNMIK-ut e ka parë shqiptarin me thikë ka nxjerrë revolen dhe e ka vrarë. Po të mos e kishtë vrarë ajo atë, ne nuk do të dilnim të gjallë nga fshati.

M.O. Serb nga Bellopoja
FDH intervistë 4. korrik 2004.

15.2. Pasojat

Serbët konsiderojnë që kryetari i komunës së Pejës, Ali Laiqi, me vetë faktin se ka vënë kurorë në varrin e protestuesit të vrarë dhe nuk ka ardhur në Bellopojë ka treguar se është në anën e atyre që kanë kryer dhunën. Sipas pohimeve të Serbëve, kryetari i komunës asnjëherë nuk ju ka përgjigjur thirrjeve të serbëve në bisedimet për kthimin. Të 25 serbët e kthyer tani jetojnë në famulli të demoluar. Serbët duan të mbesin por nuk besojnë se qeveria e Kosovës sinqerisht

[24] Rane ne telu i duši, VEČERNJE NOVOSTI, 2. aprila 2004.

don të ju ndihmojë dhe të ju krijojë kushte të jetojnë ashtu si edhe shqiptarët. Ustarët e KFOR-it italian patrullojnë pandërpre në fshat.

Po ndëgjoj se si atë shqiptarin po të konsiderojnë heroj. Edhe kryetari i komunës ka qenë në varrin e tij. Kjo është turp. Të gjitha shtëpitë tona të rindërtuara, së parin janë plaqkitur e pastaj janë djegur. Edhe kisha është shkatërruar. Të gjitha mbishkrimet e varrezave janë rrënuar. Trafostacioni është rrënuar kështu që ne tani nuk kemi rrymë. Po përdorim agregatin e KFOR-it (...) Shqiptarët edhe më tej i lëshojnë bagëtitë në kullotat tona, përderisa ne rrijmë këtu tërë ditën dhe nuk bëjmë asgjë. Askush nga komuna nuk ka ardhur të na vizitojë. Vijnë njerëait sikurse ti, vetëm për të shkruar ca raporte nga të cilat ne nuk kemi kurrëfarë dobie. Pavarësisht nga të gjitha këto, të gjithë jemi kthyer përsëri. Deri më 17 mars kemi besuar se do të jetë më mirë. Tanimë nuk i besojmë askujt. Tani jetojmë në famulli, në qendrën kolektive. Që të mos lagemi nga shiu, kulmin e kemi mbuluar me kartonë dhe teneqe. Komuna ende nuk ka filluar me ndërtimet. 12 punëtorë çdo ditë janë para një shtëpie dhe as gërmadhat nuk i pastrojnë. As temli nuk është gropuar. Është pruar materiali, por kjo nuk është e mjaftueshme. Neve serbët nuk duan të na kyçin as në pastrim të terrenit. Kur do ta bënin këtë atëherë do ta dinim se diçka do të ndërrmiret. Bellopoja ka kaluar më së keqi ndërsa tani të gjithë na kanë harruar. Askush nuk po na ofron ndihmë. Shqiptarët i punojnë tokat tona dhe i qesin bagëtitë në kullotat tona. Ne nuk mund t'i ndalim. Jetojmë në llogor. Edhe përkujtimoret në varreza na kanë shkatërruar. Kishën na kanë shkatërruar. Na kanë thënë se jemi kthyer pa marrëveshje prandaj e kemi pësuar. Ne kemi ardhur në komunë në bisedime me kryetarin. Sapo hyjmë në zyre Ali Lajqi del nga zyrja. Vetëm po të na japin 2000-3000 euro për shtëpi, do të gjindeshim. Por jo. Edhe dokumentat na u kanë djegur kështu që nuk mund të dokumentojmë çfare kanë qenë shtëpitë tona. Më duhet të them se ndonjëherë ndonjë shqiptar na viziton, por kurrë në përcjellje të dikujt sepse frikësohen se mos do të ju ndodh diçka e keqe. Të njejtit kur kalojnë në grupe me tjerët na injoronjë. Ne jemi shumë këmbëngulës prandaj më 14 korrik do të festojëm përvjetorin e kthimit tonë. Ajo ditë do të bëhet festë e fshatit. Megjithatë nuk e di deri kur do të durojmë kështu. Nëse gjërat mbesin kështu siç janë, atëherë mesigur do të shkojmë në një vend të tretë. Vetëm le të na tregojë dikush haptazi.

M.O. Serb nga Bellopoja
FDH intervistë 4.korrik 2004.

16. Shpërndarja e protestuesve në Kamenicë

Ngjarjet e marsit në komunën e Kamenicës filluan më 17 mars 2004 me demonstrata të qeta, në të cilat mori pjesë edhe kryetari i komunës. Pas njoftimeve për konfliktet në Mitrovicë, një grup i Shqiptarëve që kishte ardhur nga viset e tjera të Kosovës, filloi të brohoriste kundër Kamenicës. Rreth orës 14,00 demonstratat moren karakter të dhunshëm. Demonstruesit Shqiptarë dogjën në qendër të qytetit automobilat e Serbëve dhe i thyen vitrinat e dyqaneve të tyre. Pas kësaj, demonstruesit u nisën drejt rrugëve në të cilat gjenden shtëpitë e Serbëve. Me këtë rast nuk janë shkatuar dëme të mëdha materiale sepse KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut i shpërndanë demonstruesit. Drejt shtëpive të Serbëve është shtënë me armë automatike. Disa Serbë kanë marë lëndime të mëdha trupore në komunën e kamenicës janë shkatëruar dy kisha, njëra në Sllapashnicë të Poshtme, kurse tjetra në fshatin Talinovc. Të nesërmën me datën 18 mars demostratat kishin intensitet më të dobët, sepse KFOR-i ishte më i vendosur dhe më i

organizuar që t'i pengojë aktet e dhunshme të demonstruesve. Serbët dëshmojnë se në momentin e sulmeve nuk ka funksionuar telefonia fikse e as ajo mobile, kështu që nuk kanë pasur se prej kujt t'i drejtohen për ndihmë.

Tubimi filloi pas dite me datën 17 mars në qendër të qytetit (...) Në këtë protestë istin të pranishëm mbi 1000 njerëz. I pari e mori fjalën kryetari i komunës së Kamenicës Shaip Surdulli, e pastaj folën edhe zyrtarët e tjerë të kësaj komune (...) Mirëpo, në vazhdim njerëzit filluan të hedhin parulla të ndryshme. Sipas të gjitha gjasave ata ishin njoftuar me trazirat e Mitrovicës si dhe me trazirat e tjera nëpër vende të ndryshme të Kosovës. Para foltorës filluan të dilnin njerëz që fare nuk ishin paraparë të flisnin. Njerëzit filluan të bërtasin "Kamenicë oj tradhëtare", gjë që nënkuptonte se në Kamenicë duhej të ndodhte dhuna. Madje disa nga demonstruesit filluan ta gjuajnë kryetarin e komunës me sende të ndryshme. Ndër protestantë kishte edhe të atillë që kishin ardhur nga jashtë (...) Më së shumti kishte të rinj të moshës së mesme shkollore (...)Rreth orës 14,00 tubimi mori dimensione krejtësisht të tjera. Masa e tubuar (...) u nis drejt pjesës së qytetit ku ka më së shumti shtëpi serbe. Policia e UNMIK-ut, duke pasur parasysh numrin e madh të njerëzve të tubuar, ishte e pafuqishme që të bëjë diçka më tepër. Së bashku me KFOR-in arritën ta blokojnë hyrjen në një rrugë të banuar me Serbë. Mirëpo masa u drejtua kah rruga tjetër ku gjithashtu ka shtëpi serbe. Demonstruesit filluan të hudhin gurë mbi këto shtëpi dhe i thyen po thuaj se të gjitha dritaret (...) Jugosllav Kostiq nga fshati Reçan ishte duke e dërguar me automobil gruan e tij deri në vendin e punës. Gruaja e tij punon në Shërbimin Policor të Kosovës. Ai duke u kthyer në shtëpi hasi në turmën e njerëzve. Demonstruesit e nxorën nga automobili dhe e rrahën, pastaj ashtu të rrahur e lanë në tok. Këtë turmë njerzish e përcillnin edhe gazetarët e radios sonë, Shqiptarë, të cilët për këtë rast e informuan policinë e UNMIK-ut. Policët erdhën në vendin e ngjarjes dhe e morën të lënduarin të cilin e dërguan në spital. Me këtë rast Jugosllav Kostiq kishte psuar lëndime të rënda trupore, përkatësisht kishte thyerje të eshtrave. Ia kishin thyer edhe nofullën. Nuk e di se a është liruar nga spitali, por mendoj se ai kur më nuk do të shërohet plotësisht. Në mbrëmje KFOR-i e shpërndau masën e tubuar, por edhe më tutje qarkullonin grupe më të vogëla, posaçërisht në periferi të qytetit. Po kjo situatë u përsërit edhe më 18 mars (...) mirëpo, ditën e dytë KFOR-i ishte shumë më efikas.

L.D Serbe nga Kamenica, drejtor i radiostacionit multietnik
FDH intervistë e datës 24 qershor 2004

Me datën 18 mars është sulmuar me batare shtëpia jonë e cila gjendet në rrugën Vuk Karaxhiq nr. 211. Në rrugën tonë janë edhe pesë shtëpi serbe. Dëgjuam se po atë ditë në qendër të qytetit të Kamenicës janë shkatëruar disa autmobila dhe vitrina (...) Sulmi kishte filluar rreth orës 19,30 derisa unë gjendesha në koridor. Diçka e dridhi shtëpinë tonë. U dëgjua një batare nga automatiku. Xhamat e dritareve u thyen. U ngrit një tym. Telefonat nuk punonin, madje as 044, përkatësisht telofoni mobil kosovar. Shtëpia jonë ishte e rrethuar, ngase diçka më vonë nga bodrumi pash dy njerëz para dyerëve të shtëpisë. Dëgjohej zëri i turmës në rrugë. E vërejta një grup të cilit iu bashkuan edhe ata që na sulmuan. Më vonë telefonat filluan të punojnë.

B.N. Serbe nga Kamenica
FDH intervistë e datës 24 marsr 2004

16.1. Veprimi i KFOR-it i policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK

KFOR-i veproi në mënyrë shumë më të organizuar me datën 18 mars duke i shpërndarë demonstruesit që sulmonin shtëpitë e Serbëve. Patrullat e Shërbimit Policor të Kosovës dhe të policisë së UNMIK-ut ishin të vogla në numër, pa komandë dhe më shumë ishin në rolin e vëzhguesit.

Kemi vërejtje për sjelljen e Shërbimit Policor të Kosovës, si në ditën e parë ashtu edhe në të dytën. Ata vetëm i vëzhgonin ngjarjet. Vlenë të përmendet se policët Serbë askush nuk i ka parë në rrugë. Ditën e dytë, më 18 mars, KFOR-i veproi në mënyrë shumë më efikase dhe pikërisht për këtë demonstruesit filluan t'i gjuajnë me sende të ndryshme ushtarët e KFOR-it. Në këto përleshje pati edhe të lënduar në rradhët e pjestarëve të KFOR-it. Në disa raste këta ushtarë ishin të shtërnguar të tërhiqëshin.

L.D Serbe nga Kamenica, drejtor i radiostacionit multietnik
FDH intervistë e datës 24 qershor 2004

Pas një ore arritën dy policë ndërkombëtarë dhe me ta edhe një polic Serb. Ne nuk kishim besim në ta, andaj edhe nuk dolëm nga bodrumi. Policët e kryen shikimin. Ata nuk mund të na ruanin, sepse tërë territorin e Kamenicës e mbulonin vetëm tri patrulla. Pas largimit të tyre, rreth orës 23,00, e thirrëm mikun nga Ropotova Gradimir Nikiqin, përfaqësuesin e komunës së Kamenicës për urbanizëm. Pas kësaj, ose ai ose policia e UNMIK-ut kishte dërguar tri automjete të KFOR-it. Vetëm atëherë pranuam të dalim nga bodrumi. Ende vëreheshin gjurmët e sulmuesve. Ata erdhën nëpër kopshtet e shtëpive Serbe. Më nuk isha në gjendje që psikikisht të durojë, andaj kërkuam që të na transferojnë në Serbi (...) Disa miq Shqiptarë kishin ardhur që të na nxjerin, por KFOR-i nuk i kishte lejuar. Konsideroj se përfaqësuesi i Serbëve Ivan Stanojeviq dhe drejtori i zyrës lokale, Nebojsha Simiq, asgjë nuk kishin bërë që ta informojnë popullin se si të sillen në këtë situatë.

B.N. Serbe nga Kamenica e cila ishte fshehur në bodrumin e shtëpisë së saj
FDH intervistë e datës 24 mars 2004

16.2. Pasojat

Në orët e hershme të mëngjesit të datës 19 mars të gjithë Serbët u larguan nga qyteti. Ata u kthyen disa ditë më vonë. Fqinjët e tyre shqiptarë u afruan përkrahje Serbëve. Gazetarët Serb i fajsojnë mediat kosovare për nxitjen e shqiptarëve që të tubohen dhe të ushtrojnë dhunë ndaj Serbëve.

Sipas mendimit tim, mediat Shqiptare kanë luajtur një rol tejet negativ në ngjarjet e marsit. Ato, në një farë mënyre, i kanë ftuar qytetarët që të tubohen. Kjok mundur të konkludohet në bazë të mënyrës së informimit lidhur me incidentet. Më 19 mars në mëngjes Serbët filluan ta braktisin qytetin. Me përcjelljen e policisë së UNMIK-ut dhe të Shërbimit Policor të Kosovës disa u nisën me automjetet e veta drejt Serbisë, kurse të tjerët drejt fshatrave Serbe në komunën tonë. Edhe une isha ndërmjet tyre. Vetëm pas tri apo katër ditësh Serbët filluan të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Gjatë kësaj kohe shtëpitë e tyre nuk ishin plaçkitur e as që ishtin dëmtuar. Jam i bindur se njerëzit e Kamenicës nuk kanë marrë pjesë në dhunën e ushtruar ndaj

Serbëve. Fqinjët e mi Shqiptarë më kanë thënë: "Lubo, ruaju 2-3 ditë derisa nuk kalon ky tmer" unë edhe më tutje kamë marëdhënie të mira me të gjithë dhe punoj normalisht sikur edhe më parë. Përndryshe, një komision ka dalur në terren dhe ka vlerësuar dëmet e shkaktuara gjatë këtyre trazirave. Nuk jam i njoftuar se çfarë është dëmi i vlerësuar, por siç po dëgjoj është më i vogës se sa në të gjitha vendet e tjera ku ka pasur dhunë.

L.D Serbe nga Kamenica, drejtor i radiostacionit multietnik
FDH intervistë e datës 24 qershor 2004

17. Tri incidente në komunën e Novobërdës

Ngjarjet në komunën e Nobërdës filluan më 16 mars 2004 kur Shqiptarët protestuan para ndërtesës së komunës në fshatin Bostan kundër arrëstimit të pjestarëve të UÇK-së. Këto demonstrata ishin të qeta. Megjithatë, në natën ndërmjet 17 e 18 marsit ndodhën tri sulme: në ndërtesën e komunës në fshatin Bostan u hodh një koktej molotovi; në banesën e kryetarit të komunës Petar Vasiq, në lagjën Kolonia e Vjetër në Nobërdë u hodh një bomb dhe në fshatin Kollobukar u dogj shtpia e rindërtuar e Sava Zdravkoviqit, i cil duhej të kthehej në këtë shtëpi. Gjatë këtyre sulmeve u shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale. Vlenë të përmendet se në fshatrat me popullsi të përzier Serbe – Shqiptare nuk janë shënuar incidente.

Në natën ndërmjet 17 e 18 marsit u hodh një koktej molotovi në ndërtesën e komunës në fshatin Bostan. Me atë rast janë djegur dy zyra, mobiljet, kompjuteri dhe të gjitha sendet që kanë qenë në këto zyra. Kjo ndohi gjysmë ore pas mes nate. Komuna ka pasur rojat e veta, por ata asgjë nuk kan dëgjuar. Vetëm pasi kanë vërejtur tymin kanë reaguar. Policia kishte dalur në vendin e ngjarjes. Thonë se hetimet vazhdojnë (...) Këtu ka qenë një komision për vlerësimin e dëmeve nga Prishtina, por unë nuk jam i njoftuar për vlerësimin e dëmeve (...) Atë natë kam pasur një parandjenje se diçka do të ndohë dhe pikërisht për këtë arsye nuk kamë shkuar në banesë, por kam qëndruar në fshat te një i afërm i imi. Diku rreth orës 02,30 është hedhur një bombë në banesën time e cila gjendet në lagjen Kolonia e Vjetër. Fqinjët Shqiptarë askend nuk e kanë parë. Për fat të mirë banesa nuk është djegur, mirëpo të gjitha sendet janë dëmtuar. Po atë natë i është dhënë flaka shtëpisë së Sava Zdravkoviqit nga fshati Klobukar. Kjo shtëpi pasa ishte rindërtuar dhe po atë ditë ai është dashur të kthehet në shtëpinë e vet.

P.V. Serb nga Nobërda, kryetar i komunës
FDH intervistë e datës 20 prill 2004

17. 1. Veprimi i KFOR-it i policisë së UNMIK-ut dhe i SHPK

Më 17 dhe 18 mars KPS dhe KFOR-i kanë reaguar rreptë në Novobërdë. Patrollimi është forcuar dhe është vendosur bllokada. Megjithatë, edhe gjatë bllokimit në fshatin Izvor, shqiptarët kanë rrahur një serb i cili nuk i ka lejuar ta punojnë tokën e vet.

Pas këtyre ngjarjeve KPS dhe KFOR-i e kanë forcuar patrullimin. Bllokimi mbeti në fuqi për 10 ditë. Megjithatë, ka pas një incident në fshatin Izvor. Në afërsi të Svraqakut, shqiptarët e kanë rrahur një serb. Ai është rrahur sepse ju ka thënë të mos e punojnë arën e tij. Rasti i është

kumtuar policisë, fajtorët janë ditur dhe kanë arrestuar, mirëpo janë liruar sapo kanë dhënë deklaratën.

P.V. Serb nga Nobërda, kryetar i komunës
FDH intervistë e datës 20 prill 2004

17.2. Pasojat

Ngjarjet e marsit ndikuan që në komunën e Nobërdës të mos kthehen ata Serbë të cilët organeve të pushtetit komunal ua kishin paralajmëruar kthimin e vatrat e tyre. Administrata komunale nuk funksionon si më parë, para së gjithash për shkak të mosardhjes në punë të një numri të nëpunësve Shqiptarë.

Djegia e shtëpisë në fshati Globukar ndikoi që edhe personat e tjerë të zhvendosur të mos kthehen në vatrat e tyre. Tani më thërasin nga Serbia dhe më pyesin: "O kryetar, t'i na ke thënë se në Nobërdë është çdo gjë në rregull!. Nuk di se si tu përgjigjem (...) Mua më shqetëson edhe sjellja e disa nënpunësve Shqiptarë në këtë komunë. Ata nuk vijnë me rregull në punë, madje ka edhe të atillë që nuk dëshirojnë të paraqiten. Disa as që dëshirojnë të bisedojnë në gjuhën Serbe. Unë gjithëherë i shmangem aplikimit të masave disiplinore, sepse kjo mund të shkaktoj ndarje edhe më të mëdha ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve.

P.V. Serb nga Nobërda, kryetar i komunës
FDH intervistë e datës 20 prill 2004

18. Rrahja e Serbëve në Rahovec

Gjatë demonstratave në qendër të Rahovecit, më 17 mars, një grup njerzish hynë në lagjen Serbe dhe rahu disa serbë shtëpitë e të cilëve janë afër shtëpive të Shqiptarëve. Gjatë kohës së demostratave nuk ishte siguruar kjo lagjë, gjë që u mundësoi sulmuesve që pakurfarë pengesash të hynë nëpër shtëpitë e Serbëve. Në qendër të Rahovecit demonstruesit shkatëruan kishën ortodokse të Shën Nedeljes. Sërbët e sulmuar kanë mundur t'i identifikojnë dy nga katër sulmuesit. Gjatë trazirave në këtë qytet ka vdekur Shqiptari Gazmend Shala.

Së bashku me burrin dolëm në ballkon për të parë se çka po ndodhë. Ndëgjuam një zhurmë. Sipas zërave që ndëgjoheshin munda të konkludojë se në qendër të qytetit ishte tubuar një masë e madhe e njerëzish, e sipas brohoritjeve UÇK-UÇK, se është fjala për diça mjaft serioze (...) Para shtëpisë sonë u krijua një tollovi e madhe. Njëri prej tyre mbante lartë flamurin Shqiptar (...) një pjesë e demonstruesve filloi t'i nxirte gurët katrorë nga rruga dhe me ta i gjuanin shtëpitë serbe të boshatisura që gjendeshin përreth (...) Ne nuk kishim kah tia mbanin sepse demonstruesit tashmë ishtin para shtëpisë sonë (...) Ata i thyen dyert dhe në dhomë hynë katër të rinj. Dy prej tyre i njoha sepse i kisha parë shpesh në Rahovec, por emrat e tyre nuk më kujtohen (...) Dy të tjerët asnjëherë nuk i kisha parë në Rahovec. Ata së pri na shanë, e pastaj filluan të na godasin me shkopinj, grushta dhe të na shqelmojnë. Në dorë e mbaja një çantë të lëkurës në të cilën i kisha pasaportën, letërnjoftimin, librezën shëndetësore dhe 500 euro. Ata ma rrëmbyen çantën nga dora, pastaj më kapën për flokë dhe më shtynë shkallëve të poshtë. Me atë rast mora lëndime në të dy këmbët, në kuriz, në kofshë, në krahëror dhe kokë. Ata ishtin edhe më brutal ndaj burrit tim Stanishës, të cilin e goditnin në kokë dhe nëpër pjesët e tjera të

trupit. Lëndimi që i ishte shkaktuar në kokë nuk është shëruar një kohë të gjatë. Mirëpo, më së rëndi e kishte lënduar këmbën e majt, kështu që ende nuk mund të ecë normalisht. Pasi sulmët kishin pushuar erdhi një pjestarë i policisë së UNMIK-ut, i cili ishte i shoqëruar edhe nga policët e Shërbimit Policor të Kosovës. Ata na dërguan shë shtpinë e Violleta Kërstiqit. Të nesërmën na transferuan në ambulancën e Rahovecit. Aty na pranuan shumë mirë. Dr. Jusuf Korenica, i cila na i dha ndihmën e parë mjekësore na tha: "Më vjen keq, si ndodhi që pikërisht juve të ju sulmojnë?" Shumë mirë na pranoj edhe dr. Agimi. Nga fëtyrat e tyre shihej se me të vërtetë u vinte keq për këtë që na kishte ndodhur. Nga Rahoveci na transferuan në Mitrovicë. Stanisha qëndëroi 8 ditë në shok dhomë. Në spital është operuar nga holocista dhe tani qëndron i shtrirë dhe i palëvizshëm (...) Pronari i shtëpisë po kërkon që tia paguajmë qiranë, e ne nuk kemi kah t'i marrim të hollat ngase jetojmë vetëm nga ndihma sociale prej 50 eurosh. Askush nuk na ndihmon e as që vjen të na vizitojë. Asgjë tjetër nuk dua pos që të na kthehen qetësia dhe siguria, e të tjerat do të zgjidhen me kohë.

R.G. Serbe nga Rahoveci e rrahur më 17 mars
FDH intervistë e datës 14 maj 2004

19. Spastrimi i Prizrenit

Serbët që kishin mbetur në Prizren pas muajit qershor 1999, rreth 100 veta, dilnin lirisht në qytet dhe i kryenin punët e përditshme pa u frikësuar se mund tu ndodhë kiqka e pakëndëshme. Provokimet e kohëpaskohshme, siç janë gjuajtja me fjalë në rrugë, i merrnim si pasojë normale të luftës. Në mesin e banorëve të vjetër Shqiptarë, Turq dhe Boshnjak ndiheshin të sigurtë dhe pranuar mirë. Millosh Nekiq bënte përjashtim. Të gjitha familjet Serbe që kanë jetuar afër tij para lufte, janë shpërngulur nga presioni. Disa i kanë shitur shtëpitë e disave prej tyre, pasi i kanë braktisur, ato u janë djegur. Millosh Nekiq që nga muaji gusht i vitit 1999 nuk kishte dalur nga shtëpia nga frika se kriminelët do tia digjnin shtëpinë.

Shqiptarët me të cilët kishte biseduar FDH ishin të bindur se në trazirat e marsit nuk kanë marrë pjesë shqiptarët e këtij qyteti, porse organizatorët e demonstratave i kanë sjell demonstruesit nga viset e tjera.

Sulmuesit ishin të organizuar dhe saktësisht ishin në dieni se cilat ishin objektet e serbëve që duhej të demoloheshin dhe digjeshin. Kishte edhe të atillë që kishtin ardhur me kamionë për t'i plaqkitur këto shtëpi. Asnjëri nga këta nuk e njihja. Ata nuk ishin prizrenas (...) Unë këta njerëz nuk i kisha parë asnjëherë më parë (...) Ne me Serbët kemi pasur gjithëherë marrëdhënie të mira. Ata na respektonin, e edhe ne i respektonim. Ata flisnin gjuhën tonë dhe i respektonin zakonet tona. Gjatë kohës së ramazanit Serbët nuk pinin zigare para Shqiptarëve, Boshnjakve ose Turqve që agjëronin.

G.I. Shqiptar nga Prizreni
FDH intervistë e datës 19 maj 2004

Jetoj e vetmuar në banesën time e cila gjendet pranë shkollës 17 Nëntori (...) Nuk kam dashur ta braktisë Prizrenin, sepse ky është qyteti im në të cilin kam lindur dhe jamë rritur. Pas përfundimit të luftës ne Serbët që kemi mbetur këtu kemi përjetuar gjithçka. Mua madje më ka arrestuar edhe UÇK-ja në qershor të vitit 1999 pa parë parasysh këtë përvojë të tmershme unë

edhe më tutje mbeta në Prizren. Kohëve të fundit kamë lëvizur lirisht nëpër qytet. Gjithëherë kishte të atillë që më ofendonin, por unë nuk u kushtoja rëndësi këtyre sjelljeve të pamira. Fëmijët e fqinjëve më donin dhe gjihëherë më përshëndetnin.

E.D. Serbe nga Prizreni, banore e vjetër
FDH intervistë e datës 24 prill 2004

Shtpia jonë gjendet në lagjen Lakuriq e rrethuar nga të gjitha anët me shqiptarë, me të cilët familja ime gjithëherë ka pasur marëdhënie të mira (...) Si punëtorë të arsimit, burri im i ndjer Mile dhe unë, më tepër se 40 vjet kemi edukuar fëmijët dhe na kanë qmuar njerëzit e këtij qyteti.

D.D. Serbe nga Prizreni, lagja Lakuriq, arsimtare në pension
FDH intervistë e datës 25 prill 2004

Dhuna që u shkallëzua atë ditë për mua ishte e papritur, sepse shkalla e tensioneve ndërnacionale në Prizren ishte në nivelin më të ulët në Kosovë. Pikërisht për këtë arsye edhe e solla këtu familjen. Deri atëherë kam lëvizur lirisht dhe jamë shoqëruar pa kurfarë problemesh me Shqiptarët, Turqit dhe Boshnjakët.

L.P. Serb i ktyher i cili jetonte në Bogosllovi
FDH intervistë e dates 30 prill *2004*

Unë dhe gruaja ime nuk e kemi braktisur Prizrenin. Ne lëviznim goxha lirshëm (...) Kishim marrëdhënie shumë të mira me fqinjët, sidomos me familjen Shqiptare Shala, me vëllëzërit Thaqi, Enverin dhe Asafin. Babai i tyre Halili ka qenë njeri i mirë, e po ashtu edhe Ruzhdiu që ishte pronarë i një shitoreje të teknikës së bardhë. Ne këta nuk do t'i ndërronim me gjysmën e Serbisë. Pa marë parasysh provokimet e vogëla (...) Ne ishim të vendosur që të mbesim këtu, në shtëpinë tonë në qendër të Prizrenit pranë kishës së Shën Mërisë ku kishin mbetur fare pak familje serbe.

S.R. Serb nga qendra e Prizrenit
FDH intervistë e datës 28 prill 2004

19.1. Kronologjia e ngjarjeve

Më datën 16 mars, para dite, tri shoqata të dalura nga UÇK, Shoqata e Veteranëve të UÇK, Shoqata e Invalidëve të UÇK dhe Shoqata e Familjeve të Heronjve të UÇK, organizuan një protestë në sheshin qedror Shadërvan, për shkak të arrestimit të komandantëve të ish UÇK-së të cilët janë akuzuar për krime lufte dhe vepra të tjera penale të kryera gjatë dhe pas luftës në Kosovë, aplikimit të ligjeve Serbe në Kosovë dhe politikës së UNMIK-ut ndaj pjesëtarëve të ish UÇK-së. Në mbrëmjen e 16 marësit mediat kosovare informuan opinionin se tre fëmijë janë mbytur në lumin Ibër ngase i kishin ndjekur Serbët. Me datën 17 mars, në qendër të Prizrenit u tubua një numër kryesisht i të rinjëve që kishin ardhur me autobusë dhe të cilët brohoritnin parulla "Mitrovicë, Mitrovicë" dhe "UÇK UÇK".

Të martëm më 16 mars, në orët e paraditës, në sheshin Shadërvan të Prizrenit u organizuan protesta me moton "Të gjithë në mbrojtje të çlirimtarëve të Kosovës". Disa qindra pjesëmarës

në protesa mbanin fotografi me portretët e komandantëve të UÇK-së, parulla kundër UNMIK-ut dhe kundër aplikimit të ligjeve Serbe në Kosovë. Ata kërkonin që të "ndërpritet politika e UNMIK-ut kundër luftëtarëve të UÇK-së (...) Në emisionet informative të RTK-së, TV21, KTV-së dhe të televizioneve lokale "Besa" dhe TV Prizren dominon raportet dhe emisionet speciale nga Mitrovica që bënin fjalë për tre fëmijët që ishin viktimë e sulmit të Serbëve në afërsi të fshatit Çabër. Pati edhe raporte për blokimin e rrugës magjistrale në fshatin Çagllavicë (...) Kisha një parandjenjë se do të ndodhte diçka e keqe (...) Të nesërmën me 17 mars rreth orës 10,00 shkova në tregun e gjelbër. Rrugëve të qytetit vërejta një numër më të madh njerëzish se zakonisht. Për një çast mendova se këta njerëzë ishin tubuar ngase ishte ditë tregu. Mirëpo, në orët e pasditës Prizrenin e përfshiu një valë e dhunës që nuk mbahet mend (...) Disa qindra demonstrues, kryesisht të rinj u tubuan në qendër të qytetit në hapësirën ndërmjet hotelit Theranda, Thirana dhe urës. Demonstruesit qarkullonin nëpër qytet duke brohoritur parulla "UÇK, UÇK" dhe "Mitrovicë, Mitrovicë" dhe valonin flamuj shqiptarë. Një automjet qarkullonte nëpër qytet dhe me megafon ftonte njreëzit që t'i bashkangjiteshin demonstratës. Pas pak dhuna arriti kulminacionin (...) E pastaj u sulmuan të gjitha objektet ortodokse (...) Shtëpit Serbe në lagjen Nënkalaja (...) dhe objekte tjera në pronësi të Serbëce.

Shqiptar nga Prizreni i cili deshi të mbetej anonim
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

Serbët ishin gjetur të befasuar nga kjo situat e krijuar. Disa u përpoqën t'i mbrojnë shtëpitë e veta dhe të mbesin në to. Ka pasur raste që shqiptarët kan tentuar të pengojnë shkatërimin e shtëpive të Serbëve dhe atyre tu ofrojnë ndihmë, mirëpo shumica vetëm i ka vështruar ngjarjet.

Me datën 17 mars në orën 18,30 dëgjova krisma të forta në derë (...) dëgjohej krisma e sopatës me të cilën goditej dera. Menjëherë e thira Shërbimin Policor të Kosovës atë më thanë që të tërhiqem në brendi të oborit dhe të fshehem. Mirëpo unë vendosa ta mbrojë derën pas pak arritën 5-6 policë të cilët, nga ana e jashtme e drës, më thanë që të dilja jashtë. Unë u përgjigja se nuk dal nga shtëpia ime. Ata filluan ta shqelmojnë derën me qëllim që ta hapin. Unë edhe më tutje e shtyja derën. Pastaj një polic hipi mbi murin e oborrit dhe e hapi derën. Ai me atë rast më tha se nuk jam në gjendje që t'i kundërvihen masës. Sulmuesit përpiqeshin që edhe në prani të policit të më lëndonin. Policët e vunë një dëras në drejtim të shtëpisë së fqinjit dhe më mundësuan që të kaloj mbi atë drasë, pastaj mbi kulmin e shtëpisë tjetër për të më nxjerë në rrugën paraleshish me lumin. Policët e thirën një taksi ngase frikësoheshin se mos sulmuesit do ta qëllojnë edhe automjetin e policisë mua më dërguan në stacionin policor. Po atë natë na dërguan në bazën e KFOR-it gjerman.

M.N. Serb nga Prizreni i cili nuk deshi ta braktisë shtëpinë e vet
FDH intervistë e datës 26 prill 2004

Shtëpi dhe objekte të besimit të djegura në lagjen Nënkalaja © HLC.

Atëherë kur mendova se çdo gjë kaloi dhe se më nuk do të ketë dhunë, diku reth orës 10,00 (më 18 mars) u dëgju një zhurmë e madhe. Masa sërisht ishte tubuar. Të gjithë vraponin në drejtim të nënkalas (...) Një grup prej 20-30 vetash hyri në shtpëinë e profesor Vekosllav Stankoviqit (...) e cila ishte e braktisur. Në anën e pasme të shtëpisë së tij shpërtheu zjarri. Menjëherë e mora gypin e gomës dhe u përpoqa ta shuaj zjarrin, mirëpo më penguan dhe nuk më lejuan as të afrohem afër shtëpisë. Disa prej tyre u nisën për ta kallur shtëpinë e Adem Demaqit. Unë ua tregova fotografitë e Damaqit duke u thënë se kjo është shtëpia e tij në të cilën ishte i vendosur flamuri Shqiptar. Disa menjëherë u tërhoqën, por disa të tjerë filluan të shajnë.. "Edhe ai është si shkijet, është magjup". Ata me çdo kusht tentonin që tia vënin flakën sikur edhe shtëpive të tjera (...) E mora një thikë të madhe dhe një shufër metali dhe i paralajmërova që të mos i afërohen kësaj shtëpie. Ata thanë: "Të ikim, ky plak është i çmendur" (...) Pastaj unë vazhdova (...) t'i shuaj shtëpitë përreth që digjeshin. Më erdhi në ndihmë Magjuni që punonte si korier në Shkollën e muzikës dhe i cili banonte me familje në njërën nga shtëpitë Serbe të braktisura në lagjen Nënkalaja. Po të mos ishim ne me siguri se do të digjeshin të gjitha shtëpit përreth.

G.I. Shpiëtar nga Prizreni lagja Nënkalaja
FDH intervistë e datës 19 maj 2004

Shtëpi të djegura në Prizren © HLC

Pasi që një ditë më parë, më 17 mars, ua kishn dhënë flakën të gjitha kishave në qytet dhe disa shtëpive të tjera, të nesërmën më 18 mars, i dogjën edhe shtëpitë e serbëve në lagjen Nënkalaja. Ne edhe më tutje nuk largoheshim nga shtëpia (...) Nuk frikoheshim nga fqinjët Shqiptarë, Turq apo Goranë (...) Ishim të bindur se ata nuk do të na sulmonin. Mirëpo, më 19 mars megjithatë na sulmuan. Askush nuk u përpoq që t'i ndaloju huliganët. Vetëm një grua e re që jeton në rrugën tonë, emëri i së cilës nuk më kujtohet i tha nënës sime: "teze ejani te ne".

M.SH. Serbe e nxjerë nga shtëpia më 19 mars
FDH intervistë e datës 5 qershor 200

19.2. Sulmi ndaj Serbëve, pasurisë dhe objektve fetare

Demonstruesit i rrahnin Serbët me rastin e dëbimit të tyre. Në disa raste Shqiptarët u kanë dhënë ndihmë Serbëve duke au lidhur plagët, duke i larguar nga rruga shtëpi ose fshehur nëpër shtëpitë e tyre. Të gjitha shtëpitë e Serbëve si dhe objektet fetare janë plaçkitur dhe plotësishtë ose pjesërishtë janë shkatëruar. Me atë rast janë plaqkitur dhe dëmtuar seriozisht edhe shtëpitë e disa shqiptarëve që kanë jetuar në afërsi të serbëve. Kuvendi i Komunsë së Prizrenit shpalli më 1 prill të dhënat lidhur me dëmet e shkatëruara gjatë trazirave të marsit.

Kamë qenë në shumë vende dhe kam parë gjithçka. Mirëpo atë që e kam parë gjatë demostratave të dhunëshme më 17 e 18 mars në Prizren nuk e kam hasur askund. As që kam

mundur ta marrë me mend se mund të ndodhë diçka e tillë. Shpërthimi i dhunës doli jashtë çdo kontrolli. Grupet e Shqiptarëve të rinj rënoni dhe digjnin gjithçka para vetes.

Shqiptar nga Prizreni, lagja Nënkalaja
FDH intervistë e datës 19 maj 2004

Shtëpi Serbe të djegura në Prizren;© HLC

19.2.1. Rrahja e viktimave

Së paku 10 Serbë, kryesisht të moshuar, janë rrahum me rastin e hyrjes së demonstruesve Shqiptarë nëpër shtëpitë e tyre në lagjet Nënkalaja dhe Lakuriq. Ndër të lënduar janë edhe disa gra.

Mua më dhimbësen ata fëmijë (...) Sepse në fëtyrat e tyre të njoma vëreja një urrejtje të madhe dhe të pakuptueshme. Në shtëpinë tonë kishin hyrë së paku 30 veta. Pasi kishin thyer derën e hyrjes mua më drejtuan disa të rinjë të fuqishëm. Unë u prëpoqa që t'i pyes pse e bëjnë këtë. Në vend të përgjigjes mora një goditje me këmbë në pjesët e gjoksit (...) Pastaj pasuan goditjet nëpër të gjitha pjesët e trupit (...) Në një moment më dhanë që të dilja jasht, por unë nuk dëshiroja ta braktisi shtëpinë (...) Unë sërisht i kundërshova dhe ata sërisht filluan të më godasin kështu që fillova të bërtas dhe të thëras për ndihmë. Mirëpo, ata nuk pushonin por më thonin: "hesht, përndryshe do ta heqim kokën! Ne jemi UÇK". E ula kokën dhe e pritja më të keqen. Me atë rast më shkatëruan lëndime të rënda (...) Syrin e majtë e kishta të enjtur dhe

plotësisht të mbyllur. Shikoni, mi kan thyer edhe dhëmbët, kurse këmbën e kisha në gjips. Më është dashur që tri javë të jem nënkontrolin e përhershëm të mjekut. Tani jetoj me barëra.

D.D. Serbe nga Prizreni, lagja Lakuriq, mësuese në pension
FDH intervistë e datës 25 prill 2004

Ne për të qenë më të sigurtë kishim dhënë një shufër metali në derë dhe ata nuk arritën ta hapin derën, por hynë nëpër dritare të cilën më parë e kishin thyer. Gruaja ime dhe unë u strehuam në skajën e dhomës duke menduar se mbaruam. Fëtyra e tyre vërehej një urejtje dhe tërbim i madh. Ata i thyen të gjitha, kurse mua më rrahën me shkopinjë dhe më shqelmonin e më goditnin me grushta. Sllobodankën nuk e prekën. Ajo i luste që të mos më rrahin duke iu drejtuar në shqip se jamë njeri i sëmuar. Një i ri urdhëroi në gjuhën shqipe: "mjaftë më!".

S.R. Serb që e kishte shtëpinë pranë kishës së Shën Mërisë
FDH intervistë e datës 28 prill 2004

E thyen derën e shtëpisë dhe e hodhën në lum, pas hynë në oborrin e Bogosllovisë. Së pari hynë në katin e parë me çrast e rrahën Zeqir Morinën, të cilit ia thuen dorën, e pastaj ate dhe gruan e tij i nxorën jashtë. Në katin e parë jetonte Dragan Nedelkoviq. Nuk e di se a e kan rahur apo jo, por e di se është djegur në shtëpinë e vet (...) Pastaj u ngjitën na katin e dytë dhe filluan t'i thyejnë dyert tona. Në dhomë ishim katër gra: Natalija, bija ime, tezja Draga dhe unë, filluan të shajnë dhe të bërtasin: "dilni jashtë! Mua më pytën në sërbisht se a ka mëshkuj këtu. Unë u thashë se nuk ka, gënjeva sepse nuk dëshiroja që Lubës t'i ndohë diçka e keqe, kurse ai gjendej me familjen e vetë në katin e tretë (...) Pasi u nisëm të dalim ata filluan të na godasin. Në një moment mua më goditën në kokë me një send të prehtë dhe të fortë. Filloi të më rrjedh gjaku)...) Në gjithë këtë hallakam më humbi dikund vajza ime. Më vonë mësova se ajo ishte përzier me masën dhe në atë mënyrë ka arritur të tërhiqet. Natalija, Draga dhe unë u nisëm anës së majt të lumit, kurse demonstruesit nga gjunin me gurrë. Nuk më kujtohet si jam ndarë nga Natalija dhe Draga, vetëm për një çast kam vërejtur se nuk ishin me mua. Ashtu e lënduar mbeta e vetmuar, kurse nata dashmë kishte villu të binte.

O.F. Serbe nga Prizreni, e cila së bashku me të bijën jeton në Bogosllovi
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

Në deklaratën për FDH, kjo prizrenase e cila së bashku me vajzën jetonte në Bogosllovi që nga muaji qershor 1999 thekson se në rrugë e kishte ndihmuar një shqiptar të cilin nuk e njihte:

Për një çast mu afrua një shqiptar dhe më tha që të largohem. Unë ati i thashë se më kanë humbur një gjyshe dhe një grua tjetër që ishin me mua. Ai më tha se nuk duhet të brengosem sepse ato janë vendosur në vend të sigurtë. Atë njeri nuk e njihja. Në atë moment arriti vajza ime Tanja. Menjëherë pastaj arriti edhe automjeti i ndihmës urgjente (...) Filluan të ma lidhin varën dhe na dërguan në spital (...) Natalin dhe tezën Draga shqiptarët i kishin vendosur në një botrumin e një shtëpie dhe aty ua kishin sanuar plagët dhe u kishin dhënë ushqim. Pastaj i kishin dërguar në fshatin Sredskë ku jetojnë Serbët dhe ia kishin dorëzuar KFOR-it.

O.F. Serbe nga Prizreni, e cila së bashku me të bijën jeton në Bogosllovi
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

Përveq rasteve të përmendura, me rastin e djegjes së shtëpive në lagjen Nënkalaja më 17 dhe 18 mars, demonstruesit kan rrahur edhe çiftin bashkshortor Jeftiq, Zagora Repiqin dhe Ljepka Pitoviqin. Sipas pohimeve të Serbëve të vendosur në bazën e KFOR-it gjerman, ata u larguan nga Prizreni dhe tani gjenden në Serbi.

Shtëpi Serbe të djegura në Prizren;© HLC

19.2.2 Solidariteti

Nën dritaren time janë tubuar shumë njerëz. Ata filluan ta thyejnë derën e hyrjes së Bogoslloviseë (...) Gruas sime i thashë: "ik"! (...) Filloi thyerja e gjithë asaj që gjendjej nëpër objekte (...) Të vetmin shanjë për të shpëtuar e kishim që të dalim nëpër dritaren e madhësisë 30x30 nëpër të cilën do të dilnim në tarracën e shtëpisë së fqinjit (...) Kjo dritare e vogël ma shpëtoi familjen time. Nëpër këtë dritare së pari kaloi gruaj, e pastaj bija dhe biri im. Unë nuk munda të kaloj sepse jamë tepër i trashë. Vet me vete thashë "mbeta këtu ku edhe do të digjem" (...) Mu kujtua dritarja e vogël në tualet, nga e cila po ashtu mund të dilej në tarracën e shtëpisë së fqinjit. Më duhej që dritaren ta zgjëroja që të mund të dilja. Shkova në kuzhin dhe e morra frigoriferin me të cilin fillova ta godas dritaren në mënyrë që ta bëja një vrimë më të madhe për të dalur. Derën e hymjes e blokova me tavolnë dhe disa sende të tjera. Demonstruesit tentuan ta hapin derën por nuk arritën. Pas hoqën dorë, me siguri për shkak se zjarri përhapej (...) Pas disa goditjeve arrita të krijoj një hapësirë të mjaftueshme për të dalur në tarracën e shtëpisë fqinje, para se flaka të përhapej në tërë shtëpinë.

Në deklaratën e FDH, ky i kthyer në Prizren po ashtu thekson se në situatën kritike e ka ndihmuar një Shqiptarë:

Pronari i shtëpisë na ofroi mikëpritje miqësore. Na tha qaj dhe na thoshte se nuk duhet të brengosemi (...) Që të mos i shkaktojmë telashe unë i morra fëmijët dhe shkuam në hotelin "Theranda" (...) Në hotel qëndruam shkurt ngase frikohesha se mos na ka parë ndokush. E theva xhamin dhe dola në afërsi të ndërtesës së teqes ku gjendeshin dy kontenjer të mëdhenjë për mbeturina. U vendosëm në këta kontenjer. Biri im filloi të qaj, kurse unë ia mbylla gojë që të mos na ndëgjoj askush. Bija ime heshte, por ishte tepër e frikësuar. Ishim dathur, deshur dhe të urritur. Dikur rreth orës 03,00 situata u qetësua, por unë nuk isha e sigurtë se a mund ta braktisim këtë vend (...) Vetëm pas orës 5,00 vendosëm të dalim dhe u nisëm drejt ndërtesës së qendrës rajonale të UNMIK-ur

L.P. Serb nga Prizreni, i kthyer i cili jetonte në Bogosllovi
FDH intervistë e datës 30 prill 2004

Në fillim na gjuanin me gurë e pastaj në oborin tonë e hodhën një "koktej molotovi" për fat të mirë ne nuk pësuam lëndime. Përveq dëmeve të shkatëruara materiale (...) Huliganët shkatëronin gjithçka për rreth. Që të katërtat hymë në një kthinë pas shtëpisë edhe aty u barikaduam me dërrasa. Tashmë kishte rënë nata dhe kjo na jepte shpresë se nuk kdo të na zbulojnë. Demonstruesit i thyenë shpejtë dyert e hyrjes. Ndëgjohej zhurmë e madhe, por ata nuk na zbuluan. Aty mbetëm deri në orën 8,00 të mbrëmjes. Pasi më nuk dëgjohej kurfarë zhurme u murëm vesh që të ikim në pyll. Pasi tolëm jasht vërejtëm se çdo gjë ishte plaçkitur dhe demoluar. I morëm disa batanije, pak konzerva dhe u nisëm drejtë pyllit ku qëndruam deri në orën 1,00 pas mesnate (...) pastaj vendosëm të zbresim deri te shadërvani, pa parë parasysh se çka do të ndohte.

Në qendër të Prizrenit, dëshmitares dhe grave të tjera nga shtëpitë fqinje në lagjen Nënkalaja u kishte ndihmuar një Shqiptar i panjohur.

Arritëm deri te shkolla e muzikës dhe aty takuam katër meshkuj. Për një qast menduam se mbaruam, por ishim me fat, këta ishin fqinjët tanë Shqiptarë (...) Ata na dërguan në shtëpinë e tyre dhe aty e pritëm mëngjesin (...) E bija e një Shqiptari e kishte dikend në KFOR të cilin e lajmëroi se kemi nevojë për ndihmë. Vetëm në mbrëmje të asaj dite rreth orës 8,30 pasi u dogjën të gjitha shtëpitë Serbe Nënkala, arritën dy automjete të KFOR-it me 4 ushtarë, të cilët na morën dhe na dërguan në kazermë.

M.SH. Serbe nga Prizreni, e vendosur në bazën e KFOR-it gjerman
FDH intervistë e datës 27 prillj 2004

19.2.3. Njohja e sulmuesve

Nga tarraca pashë 7 meshkuj të panjohur. Ata silleshin rreth shkollën. Në orën 14,10 minuta ra zilja e derës sime. Unë nuk e hapa derën (...) Ata u kthen sërish pas 20 minutash (...) Nga zëri mund t'i njihja njerëzit që kishin uzurpuar një banesë Serbe në katin e 4 të kësaj banese. Nga taraca vërejta Shqiptarin me emrin Shasivar, i cili e ka një mercedes të murëm. Ai në vitin

1999 pikërisht me këtë mercedes i bartëte sendet e plaçkitura nga banesat e serbëve. Në orën 15,30 demonstruesit tentuan për herë të parë ta thyejnë derën time por nuk arritën. Pas një ore sëerish u kthyen. Nuk e di se me çka e goditën derën por (...) nga kjo goditje dera u blokua. Në të njejtën kohë një grup i të rinjëve u tubua pas ndërtesës (...) Njëri prej tyre më tha: "zbrit posht". Një grup u nis drejt hyres së ndërtesës, me siguri për ta thyer derën. Ky ishte tendimi i tyre i fundit për ta thyer derën (...) , por në qastin e fundit arritën policët.

E. Gj. Serbe nga Prizreni
FDH intervistë e datës 28 prill 2004

19.2.4 Të dhënat zyrtare lidhur me shtëpitë e shkatëruara nga data 17 deri 19 mars

Sipas të dhënave të Komisionit të komunës së Prizrenit për vlerësimin e dëmeve janë djegur 51 shtëpi, kurse 4 janë demoluar. Sipas vlerësimit të këtij komisioni dëmet kapin shumën pre 826.180 euro.

Në lagjen Nënkalaja janë djegur shtëpitë e: Blagoje Jeftiqit, Ilija Stavretoviqit, Vekoslav karajeliqit, Luka uniqit, Zvonimir Rakiqit, Zlata Vasiljeviqit, Danica Nedelkoviqit, Spase Mojsiqit, Dimitirje Stojkoviqit, Danica Dishljenkoviqit, Svetlana Kokanoviqit, Pite Pitoviqit, Moma paviqeviqit, Risto Tasiqit, Borka Veselinoviqit, Toma Vasiljeviqit, Spase Mihaloviqit, Krste Lakiqit, Danica Mihajloviqit, Leposava Qosiqit, Stojana Stojanoviqit, Krste Zariqit, Milan Vukadinoviqit, Bedri Bojagjiut, Krunislam Mondusiqit, Bozhana Gjurgjeviqit, Dimka Dimkiqit, sjpase Dinetoviqit, Gjon Gjonajt, Petaar Nedeljkoviqit, Ded Kaqinarit dhe Krste Zariqit.

Komisioni nuk ariti të verifikoj emrat e 28 pronarëve të tjerë të shtëpive në lagjen Nënkalaja. Në pjesët tjera të qytetit janë djegur edhe tri shtëpi (në rrugën Zahir Pajaziti, kurse shtëpia e Millosh Nekiqit në rrugën Ismet Jashari-Kumanova është shkatëruar plotësisht).

19.3. Shkatërimi i objekteve fetare

Gjatë pesë vjetëve të fundit kemi përjetuar gjëra të tmershme. Menjëherë pas tërheqjes së policisë dhe ushtrisë Serbe është vrarë monarku, ati Hariton. Trupi i tij është gjetur pa kokë në lagjen prizrenase Tuzus (...) Plotë pesë vjet nuk kemi mundur të dalim jashtë mureve të manastirit pa përcjellje të KFOR-it. Më datën 17 dhe 18 mars filloi sulmi ndaj Serbëve që ende kishin mbetur në Kosovë. Pasi në prizren i dogjën dhe i demoluan të gjitha kishat dhe objektet ortodokse si dhe një numër të madh të shtëpive Serbe masa e njerëzve u nis këmbë nga Prizreni për në Manastrin e Shën Arkangjelit. Në sulmin e organizuar atë mbrëmje kundër këtij manastiri kishin marrë pjesë kryesisht të rinj Shqiptarë. Pjesëtarët e KFOR-it kanë deklaruar se ishin rreth 400, ndërkaq unë mendoj se ka pasur dy herë më shumë.

Monarku i manastirit Shën Arkangjeli
FDH intervistë e datës 26 maj 2004

Në raportin e komisionit të përmendur komunal për konstatimin e dëmeve thuhet se janë dëmtuar 8 objekte fetare, prej të cilave 3 janë shkatëruar plotësisht dhe tre pjesërisht: Shën

Marrija e levishkut nga shekulli i XIII është plaçkitur dhe shkatëruar plotësisht; manastiri i Shën Arkan Gjelit i shekullit XIV është shkatëruar plotësisht (është djegur edhe konaku me të gjitha elementet); kisha e Shën Javës e shekullit XIV është dëmtuar; kisha e Shën "Vraqa" e shekullit XIV është demoluar; kisha e Shën Gjorgjit – Ronoviqit e shekullit XV dhe kisha e Sinodit të Shën Gjorgjit është dëmtuar seriozisht; kisha e Svetog Spasa është dëmtuar më pak; kisha e Shën Javës në fshatin Zhivinjac është minuar (ka mbetur vetëm këmbana) dhe ndërtesa e Bogosllovisë Qirili dhe Metodi me të gjitha objektet përcjellëse (seminari, internati, trepezaria etj.) është djegur plotësisht. Nga kjo ndërtesë janë plaçkitur dhe djegur të gjitha librat dokumentet dhe sendet e tjera. Ndërtesa e administratës ka pësuar dëmtime më të vogëla[25]

19.4. Veprimi i KFOR-it i plicisë së UNMIK-ut dhe i SHPK

Punktet e KFOR-it para shtëpive Serbe ishin hequr ose pjestarët e KFOR-it ishin tërhequr pasi janë sulmuar nga demonstruesit. SHPK nuk u është përgjigjur thirjeve të Serbëve. SHPK-ja nuk ishte e suksesshme as në rastet kur ishte përpjekur të intervenonte para së gjithash, për shkak të numrit të vogël të policëve. Në disa raste pjestarët e policisë së UNMIK-ut janë tërhequr para demonstruesve duke ua lënë shkopinjët dhe mburojat zyrtare, të cilat pastaj i shfrytëzonin demonstruesit më rastin e sulmeve ndaj Serbëve. KFOR-i dhe SHPK organizuan evakuimin e Serbëve duke mos bërë përpjekje që të ndalojnë demonstruesit dhe të bëjnë sigurimin e pasurisë së Serbëve. Mirëpo, në disa raste pjestarët e SHPK kanë marrë pjesë në dhunën që është ushtruar ndaj Serbëve. Institucionet e tjera, siç është shërbimi i zjarëfikësve nuk kanë reaguar sipas rregullave të shërbimit.

Pashë një grup të të rinjve të cilët e thyen derën kryesore të Bogosllovisë dhe depërtuan brenda (...), pastaj ia dhan flakën. Nuk vërejta në atë rast se a kishte mbetur ndonjë Serb brenda saj. Me atë rast askush nuk intervenoj për të penguar dhunën. Vetëm pasi zjarri kishte përfshirë të gjitha objektet e Bogosllovisë dhe mund të përhapej edhe në shtëpit për rreth, arritën zjarrëfikësit. Mirëpo, ato jo vetëm që u penguan të intervenojnë, por edhe u gjuajtën me gurë. Një grup i të rinjëve e mori automjetin e tyre dhe u nis te poshtë rrugës në drejtim të ndërtesës së qendrës rajonale të UNMIK-ut. Në të njejtën kohë u ndëgjuan disa të shtëna. Nga drejtimi i ndërtesës së UNMIK-ut u nisën policët e njësisë speciale argjentinase. Ata tentuan që me gaz lotësjellës t'i shprndajnë demonstruesit, por u sulmuan nga masa e tubuar. Demonstruesit mbanin në duar gurrë, shkopinjë dhe gurë katrorë (...) Policët tërhiqeshin në drejtim të ndërtesës së UNMIK-ut. Një numër i policëve mbeti i lënduar dhe ata i lanë mburojat e shufrat të cilat i morën demonstruesit. Nuk munda të vëreja se sa polic ishin, por ishte e qartë se numri i tyre ishte i pamjatueshëm (...) Demonstruesit thyen po thuaj se të gjitha xhamat në pjesën e përparme të ndërtesës së qendrës rajonale të UNMIK-ut.

Shqiptar nga Prizreni i cili deshti të mbetej anonim
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

[25] Raporti i komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve 3 prill 2004

Këtë objekt (kisha e Shën Mërisë) deri vonë e kanë ruajtur ushtarët e KFOR-it, punkti i të cilëve gjendje drejpërdrejt të kishës. Gjatë kohës së sulmit në afërsi të kishës nuk kishte ushtarë të KFOR-it[26]

Disa prej demonstruesve me flamur të bardh iu afruan ushtarëve gjerman të KFOR-it dhe me ta diçka biseduan. Pastaj masa filloi t'ia vëjë flakën manastirit (...) Ne na vendosën në një automjet me zingjir (...) Dhe përmes rrugës anësore dolëm në rrugën magjistrale. Ushtarët gjerman na dërguan në bazën e tyre.

Monarku i manastirit Shën Arkangjeli
FDH intervistë e datës 26 maj 2004

Filloi çmenduria, krisma dhe zhurma, e pastaj nga ndërtesa e Bogosllovisë filloi të del ty. Mendoja se ndokush do ta pengoj këtë, por askush nuk u paraqit. Nuk erdhën as plicia e as ushtarët e KFOR-it (...) E solla telefonin dhe e thira birin tim Miletën, i cili gjendje në Shtërpcë dhe i tregova se çka po ndohë (...) pastaj u sajmërua policia e Shtrërpcës (...) ata më pyetën për numrin e njerëzve që e kishin sulmuar dhe djegur Bogosllovinë. Unë i luta diça që të ndërmarrin (...) Sirisht na thiri policia e Shtërpcës dhe na njoftuan se kanë biseduar me policinë e Prizrenit të cilët u kishin thënë se pjestarët e KFORI-it dhe të plicisë së UNMIK-ut gjenden te shkolla e muzikës në fund të Nënkalasë dhe se do të na ofrojnë ndihmën e nevojshme. Unë ju afrova dritares dhe shikova në drejtim të shkollës së muzikës, por nuk pash as polic e as ushtarë të KFOR-it, vetëm munda të shikoja se si digjej kisha e Shën Spasit. Në anën e kundërt digjej kisha e Shën Javës, nja 100 metra larg shtëpis sime.

S:N. Serbe e kthyer në Prizren në lalen Nënkalaja
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

Me telefon e thirra policinë, por askush nuk u lajmërua (...) Pasi sulmuesit pushuan të më rrahin, zbritëm në bodrum dhe ikën nga shtëpia jonë. Pas kësaj arritën 5 policë. Katër prej tyre ishin Shqipar, kurse njëri fliste anglisht. Ata na thanë se duhet të largohemi. Gruaja ime dëshironte të kthehej për ta marë çantën me dokumente ku i mbante edhe 2000 euro, që i kishim kursyer për pleqëri dhe shpenzime të varimit, por ata nuk e lejuan që këto gjëra të merte. Edhe unë tentova, por polici i SHPK filloi të mp godas prapa. Me goditi disa herë fuqishëm. Me atë rast ndjeva dhëmbje të forta: Dy policë të tjerë ma vunë kapelën në kokë dhe më detyruan të shkoja deri te automjeti i tyre.

S.R. Serbi shtëpia e të cilit gjendej afër kishës së Shën Mërisë
FDH intervistë e datës 28 prillj 2004

Demonstruesit së pari hynë në oborr e pastaj në shtëpi, edhe pse në të ishte e vënë tabela e KFOR-it në të cilën ishte e shkruar: "kjo shtëpi gëzon mbrojtjen e KFOR-it – Stop". Por KFOR-i nuk na mbrojti. Nga KFOR-i dhe policia morëm telefnat që të mund t'i thërasim në rast nevoje. Më heret gjithëherë përgjigjeshin në thirjet tona, por kësaj rradhe nuk ndohi ashtu (...) Ata fare nuk përgjigjeshin. Plicia ariti tepër vonë, atëherë kur tanimë çdo gjë ishte

---

Ibid

plaçkitur dhe demoluar, që të më evakuojn ose thëm më mirë, të më nxjerin me dhunë nga shtëpia.

D.D. Serbe nga Prizreni, lagja Lakuriq, arsimtare në pension
FDH intervistë e datës 25 prill 2004

Unë e thira plicinë përmes një miku të OSBE-së. Ai ishte greg (...) prej tij kërkova që të mi jep emrat e policëve që do të vijnë të më marrin, sepse askujt nuk mund t'i besoja (...) Nuk kaluan as 10 minuta dhe policët erdhën. Në momentin e arritjes së policëve të rinjtë që demonstronin isin para dyerve të mija. Kur policët e hapën derën pashë dy të rinj me duar të ngrituar lartë, të cilët ishin të kthyer kah muri. Një polic e mbylli derën e banesës që të mos i shihja dy të rinjtë në koridor. Nuk e di se çka ka ndohur me ta. A janë arestuar apo liruar. Policët më thanë se kemi mjaftë kohë që të përgatitemi. Rreth jorës 18,00 na nxorën nga banesa. E mbyllën derën e banesës sime dhe na quan në stacionin policor. Pastaj na dërguan në bazën e KFOR-it gjerman. Policët u sollën shumë mirë me mua. Mendoj se një polic i cili kishte ardhur në banesën time quhet Naser, dhe ai e di se kush ishin ata djelmoshat e tjerë. Siç jam njoftuar më vonë banesa ime megjithatë ishte plaçkitur.

E.Gj. Serbe nga Prizreni, e vendosur në bazën e KFOR-it gjerman
FDH intervistë e datës 24 prill 2004

19.5. Pasojat

Serbët e mbetur, rreth 30 veta të vendosur në bazën e KFOR-it german, në fillim ishin të vendosur të largohe nga Kosova pas një zhdëmtimi material. Disa prej tyre edhe kanë shkuar. Pas tre muajsh, numri i atyre që dëshirojnë të mbesin është më i madh, me kusht që tu rindërohen shtëpitë. Disa Shqiptarë mendojnë se dhuna e marsit është një turp ndaj njerëzve të paaftë dhe se vetëm një numër i vogël i fqinjëve ka rezikuar tu ndihmojë të rezikuarve.

Ata që paraqiten si mbrojtës të interesve të shqiptarëve siç është AKSH (Armata Kombëtare Shqiptare), porosisinë se do të luftojnë kundër padrejtësisë që po e ushtron UNMIK-u e për lirinë e popullit shqiptarë, pa marë parasysh çmimin.

Bogosllovia ka qenë shtëpia ime e vetme. Kam jetuar në kushte modeste, që nga lufta kam arritur të kurse 2.300 euro dhe të gjitha më janë djegur. Nuk di se çka do të ndoh me ne. Ne kemi qenë njerëz pa asgjë. Kujt i kemi penguar?

O.F. Serbe nga Prizreni, e vendosur në bazën e KFORI-it gjerman
FDH intervistë e datës 27 prill 2004

U pa qartë se çdo gjë ishte e organizuar mirë. Dikush këto i ka nxitur. Janë sulmuar të gjitha objektet ortodokse. Sikur çdo gjë të mos ishte e organizuar nuk do të digjeshin vetëm shtëpitë e Serbëve e jo edhe të Shqiptarëve që ishtin afër tyre. Për shembull, është djegur Bogosllovia, kurse shtëpitë Shqiptare përrreth kanë mbetur të paprekura. (...) Çdo gjë që kanë bërë kan shkuar në dëm të Shqiptarëve. Tani nevojitet kohë e gjatë dhe mund i madh që të kthehet besimi.

H.M. Shqiptar nga Prizreni
FDH intervistë e datës 27 mars 2004

Shpresonim se do të na ktheheshin fëmijët dhe për një jetë më të mirë, mirëpo, atë ditë fqinjët danë nuk ishin fer, sepse nuk na ndihmuan. Ndoshta nuk kan guxuar (...) Në rrugë kishte shumë njerëz. Policët e SHPK së bashku me fqinjët tanë vetëm shikonin si digjej kisha e Shën Mërisë. Duke hyrë në automjet gruaja ime u tha fqinjëve "Duhet të turproheni që po i lejoni të gjitha këto". Askush nuk e tha asnjë fjalë.

S.R. Serb nga qendra e Prizrenit
FDH intervistë e datës 28 prill 2004

Veprimet e huliganëve dhe të kriminelëve na kanë turpëruar të gjithëve. Tani duhet shumë kohë dhe mund që të kthehet besimi i humbur (...) Kur bisedova me bitë e mi Armendin, i cili është në Gjermani dhe me Arminin i cili gjendet në Sarajevë ata më thanë: "Ne më nuk do të vijmë në Prizren!" e pse të vijmë?

G.I. Shqiparë nga Prizreni
FDH intervistë e datës 19 maj 2004

Shtëpia ime ishte djegur para luftës së Dytë Botërore. Të njejtën shtëpi po e kërkoj (...) Ma dogjën shtëpin, e rrafshuan terrenin dhe tani duket sikur ajo kur nuk ka ekzistuar, sikur nuk ka pasur shtëpi në atë vend, e kjo nuk është e vërtetë. E dua shtëpinë time (...) Scilit i takon e drejta në sendin e vet. Në këtë shtëpi është shpirti im, sepse në të kanë jetuar prindërit e mi dhe në të jam rritur. Askush nuk ka të drejtë të ma merr shpritin.

M.N. Serb nga Prizreni
FDH intervistë e datës 26 prillj 2004

Rrezistenca jonë kundër vendimeve të padrejta është lufta jonë legjitime për çlirimin nacional të popullit tonë. Këtë luftë duhet përparuar. Populli ynë nuk kërkon që liria të falet, e as të gjunjuzohet ..... Ai do të organizohet dhe do ta fitojë lirinë pa marë parasysh çmimin[27]

20. Vrasja e babait dhe e të birit në fshatin Dajkoc

Natën ndërmjet 17 e 18 marsit në fshatin Drajkovc janë vrarë në oborrin e tyre, Dobrivoje dhe biri i tij Borko Stolliq.

Edhe pse në territorin e komunës së Shtërpcës nuk pati incidente, përkatësisht djegie e shkatërime të kishave dhe të shtëpive Serbe, te shumë qytetarë tanë vërehej frika. Dhuna e ushtruar në vendet tjera devalvoi të gjitha të ariturat pozitive gjatë pesë viteve të fundit. Ne kohëve të fundit gëzonim liri më të madhe dhe lirisht udhtonim deri në Prizren, Ferizaj, Prishtinë dhe vende të tjera. Policia e KFOR-it nuk i përcillte konvojet tona. Nuk janë shënuar asfarë incidentesh. Janë suprimuar punktet kontrolluese të policisë dhe të KFOR-it. Pas vrasjes tinzare të dobrivoje Stoliqit dhe birit të tij 22 vjeçar Borkos në natën ndërmjet 17 dhe 18 marsit, në fshatin Dajkovc të komunës së Shtërpcës ndër sërbët mbretroi friga dhe pasiguria (...) Sulmuesit e panjohur kanë shtënë me batare ndaj babës dhe të birit. Ata jnë vrarë rreth orës 22,15 në oborin e shtëpisë. Dobrivoje është qëlluar me disa pëlumba në kokë. Pasi i ka

[27] Lëvizja për çlirimin kombëtarë të Kosovës – 23 mars 2004

dëgjuar të shtënat Borko da dalur të shoh se çka po ndodhë. Sulmuesit kanë shtënë dhe e kanë plagosur. Të plagosur e kanë dërguar në bazën amerikane Bondstill, por nuk mbijetoi. Pas kësaj, nëna e Borkos, Verica, pësoi çregullim mental. Ajo tani gjendet në Mladenovc te vjehra dhe vjehri. Askush nuk i ka pa sulmuesit (...) Të nesërmën policia nuk ka mundur ti afrohet vendit të ngjarjes sepse kishte të shtëna nga të gjitha anët. Më vonë këtë e mundësuan ushtarët e KFOR-it. Në oborin e shtëpisë janë gjetur 35 gëzhoja të pushkës automatike dhe gjurmët e qizmeve. Këtë ma ka thënë vllau Stanoje, i cili ka jetuar në Dajkovc dhe i cili pas këtij incidenti, nga frika është larguar me gruan e vet, sikur edhe shumë të tjerë dhe është vendosur në Shtërpcë.

L.R. Serb nga Shtërpca, drejtor i shtëpisë së kulturës
FDH intervistë e datës 2 maj 2004

20.1. Pasojat

Pas vrasjes së Dobrivoje dhe Borko Stoliqit pushuan të funkcionojnë organet komunale, ngase përfaqësuesit shqiptarë nuk janë duke ardhur në asembletë komunale. Pjestarët Serb të SHPK nga Shtërpca kan refuzuar të punojnë së bashku me kolegët Shqiptarë për shkak të dhunës së ushtruar ndaj Serbëve aneë e mbanë Kosovës. Pas kërcnimit se do të suspendohen ata u kthyen në punë. Mirëpo, madje edhe në këto marrëdhënie të qregulluara multietnike Serbët dhe Shqiptarët e fshatrave multietnike Biti e Ulët, Biti e Epërme dhe Sushicë janë marrë vesh që, nëese e do nevoja do ta mbrojnë fshatin dhe finjët e vet.

Kuvendi dhe organet komunale nuk funkcionojnë. Nënpunësist shqiptarë nuk janë duke ardhur në punë. Nënpunësit Serbë nuk pranojnë të punojnë me Shqiptarë. Ka prej atyre që kërkojnë zyra të ndara për Shqiptar dhe Serbë. Mbledhja e kuvendit e caktuar për datën 22 prill 2004 nuk është mbajtur për shkak të mosardhjes së këshilltarëve. Këto dukuri ta mundësojnë nxjerrjen e vendimeve të ndryshme. Disa keqpërdorin këtë situatë dhe kthimin e tyre e kushtëzojnë me kthimin e Serbëve në Kosovë. Ata kërkojnë që të sigurohet funksionimi i institucioneve multietnike në prishtinë dhe qytetet e tjera të Kosovës në të cilat jetojnë vetëm Shqiptarët, gjithnjë e më të zëshme janë kërkesat për ndarjen, përkatësisht kantonizimin e Kosovës etj. Megjithatë, derisa disa politikanë Serbë dhe Shqiptarë bënin gara se kush do të jetë më patriot mbi baza etnike, vepronin qytetarët e fshatrave të përziera në komunën tonë. Shqiptarët dhe Serbët e fshatit Biti e Ulët, Biti e Epërme dhe Sushicë, janë marrë vesh që bashkarisht të mbrohen nga persona të panjohur edhe kjo është diçka pozitive te ne, që meriton të shfrytëzohet në të ardhmen

L.R. Serb nga Shtërpca, drejtor i Shtëpisë së Kulturës
FDH intervistë e datës 2 maj 2004